INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS
GOVERNMENT OF KOSOVO
VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJENAUKU I TEHNOLOGIJU

Këshilli i Ekspertëve për Arsimin Parauniversitar

# STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË 2007-2017

Prishtinë, mars 2007

**Botues:**
Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT)

**Për Botuesin:**
Dr. Fevzi Berisha, zëvendësministër

**Redaktor:**
Dr. Dukagjin Pupovci

**Ballina & Layout:**
Petrit Tahiri

**Shtypi:**
Druckart

**Tirazhi:**
2000 kopje

**Përmbajtja**


Lista e shkurtesave........................................................................................ 5
Fjala e ministrit.............................................................................................. 6
**Përmbledhje ekzekutive**................................................................................ 9
**1. Hyrje**........................................................................................................ 13
**2. Arsimi parauniversitar në Kosovë – gjendja e tanishme**........................... 17
2.1. Konteksti shoqëror-politik.............................................................. 17
2.2. Arritjet dhe dobësitë e sistemit të arsimit......................................... 19
2.2.1. Kapacitetet menaxhuese të sistemit.................................. 19
2.2.2. Cilësia dhe efektiviteti...................................................... 22
2.2.3. Përfshirja dhe barazia në arsim......................................... 24
2.2.4. Përgatitja dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve...... 26
2.2.5. Infrastruktura.................................................................... 27
2.2.6. Arsimi dhe shoqëria.......................................................... 29
2.2.7. Pozita materiale e arsimit.................................................. 31
**3. Parimet e zhvillimit të sistemit – Vizioni dhe misioni**............................... 35
3.1. Parimet për zhvillimin e sistemit të arsimit...................................... 35
3.1.1. Parimi i dobisë, përfitimit dhe i filantropisë ................. 35
3.1.2. Parimi i haptësisë, i transparencës dhe i fleksibilitetit...... 36
3.1.3. Parimi i monitorimit, matjes dhe i vlerësimit................. 36
3.1.4. Parimi i efikasitetit dhe i efektivitetit ............................ 37
3.1.5. Parimi i drejtësisë dhe i pjesëmarrjes në arsim................ 37
3.1.6. Parimi i rregullimit dhe i krijimit të stabilitetit................. 38
3.1.7. Parimi i tërësisë................................................................ 39
3.1.8. Parimi i interesit kombëtar................................................ 39
3.2. Vizioni dhe misioni.......................................................................... 39
3.2.1. Vizioni ............................................................................. 40
3.2.2. Misioni ............................................................................ 41
**4. Objektivat strategjike dhe masat**................................................................ 43
4.1. Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor e efikas në sistemin e arsimit........................................................................................ 43
4.2. Sistem funksional për sigurimin e cilësisë së të nxënit i bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e zhvilluara........................ 49
4.3. Gjithëpërfshirje, barazi dhe respektim i diversitetit në arsim.......... 53
4.4. Përgatitja dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve.................... 57
4.5. Mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimdhënie dhe nxënie.................................................................................... 60

4.6. Lidhje e qëndrueshme e arsimit me zhvillimet globale ekonomike dhe shoqërore........ 63
4.7. Avancimi i gjendjes materiale të arsimit........ 66
**5. PLANI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË**........ 69
**Objektiva 4.1:** Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor e efikas në sistemin e arsimit........ 69
**Objektiva 4.2.** Sistem funksional për sigurimin e cilësisë së të nxënit i bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e zhvilluara........ 72
**Objektiva 4.3.** Gjithëpërfshirje, barazi dhe respektim i diversitetit në arsim........ 75
**Objektiva 4.4.** Përgatitja dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve.... 77
**Objektiva 4.5.** Mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimdhënie dhe të nxënë........ 79
**Objektiva 4.6.** Lidhje e qëndrueshme e arsimit me zhvillimet globale ekonomike dhe shoqërore........ 81
**Objektiva 4.7.** Avancimi i gjendjes materiale të arsimit........ 83
**6. BUXHETI I STRATEGJISË**........ 85
6.1. Realizimi i Strategjisë – ndryshimi i strukturës dhe qasjes në financimin e arsimit........ 85
6.2. Procesi i buxhetimit........ 87
6.3. Përmbledhja e buxhetit të Strategjisë........ 89
6.4. Projeksioni i shpenzimeve për arsimin parauniversitar 2007-2012.. 95
**SHTOJCË 1**........ 100
**SHTOJCË 2**........ 102

## LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|---|---|
| **BB** | Banka Botërore |
| **BE** | Bashkimi Evropian |
| **BPV** | Bruto Prodhimi Vendor |
| **CRS** | Catholic Relief Services |
| **DKA** | Drejtoria Komunale e Arsimit |
| **ECHO** | Organizata Humanitare e Bashkimit Evropian |
| **EFA** | Arsimimi për të Gjithë |
| **FSDEK** | Programi Finlandez për Mbështetjen e Arsimit Special në Kosovë |
| **GTZ** | Bashkëpunimi Teknik Gjerman |
| **IEA** | Institucion Edukativ-Arsimor |
| **IPA** | Instrumenti Paraprak për Anëtarësim në Bashkimin Evropian |
| **ISP** | Instituti i Studimeve Pedagogjike |
| **KEAP** | Këshilli i Ekspertëve për Arsimin Parauniversitar |
| **KEC** | Qendra për Arsim e Kosovës |
| **KEDP** | Projekti Kanadez për Aftësimin e Mësimdhënësve Kosovarë |
| **KPAK** | Komiteti i Prindërve të Arsimit të Kosovës |
| **KSHAM** | Këshilli për Shqyrtimin e Aftësimit të Mësimdhënësve |
| **MASHT** | Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë |
| **MEF** | Ministria e Ekonomisë dhe e Financave |
| **MKLSH** | Zhvillimi i Mendimit Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit |
| **MKRSÇJ** | Ministria e Kulturës, e Rinisë, e Sporteve dhe e Çështjeve Jorezidente |
| **MMPH** | Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor |
| **MPL** | Ministria e Pushtetit Lokal |
| **MPMS** | Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale |
| **MSH** | Ministria e Shëndetësisë |
| **MSHP** | Ministria e Shërbimeve Publike |
| **MTI** | Ministria e Tregëtisë dhe e Industrisë |
| **OECD** | Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik |
| **OJQ** | Organizatë Joqeveritare |
| **QAP** | Qendrat e Aftësimit Profesional |
| **SMIA** | Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim |
| **TI** | Teknologji Informative |
| **UNESCO** | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë |
| **UNICEF** | Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara |
| **UNMIK** | Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë |
| **UP** | Universiteti i Prishtinës |
| **ZRA** | Zyra Rajonale e Arsimit |

## Fjala e Ministrit



Në fillim të korrikut 2005, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë filloi procesin për hartimin e Strategjisë Afatmesme të Arsimit Parauniversitar (SAPU) në Kosovë. Vendimi për fillimin e punës në hartimin e këtij dokumenti u mbështet në dy arsye kryesore. E para, arsimi në Kosovë ende vuante pasojat e gjendjes së vështirë të viteve të 1990-ta, ndërkohë që faza emergjente e rindërtimit të sistemit ishte në përfundimin e saj. Kështu që, strategjia kishte për qëllim të vendosë bazat për përmirësimin dhe zhvillimin afatgjatë të të arsimit parauniversitar në Kosovë. Arsyeja e dytë për përgatitjen e kësaj strategjie mbështetet në nevojën për përcjelljen e rrjedhave evropiane në këtë fushë dhe në krijimin e një strukture të arsimit që do të sigurojë efikasitet dhe cilësi në mësimdhënie.

MASHT është e bindur se arritja e objektivave strategjike që janë definuar në këtë dokument do të kontribuojë në tri aspekte:

1. Përmirësimi i cilësisë së arsimit do të bëjë që nxënësit që mbarojnë arsimin parauniversitar në Kosovë të zotojnë njohuri, shkathtësi dhe shprehi që janë të krahasueshme me nxënësit e vendeve të tjera. Kjo mundëson një mobilitet të shtuar të studentëve të ardhshëm dhe të fuqisë punëtore, pra një integrim më të plotë të Kosovës në rrjedhat evropiane.

2. Përmirësimi i efikasitetit të funksionimit të arsimit parauniversitar do mundësojë që fondet e dedikuara për arsim të japin efekte maksimale.

3. Do të sigurohet një pjesëmarrje më e madhe e të gjitha grupeve të shoqërisë kosovare në arsim duke ndikuar kështu në rritjen e shkallës së zhvillimit njerëzor në Kosovë dhe ndërtimin e një shoqërie të mbështetur në barazi, diversitet dhe tolerancë.

Procesi i hartimit të Strategjisë u zhvillua në kohën kur nisën bisedimet për statusin e Kosovës. Ndërsa zbatimi i saj do të bëhet në rrethana të tjera kur Kosova do të jetë shtet i pranuar ndërkombëtarisht. Ne të gjithë së bashku kemi privilegjin, por edhe përgjegjësinë, për zhvillimin e arsimit i cili po kalon fazën emergjente dhe të reformave strukturore në fazën e zhvillimit dhe të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe të arritjes së standardeve evropiane.

Pas shumë analizave dhe studimeve, ne tani të gjithë pajtohemi se niveli dhe ritmi i zhvillimi ekonomik dhe social të një vendi varet nga niveli i dijes të akumuluar në fuqinë punëtore të atij vendi. Kjo strategji ka për mision që Kosovën ta shndërrojë në një shtëpi të të nxënit për të siguruar kështu një zhvillim të qëndrueshëm në të

ardhmen. Për më tepër, arsimi e bënë qytetarin më të informuar dhe më të përgatitur për të gjykuar për politikat dhe vendimmarrjen që ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve. Kjo mundëson një qeverisje dhe llogaridhënie më të madhe nga ana e vendimmarrësve. Trendët në fushën e arsimit në Evropë siç është mësimi gjatë tërë jetës, arsimimi i të rriturve, ndërlidhja e arsimit me nevojat e shoqërisë, zhvillimet në tregun e punës, arsimi joformal dhe informal, etj. janë mekanizma që imponojnë lidhjen e natyrshme të sistemit arsimor në tërësinë e vet.

Së bashku me Strategjinë për Arsimin e Lartë në Kosovë 2005-2015, Strategjia e Arsimit Parauniversitar 2007-2017 krijon bazat për një qasje të integruar të arsimit në Kosovë në përgjithësi.

Përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent gjatë hartimit të Strategjisë për Arsimin Parauniversitar, MASHT ka arritur një konsensus të gjerë politik, qytetar e profesional. Një qasje e tillë ka bërë që në strategji të përfshihen interesat dhe specifikat e të gjitha grupeve të shoqërisë Kosovare dhe që zbatimi i strategjisë të ketë një përkrahje të gjerë nga të gjitha palët e interesit. MASHT ka mirëpritur angazhimin e të gjithë akterëve që kanë marrë pjesë në këtë proces të cilët me vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e tyre kanë pasuruar draftin e strategjisë të përgatiture fillimisht nga ekspertët.

Me këtë rast, dëshiroj të shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim dhe të MASHT për Këshillin e Ekspertëve të Arsimit Parauniversitar (KEAP), Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC), ekspertin nga Shqipëria Profesorin Bardhyl Musai, stafin e MASHT dhe të gjithë ata që kanë marrë pjesë në përgatitjen e këtij dokumenti të rëndësishëm. Një mirënjohje të veçantë për të gjitha mediat e vendit që krijuan hapësirë për paraqitjen e këtij dokumenti strategjik para qytetarëve.

MASHT pret nga institucionet e Kosovës, donatorët, partnerët dhe miqtë e arsimit e të Kosovës që të ndihmojnë zbatimin e kësaj strategjie në mënyrë që bashkërisht të hapim perspektiva të reja për nxënësit dhe për zhvillim të qëndrueshëm të Kosovën. Me punën tonë të përbashkët në implementim e kësaj strategjie do i bëjmë fëmijët tanë më të lumtur dhe do u mundësojmë atyre të jenë qytetarë të informuar për tu bërë më lehtë pjesë e zhvillimeve dhe proceseve euro-perëndimore.

Besoj thellësisht se bashkërisht mund të sigurojmë energjitë dhe burimet për të implementuar këtë strategji.

Ministri Agim Veliu

Me vendimin e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, prej muajit korrik 2005 deri në janar 2007 rreth 100 ekspertë, punëtorë arsimi dhe përfaqësues të palëve me interes morën pjesë në procesin e zhvillimit të Strategjisë për Arsimin Parauniversitar 2007 – 2017 dhe përcaktuan vizionin ‘arsimor' për Kosovën, misionin dhe objektivat strategjike të sistemit e të institucioneve arsimore për arritjen e këtij vizioni, si dhe planifikuan masa konkrete për jetësimin e të gjitha këtyre brenda mundësive reale të Kosovës në periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2017. Kuptohet se një ndër synimet thelbësore të këtij plani strategjik është edhe zhvillimi i partneriteteve përkatëse arsimore dhe ndërsektoriale në shkallë kombëtare, rajonale, evropiane dhe me gjerë me qëllim të integrimit në rrjedhat përkatëse arsimore evropiane.

**Vizioni:** Pjesëmarrësit në procesin e hartimit të planit strategjik të zhvillimit të arsimit parauniversitar në Kosovë kanë përcaktuar këtë vizion për shoqërinë kosovare dhe për sistemin arsimor pas periudhës 10 vjeçare:

***Kosova – shoqëri e dijes, e integruar në rrjedha evropiane me mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë individëve, të cilit i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.***

**Misioni:** Institucionet arsimore dhe personeli i tyre kanë rol vendimtar në aspektin e edukimit, të arsimimit dhe të aftësimit të njerëzve të Kosovës me qëllim të sendërtimit të këtij vizioni ambicioz të shoqërisë dhe të institucioneve kosovare. Kështu ata e kanë përcaktuar rolin e vet dhe të institucioneve në suaza të misionit në vijim:

***Ndërtimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, që siguron kushte për formim cilësor të të gjithë individëve duke kultivuar shprehi të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe vlera të qytetarisë demokratike.***

**Objektivat strategjike:** Në këtë kuptim dhe në bazë të shtatë fushave problemore të përcaktuara si të tilla nga të gjithë pjesëmarrësit e procesit të zhvillimit të strategjisë, hartuesit e strategjisë kanë identifikuar shtatë objektiva strategjike, të cilat duhet të arrihen në periudhën 2007-2017:

4.1. Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor e efikas në sistemin e arsimit

4.2. Sistem funksional për sigurimin e cilësisë së të nxënit i bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e zhvilluara

4.3. Gjithëpërfshirje, barazi dhe respektim i diversitetit në arsim

4.4. Përgatitja dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve

4.5. Mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimdhënie dhe të nxënë

4.6. Lidhje e qëndrueshme e arsimit me zhvillimet globale ekonomike dhe shoqërore

4.7. Avancimi i gjendjes materiale të arsimit

Këto janë njëherësh edhe shtatë objektivat dhe shtatë prioritetet e intervenimeve në sistemin arsimor kosovar me qëllim të avancimit të sistemit arsimor, të ngritjes së cilësisë, të hapjes ndaj sektorëve të tjerë dhe për zhvillimin e individit, të ekonomisë dhe të sigurimit të kohezionit social përmes arsimit.

**Masa konkrete për zbatim:** Në këtë plan strategjik janë paraparë 36 masa të përgjithshme, të cilat mund të konkretizohen në qindra projekte gjithnjë për të realizuar transformimin e nevojshëm nga gjendja e konstatuar në fillim të procesit e deri te arritja e vizionit për shoqërinë e për sistemin arsimor të përcaktuar njëzëri nga të gjithë pjesëmarrësit në proces. Në këtë rrugë të transformimit nga gjendja e tanishme në vizionin e së ardhmes për një Kosovë si shoqëri e integruar në proceset e ngjashme në Evropë, sistemi arsimor në Kosovë zotohet të sigurojë përfshirje të gjithëmbarshme të fëmijëve e të të rinjve në sistemin arsimor, parasheh që mësimi të zhvillohet në më së shumti dy ndërrime, zotohet që do të shtatëfishojë përfshirjen e tanishme të fëmijëve të grupmoshës 0-5 vjeç, ndërkaq premton se do të përfshijë pothuajse të gjithë (90 %) të fëmijëve të grupmoshës 5 – 6 vjeç në arsimin parafillor, që deri në vitin 2017 të gjithë mësimdhënësit në shërbim do të përfshihen në programe të akredituara për zhvillim profesional e të tjera të ngjashme. Të gjitha këto dhe aspekte e rrugë të tjera për avancimin e domosdoshëm të sistemit arsimor kosovar janë paraparë në këtë dokument, i cili, pas hartimit të planit dhe të buxhetit të detajuar për zbatimin e strategjisë (deri në vitin 2012), është miratuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë dhe është dërguar në miratim nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës.

**Vlerësimi:** Kjo Strategji dhe masat e parapara aty do të monitorohen në vazhdimësi dhe do të vlerësohen në bazë periodike në bazë të një plani të detajuar të monitorimit dhe të vlerësimit.

**Prioritetet qeveritare:** Pikërisht gjatë vitit 2006, në vlug të zhvillimit të këtij plani strategjik, Qeveria e Kosovës e deklaroi politikën e saj, bazuar në tri prioritete kryesore - Tri “E“-të e Qeverisë: ekonomia, edukimi (arsimi) dhe energjetika. Pikërisht ky qëndrim dhe kjo gatishmëri e Qeverisë e bën edhe më të realizueshëm planin mjaft ambicioz të masave të parapara për arritjen e objektivave strategjike të vendosura. Një aspekt i rëndësishëm i këtij plani zhvillimor të arsimit në planin e përgjithshëm është se ky plan po ashtu shënon një kthim të vëmendjes dhe të përparësive të Qeverisë në drejtim të mësimdhënësit, të shkollës, të prindërve, në drejtim të infrastrukturës fizike dhe teknologjike dhe në drejtim të një ambienti më miqësor e më demokratik për nxënësit në shkolla.

**Përkushtimi:** Energjia dhe dija e investuar në zhvillimin e kësaj strategjie, përkushtimi i institucioneve kosovare për të zhvilluar arsimin, si dhe dashuria e vendosmëria e dëshmuar gjatë viteve të nëntëdhjeta e komunitetit kosovar për arsimimin dhe shkollimin e fëmijëve të tyre janë garanci se arsimi dhe shoqëria kosovare kanë një të ardhme të përbashkët, të ndritur dhe të orientuar nga të gjithë njerëzit e Kosovës, pa dallim.

Menjëherë pas themelimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në vitin 2002, udhëheqja e atëhershme formoi një grup të përzier punues me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë për fillimin e procesit të hartimit të një plani afatshkurtër strategjik të zhvillimit të arsimit kosovar 2002 – 2007. Ky grup përfundoi punën e vet në maj të vitit 2003, duke prodhuar planin e parë strategjik për daljen e arsimit kosovar nga faza emergjente dhe për konsolidimin e tij, duke ruajtur në të njëjtën kohë unitetin e sistemit arsimor dhe duke paraparë edhe integrimin në rrjedhat dhe proceset përkatëse evropiane. Megjithëse i hartuar nga një grup i ngushtë i ekspertëve dhe zyrtarëve të administratës qendrore të MASHT-it dhe pa pjesëmarrje qoftë të praktikuesve të arsimit apo të sektorëve të tjerë relevantë për arsimin, ky plan dhe planet e tjera vjetore të veprimit të dala nga ky siguruan një zhvillim relativisht të planifikuar të sistemit arsimor gjatë viteve 2002 – 2004. Ky plan përqendronte përpjekjet e strukturave dhe të institucioneve arsimore për zhvillimin e planprogrameve dhe teksteve të reja në zbatim të këtyre planprogrameve.

Megjithatë, në fillim të vitit 2005, pas vlerësimit të procesit të planprogrameve nga Instituti i Edukimit i Londrës, në kohën kur po përfundonte zhvillimi i planprogrameve të reja, kur shumica e programeve ndërkombëtare për mbështetjen e arsimit në Kosovë kishin përfunduar ose kishin përparuar në fazën e tyre të dytë, kur projekti i Bankës Botërore për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim ngadalë po i afrohej përfundimit dhe në kohën kur ishte zhvilluar tashmë strategjia për zhvillimin e arsimit të lartë 2005 – 2015, u bë e qartë se strategjia e parë nuk mjaftonte për të siguruar një zhvillim koherent të sistemit arsimor, në veçanti në pjesën e tij më të rëndësishme – në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, si në mësimdhënie ashtu edhe në administratë. Zhvillimet në sferën arsimore të përmendura më lart kishin ndryshuar kuadrin më të gjerë profesional të sektorit të arsimit dhe dokumentet e atëhershme strategjike nuk arritën t'i përcillnin zhvillimet e shpejta të kontekstit më të gjerë shoqëror. Po ashtu, Procesi i Lisbonës (për reformat arsimore në Evropë deri në vitin 2010) dhe Deklarata e Kopenhagës (për zhvillimin e arsimit dhe aftësimit profesional) bashkë me proceset integruese rajonale e evropiane po bëheshin gjithnjë e më të rëndësishme për sistemin arsimor kosovar (krahasuar me fazën emergjente të rindërtimit e të konsolidimit të arsimit të viteve 2002 - 2004).

Si rezultat e të gjitha këtyre, në korrik të vitit 2005, në Durrës, u mbajt një sesion planëzues, në të cilin morën pjesë udhëheqës të lartë të MASHT-it dhe ekspertë kryesorë të arsimit kosovar. Aty u vendos për konceptin dhe për piketat e një procesi të rëndësishëm për zhvillimin e planit afatmesëm strategjik për zhvillimin e arsimit 2007 – 2017.

# 1. Hyrje

Vendimet kryesore të këtij sesioni planëzues ishin:

a) të themelohet Këshilli i Ekspertëve për Arsimin Parauniversitar për koordinimin e procesit të zhvillimit dhe të zbatimit të Strategjisë;

b) procesi i Strategjisë së arsimit parauniversitar të bazohet në përvojat pozitive të procesit të strategjisë së arsimit të lartë;

c) të krijohet një strukturë mbështetëse e procesit (agjenci implementuese, sekretariat, konsulencë) për të siguruar zhvillim koherent dhe të papenguar të procesit dhe

d) hartimi i një strategjie të veçantë të komunikimit si për procesin e strategjisë, ashtu edhe për informimin e opinionit për zhvillimet arsimore në Kosovë në përgjithësi.

Elemente kryesore të procesit tonë të strategjisë së arsimit parauniversitar janë shtrirja, përfshirja, koherenca, komunikimi, dhe ekspertiza. Me shtrirjen nënkuptojmë zgjerimin e pjesëmarrjes dhe pronësisë ndaj procesit të strategjisë te palët (e të gjitha përkatësive etnike) të interesuara qoftë si ofruese apo si përfituese të shërbimeve arsimore. Kjo shtrirje është arritur përmes organizimit të punëtorive për identifikimin e dobësive dhe të arriturave të sistemit në të shtatë rajonet. Në këto punëtori kanë marrë pjesë mësimdhënës, administratorë e zyrtarë arsimorë nga të gjitha anët e Kosovës. Në anën tjetër, shtrirja te komuniteti dhe deri te përfitues të tjerë të shërbimeve arsimore arrihet përmes ngjarjeve dhe veprimeve të ndryshme të organizuara në kuadër të qasjes së re për komunikimin e procesit të strategjisë me përfituesit. Një shtrirje e këtillë ka siguruar edhe pjesëmarrje e pronësi më të madhe të të gjitha palëve të përfshira në sektorin arsimor në Kosovë. Ngjarjet e organizuara për këtë qëllim e kanë bërë procesin tonë unik dhe pothuajse gjithëpërfshirës dhe kanë siguruar qëndrueshmëri të masave dhe veprimeve të parapara për të siguruar realizimin e objektivave të parashtruara në strategjinë tonë për zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar. Në këtë kontekst, të vetëdijshëm se sistemi arsimor është një dhe i pandashëm, MASHT-i ka qenë e kujdesshme të sigurojë edhe koherencë të zhvillimit ndërmjet niveleve të arsimit parauniversitar dhe të arsimit të lartë përmes përfshirjes së një numri të ekspertëve nga procesi i strategjisë së arsimit të lartë 2005 – 2015. Procesi i kësaj strategjie ka përfshirë në njërën nga format e veta të shumta të punës gjithë ekspertizën dhe përvojën relevante në Kosovë, si dhe të gjithë sektorët e rëndësishëm, të cilët, më shumë a më pak, komunikojnë me sektorin e arsimit.

Një sërë punëtorish me pjesëmarrje nga nivele, aspekte, segmente dhe sektorë të ndryshëm të sistemit arsimor kanë bërë të mundur identifikimin e dobësive dhe të arriturave, përmes përcaktimit të fushave të trajtuara, pastaj definimin e vizionit, misionit, objektivave strategjike zhvillimore dhe, në fund, nxjerrjen e masave e veprimeve konkrete për çuarjen përpara të sistemit arsimor nëpër vitet e rëndësishme kah të cilat po ec shoqëria kosovare. Të gjitha këto masa janë operacionalizuar në planin e hollësishëm të veprimit për vitet 2007 – 2012.

Të gjitha aspektet dhe segmentet e kësaj strategjie i kanë vlerësuar drejt kahet e zhvillimit të arsimit kosovar në përputhje me mundësitë e qeverisë dhe të shoqërisë për të mbështetur një zhvillim të tillë. Këtu, po ashtu, vlerësohet dhe theksohet drejt nevoja e sigurimit të mbështetjes së domosdoshme ndërkombëtare për të mundësuar këtë zhvillim – sidomos deri në vitin 2012 kur mund të pritet një këndellje e ekonomisë kosovare dhe e kapacitetit të kësaj shoqërie për prioretizimin e duhur dhe zhvillimin adekuat të arsimit me forcat e veta.

Në fund, me qëllim të analizës sa më të mirë të gjendjes dhe të perspektivave në sistemin e arsimit, ekspertët, zyrtarët dhe mësimdhënësit që morën pjesë në procesin e hartimit të kësaj strategjie vendosën që ta ndajnë informacionin dhe realitetin arsimor kosovar në shtatë fusha problemore:

1. Kapacitetet menaxhuese të sistemit
2. Cilësia dhe efektiviteti
3. Përfshirja dhe barazia në arsim
4. Përgatitja dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve
5. Infrastruktura
6. Arsim dhe shoqëria dhe
7. Baza materiale e arsimit.

Në bazë të këtyre fushave problemore janë organizuar edhe grupet punuese dhe ekspertiza e zyrtarëve dhe ekspertëve të përfshirë në këtë proces.

## 2.1. Konteksti shoqëror-politik

Në vitin 2005, kur edhe filloi hartimi i kësaj strategjie të zhvillimit të arsimit parauniversitar, Kosova po kalonte nëpër një fazë të rëndësishme të kohës së transicionit të periudhës së pasluftës.

Për zhvillimet në rrafshin arsimor u tha diçka në hyrjen e këtij dokumenti, ndërkaq në rrafshin politik dhe ekonomik ishin një varg ngjarjesh dhe zhvillimesh që në thelb po e ndryshonin relievin e përgjithshëm shoqëror, politik dhe ekonomik të sektorit të arsimit.

Në rend të parë kishim tashmë një sërë zgjedhjesh në nivel vendor e kombëtar të cilat u vlerësuan si shumë të suksesshme e demokratike nga bashkësia ndërkombëtare. Të fundit nga këto zgjedhje prodhuan edhe një qeverisje relativisht stabile me pozitë dhe opozitë demokratike funksionale. Kjo qeverisje ia arriti të përballojë sprova të rëndësishme në rrethana të kufizimeve të shumta politike, materiale e financiare.

Së dyti, ishte procesi i zbatimit të standardeve për Kosovën – një sërë kushtesh që bashkësia ndërkombëtare ia kishte përcaktuar Kosovës dhe institucioneve të saj në rrugën e pavarësimit. Në tetor 2005 i dërguari special i bashkësisë ndërkombëtare, Kai Eide, e vlerësoi në përgjithësi pozitivisht procesin e zbatimit të standardeve, mirëpo, në të njëjtën kohë, kërkonte vazhdimin e plotësimit të standardeve të mbetura, duke vlerësuar të domosdoshëm përfundimin e obligimeve të mbetura para vendosjes së statusit të ardhshëm të Kosovës. Një pjesë e këtyre standardeve kishte të bënte drejtpërsëdrejti me sektorin e arsimit ose në njëfarë dore ndikonte në punën e këtij sektori. Sa për ilustrim, standardi i kthimeve të qëndrueshme prekte edhe çështjen e arsimit, pasi që për çdo të kthyer duhej siguruar edhe kushte për shkollimin e fëmijëve të tyre. Procesi i zbatimit të standardeve për Kosovën ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë në sektorin e arsimit, qoftë si fushë e angazhimit të institucioneve arsimore, qoftë si prioritet që pengon vendosjen e përparësisë së duhur në zhvillimin e arsimit nga institucionet e Kosovës.

Element i tretë i rëndësishëm gjatë kësaj kohe e që ka ndikuar dukshëm në krijimin e kontekstit të gjerë shoqëror e ekonomik të sektorit të arsimit ka qenë edhe procesi i privatizimit. Mënyra e zhvillimit të privatizimit dhe zhagitjet në këtë drejtim kanë ndikuar në thellimin dhe zgjatjen e krizës ekonomike në Kosovën e pasluftës dhe kanë dobësuar bazën materiale të shoqërisë për investim të duhur në sektorin e arsimit. Në këtë mënyrë, ideja dhe qëllimi shumë i qartë i qeverive kosovare për t'i dhënë përparësi arsimit vazhdimisht ka mbetur në nivel deklaratash për arsye të bazës së dobët financiare të shoqërisë.

Rrjedhimisht, edhe përqindjet relativisht të mira (rreth 12.5 %) të mjeteve të ndara për arsim nga buxheti qeveritar ishin të pamjaftueshme për shkak të brutoprodhimit të ulët vendor dhe të buxhetit të vogël.

Me rëndësi gjatë kësaj kohe ka qenë edhe bartja e pushtetit nga UNMIK-u në institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës. Arsimi qysh në formimin e MASHT-it ka qenë e drejtë e transferuar, mirëpo shkollimi në gjuhët e minoriteteve ka mbetur e drejtë e rezervuar në duart e UNMIK-ut. Një situatë e tillë nuk ka ndihmuar shumë në trajtimin e çështjeve që kishin të bëjnë me shkollimin e pjesëtarëve të komunitetit serb. Edhe pse të gjitha komunitetet tjera etnike të Kosovës janë të integruara plotësisht në sistemin arsimor kosovar, kjo nuk mund të thuhet edhe për komunitetin serb, i cili, praktikisht, ka krijuar një sistem paralel të shkollimit. Ky sistem shpesh përdoret për nevojat ditore të politikës, duke ia bërë të pamundur institucioneve të Kosovës ofrimin e shërbimeve arsimore cilësore për fëmijët që mësojnë në gjuhën serbe. Ky sistem paralel dhe shkollimi e integrimi i fëmijëve e i të rinjve të komunitetit serb në shoqërinë kosovare do të mbetet një nga rreziqet potenciale të zhvillimit të mëtejmë të sistemit arsimor kosovar, por edhe një sfidë për procesin e strategjisë së arsimit parauniversitar të Kosovës.

Në fund, si rezultat i plotësimit të standardeve dhe për shkak të paqëndrueshmërisë së statuskuosë në Kosovë, në radhët e bashkësisë ndërkombëtare u krijua bindja se duhej patjetër të fillonin bisedimet për statusin e ardhshëm të Kosovës. Zhvillimi i këtyre bisedimeve, disi vetvetiu, e ka vënë në plan të dytë çështjen e investimit në arsim (me gjithë politikën e deklaruar të qeverisë për tri “E”-të: ekonomi, energji dhe edukim). Megjithatë, përfundimi i shpejtë i këtyre bisedimeve mund të hapë rrugë për investim më të mirë në arsim, pasi që rregullimi i statusit të Kosovës mund të hapë rrugë për zhvillim ekonomik të Kosovës, por edhe për konkurrim për kredi të ndryshme të leverdishme pranë institucioneve ndërkombëtare si Banka Botërore e të tjera. Në këto rrethana do të ndihmonte edhe politika e deklaruar e Qeverisë për tri “E“-të.

Integrimet rajonale si në kuadër të Paktit të Stabilitetit apo në kuadër të nismave të ndryshme dypalëshe e shumëpalëshe për bashkëpunim në rajon, po ashtu e kanë ndryshuar kontekstin e funksionimit të institucioneve arsimore por edhe misionin e arsimit në promovimin e vlerave evropiane, bashkëpunimit, tolerancës, kompetencave kyçe, ndërmarrësisë e të vlerave të tjera që promovojnë integrimet rajonale dhe ato më të gjera evropiane. Haptësia më e madhe e Bashkimit Evropian për lehtësimin e qasjes së vendeve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të procesit të stabilizimit e asocimit dhe të Instrumenteve Paraprake për Anëtarësim (IPA), e manifestuar në konkluzionet

e disa mbledhjeve të Komisionit Evropian e të trupave të tjera të Bashkimit Evropian dhe në marrëveshjet e arritura për fillimin e bisedimeve për anëtarësim me disa vende të rajonit, ishin indikatorë të qartë edhe për institucionet e Kosovës për angazhim të përshpejtuar në drejtim të plotësimit të standardeve dhe të përshtatjes kërkesave paraprake për anëtarësim në BE. Megjithëse arsimi nuk paraqitet në kuadër të "communitaire acquais" (kushteve formale për anëtarësim në BE), prapëseprapë konventat e ndryshme në fushën e arsimit paraqiten si standarde të domosdoshme për ecje në drejtim të integrimeve evropiane.

Në kontekstin më të gjerë ndërkombëtar gjejmë një botë që karakterizohet nga ndryshime të shpejta, nga globalizimi në rritje dhe nga ndërlikueshmëria gjithnjë më e madhe e marrëdhënieve shoqërore, kulturore dhe ekonomike, të udhëhequra gjithnjë e më shumë nga informata dhe nga dija. Dhe këto nuk mund të mendohen pa praninë e gjithanshme të kompjuterëve dhe të teknologjisë së informimit e të komunikimit. Një kontekst i tillë i ndryshimeve marramendëse doemos duhet të reflektohet në objektivat e ardhshme të sistemeve të arsimit e të aftësimit dhe në çfarëdo planifikimi strategjik në arsim apo në cilindo sektor tjetër të shoqërisë.

Në anën tjetër qëndrojnë standardet e përcaktuara në Programin e Reformave të Arsimit Evropian deri në vitin 2010 dhe Deklarata përkatëse e Lisbonës, në Konventën Evropiane të Kopenhagës për arsimin dhe aftësimin profesional dhe procesin që filloi atje, apo edhe objektivat e procesit që filluan me Deklaratën e Bolonjës dhe me deklaratat pasuese të Pragës (2001), Berlinit (2003), të Bergenit (2005) dhe piketat për zhvillim të harmonizuar gjithandej Evropës të vendosura në këto dokumente. Të gjitha këto dokumente e procese e kanë ndryshuar thelbësisht kontekstin më të gjerë rajonal e evropian të arsimit kosovar. Ky kontekst i ri ka kërkuar doemos edhe strategji, politika e qasje të reja të sistemit e të komunitetit arsimor kosovar. Të gjitha këto, së bashku me nismën Arsimi për të Gjithë të UNESCO-s, janë trajtuar nga ekspertë arsimorë kosovarë e ndërkombëtarë, të përfshirë në procesin e hartimit të strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2007 – 2017.

## 2.2. Arritjet dhe dobësitë e sistemit të arsimit

### 2.2.1. Kapacitetet menaxhuese të sistemit

Sistemi kosovar i arsimit doli nga periudha e izolimit të gjatë dhe nga lufta e fundit të viteve të nëntëdhjeta pothuajse tërësisht i shkatërruar si nga aspekti i infrastrukturës fizike, ashtu edhe për nga kapacitetet dhe resurset njerëzore.

## 2. Arsimi parauniversitar në Kosovë – gjendja e tanishme

Në kuptimin e udhëheqjes dhe menaxhimit, sistemi arsimor në periudhën e pasluftës karakterizohej nga:

a) motivimi i lartë i administratës dhe udhëheqjes vendore arsimore për të përmirësuar performancën e sistemit arsimor dhe

b) për nga prania e një numri të madh të ekspertëve e administratorëve ndërkombëtarë të arsimit si në kuadër të strukturave të UNMIK-ut, ashtu edhe në organizatat e shumta joqeveritare ndërkombëtare, të angazhuara aso kohe në programe të ndryshme të mbështetjes së arsimit kosovar.

Motivimi i lartë i udhëheqjes dhe i administratës vendore kishte bërë që programet e ndryshme aftësuese të hasin në hapësi dhe receptivitet të theksuar të zyrtarëve e të administratorëve të cilët aftësoheshin në këto programe. Kjo e kishte ngritur dukshëm efektivitetin e programeve trajnuese, por kishte pasur ndikim edhe në ngritjen e efikasitetit të menaxhimit të institucioneve arsimore dhe të drejtimit të sistemit në përgjithësi. Programet aftësuese të udhëheqjes arsimore ishin organizuar ose/dhe bashkërenditur fillimisht nga Projekti Kanadez për Aftësimin e Mësimdhënësve Kosovarë (KEDP), e cila deri në vitin 2004 ka funksionuar edhe si agjenci udhëheqëse në fushën e aftësimeve. Prej vitit 2000 deri në vitin 2005, rreth 700 udhëheqës arsimorë kishin kaluar nëpër ndonjë formë të aftësimit të udhëheqjes arsimore në nivele të ndryshme të administratës, të institucioneve dhe të sistemit. Siç do të shihet më vonë, këtyre programeve u mungonte qëndrueshmëria institucionale dhe thellësia e trajtimit të problemeve të udhëheqjes, por, megjithatë, këto kishin luajtur rol të pazëvendësueshëm në sigurimin e shërbimeve themelore arsimore në fillim (1999 – 2001 faza emergjente) dhe në ngritjen e cilësisë së këtyre shërbimeve në fazën e konsolidimit të sistemit (2002 – 2005).

Një karakteristikë tjetër e kësaj periudhe ishte shkëmbimi i drejtpërdrejtë i përvojave të udhëheqjes arsimore ndërmjet zyrtarëve të shumtë ndërkombëtarë dhe të atyre vendorë. Ky aftësim i gjallë dhe pa shkëputje nga puna kishte ndodhur në të gjitha nivelet e administratës e të udhëheqjes arsimore me efekt të drejtpërdrejtë në cilësinë e udhëheqjes e të menaxhimit. Vetëm në administratën qendrore të MASHT-it, në vitin 2002, ishin të angazhuar më se 30 zyrtarë, ekspertë e këshilltarë ndërkombëtarë. Për ilustrim, në atë kohë administrata qendrore e MASHT-it kishte 50 zyrtarë vendorë. Të tjerë ekspertë ishin të angazhuar në nivel rajonal, në organizata të ndryshme joqeveritare dhe në projekte të tjera mbështetëse qeveritare, të cilët realizonin bashkëpunim të përditshëm me udhëheqjen arsimore kosovare në të gjitha nivelet. Në mënyrë graduale dhe paralelisht me ngritjen e aftësive menaxhuese e udhëheqëse të udhëheqjes vendore

ndodhte edhe bartja e autorizimeve dhe e kompetencave nga zyrtarët e UNMIK-ut e nga agjenci udhëheqëse tek zyrtarët vendorë. Ky ishte një proces i kontrolluar i transferimit të kompetencave dhe i ngritjes e i zhvillimit të kapaciteteve për qeverisje në sistemin arsimor kosovar. Si rezultat i këtij procesi kishte një demokratizim të udhëheqjes arsimore, u shënuan ndryshime pozitive në vetë sistemin dhe u përmirësuan e u humanizuan deri diku ambienti dhe kushtet e punës. Një prej efekteve të këtij demokratizimi ishin edhe nisma të ndryshme për përmirësimin e menaxhimit, përfshirja më e madhe e palëve të interesuara në udhëheqjen e shkollës (të përfshira edhe në legjislacionin në fuqi) si dhe, përfundimisht, ngritja relative e cilësisë së shërbimeve arsimore. Në fund, ndër segmentet e udhëheqjes arsimore në të cilat ishte punuar mjaft, por që mbetej të bëhej edhe më, ishin: (a) institucionalizimi i programeve aftësuese të udhëheqjes arsimore, (b) ristrukturimi dhe zhvillimi i personelit të administratës qendrore të MASHT-it, (c) përfshirja më e gjerë e palëve të interesuara, (d) sigurimi i informatave më relevante dhe më të krahasueshme në lidhje me populacionin e sistemit arsimor, si dhe (e) profilizimi dhe ndarja e funksioneve administrative nga ato profesionale në nivel të administratës qendrore të MASHT-it.

• • •

Mungesa e institucioneve dhe e programeve të qëndrueshme për aftësim të administratës arsimore, mungesa e ofruesve të pavarur të shërbimeve aftësuese, sensibilizimi i pamjaftueshëm i komunitetit, mungesa e informatave dhe e analizave për nevoja aftësuese dhe centralizimi i tepruar i sistemit ishin konstatuar aspekte të qeverisjes, si rrjedhojë e të cilave kishte politizim relativ të arsimit, kufizim të autonomisë së shkollës, ndikim tek udhëheqja tradicionale e institucioneve arsimore dhe tek përfshirja e pamjaftueshme e komunitetit në çështjet e shkollës. Përfundimisht, këto kishin shkaktuar vështirësi në udhëheqjen e në menaxhimin e institucioneve arsimore (pavarësisht nga konstatimi se procesi kishte ngritje dhe  zhvillim gradual në pjesën e arritjeve të analizës).

Kjo cilësi e udhëheqjes dhe e menaxhimit kishte sjellë deri te lëshime të konsiderueshme gjatë punësimit të personelit, mosshfrytëzim të duhur të resurseve njerëzore, mungesë të monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit, si dhe mungesë të të dhënave të besueshme për sistemin e arsimit. Të gjitha këto, bashkë me përcjelljen joadekuate të nxënësve pas largimit nga institucioni i tyre arsimor, dukej të kishin qenë ndër arsyet për cilësi të pakënaqshme të shërbimeve arsimore.

Shqyrtimi i arritjeve tregoi se ‘ishin krijuar parakushtet për një proces të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve për qeverisje dhe udhëheqje’, ndërsa shqyrtimi i dobësive

sinjalizoi për çfarësi 'të pakënaqshme të udhëheqjes dhe qeverisjes arsimore'. Bazamenti për trajtim dhe tejkalim të dobësive u krijua duke ndërtuar mbi praktikat e mira të arritjeve dhe duke propozuar masa konkrete për arritjen e objektivave të përcaktuara – gjithnjë në suaza të vizionit dhe të misionit të definuar bashkërisht të sistemit arsimor të Kosovës.

### 2.2.2. Cilësia dhe efektiviteti

Së bashku me tërë shoqërinë kosovare, sistemi arsimor i Kosovës ka kaluar nëpër procese intensive transformuese nga gjendja emergjente e pasluftës deri në fazën konsoliduese e zhvillimore të vitit 2005. Pos masave të domosdoshme në fushën e legjislacionit e të infrastrukturës gjatë fazës emergjente, realitetet e reja të krijuara në shoqërinë kosovare u përcollën edhe me masa më tipike softuerike në sektorin e arsimit, të cilat, me kalimin e kohës do të siguronin cilësi dhe efektivitet më të lartë të shërbimeve arsimore. Gatishmëria për ndryshime në radhët e komunitetit arsimor në Kosovë përbënte një sfond të domosdoshëm konstruktiv dhe garanci për sukses të masave të reja. Masat e para u ndërmorën për të vendosur shtyllat kryesore mbi të cilat do të zhvilloheshin veprimet e ardhshme reformuese në sistemin arsimor kosovar. Për këtë qëllim, me mbështetjen e UNICEF-it filloi puna për hartimin e Kornizës së Re Kurrikulare të Kosovës, filloi zbatimi i programeve intensive të aftësimit të mësimdhënësve dhe u vendos struktura e re 5 – 4 – 3 (4) e arsimit parauniversitar në Kosovë.

Me një prapavështrim pesëvjeçar mund të konstatojmë se vitet e para të ringjalljes së arsimit kosovar përqendroheshin rreth reformës kurrikulare, përfshirë metodat e mësimdhënies, përmbajtjen e programeve, tekstet shkollore, vlerësimin e nxënësve dhe filozofitë e qasjet e reja në arsim. Shkolla inkluzive, pilotimi i qasjeve të reja, mësimi me nxënësin në qendër, projekti "Shkolla mike e fëmijës", projekte të shumta për kyçjen e komunitetit në qeverisje dhe në përkrahje të shkollës, projekte për demokratizimin e raporteve të faktorëve arsimorë, metodat e reja dhe të shumëllojshme për vlerësimin e njohurive, shkathtësive dhe shprehive të nxënësve etj., ishin vetëm disa nga 'risitë' e shumta në zbatim, që pothuajse kishin vërshuar shkollat tona gjatë dy-tri viteve të para të pasluftës. Me gjithë mungesën e një qasjeje të planifikuar e më sistematike në zbatimin e këtyre risive, prapëseprapë, gjëja e parë që bie në sy gjatë vizitave në shkollat tona është fryma e re me renditje të re të bankave, raporte më të lira mësimdhënës – nxënës, vlerësimi i shumëllojshëm, vetëdija e shtuar për të drejtat e fëmijëve e të tjera.

Në fund, vërehet se planprogramet e reja (për arsimin e përgjithshëm dhe për arsimin profesional), tekstet e reja shkollore, metodat e reja të mësimdhënies dhe mënyrat e reja të vlerësimit kanë ndikuar në ngritjen e cilësisë së shërbimeve arsimore dhe të efektivitetit të sistemit arsimor.

• • •

Megjithatë, ekspertët kanë vërejtur se edhe më shumë mundet dhe duhet të bëhet në segmente të ndryshme të realitetit arsimor në Kosovë.

Ata konstatuan mungesën e mekanizmave dhe institucioneve përkatëse për akreditim, për sigurim të cilësisë, për vendosjen e standardeve dhe për vlerësim të jashtëm; po ashtu u theksua mungesa e një Këshilli Kombëtar funksional për planprograme dhe tekste shkollore, mungesa e kapaciteteve për hulumtime në arsim, si dhe mungesa e politikave afirmative për hartimin, botimin dhe shpërndarjen e teksteve dhe mjeteve shkollore. Të gjitha këto dhe rrethana të tjera, si mungesa e kapaciteteve të duhura njerëzore dhe jostabiliteti shoqëror e ekonomik, kishin shkaktuar mosfunksionim të duhur të sistemit për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë, planprograme të ngarkuara shkollore me mangësi të theksuara sa i përket ndërmarrësisë dhe me përqendrim në dije në vend të sigurimit të shkathtësive, të cilat paraqesin edhe rrëshqitje nga Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës. Pos kësaj, ka probleme lidhur me përcaktimin e nocionit të shkathtësive bazë (prezantuese apo ndërpersonale, individuale apo shoqërore, teknike apo profesionale, në formë të vetëdijes artistike e kulturore e të tjera). Natyrisht, pamundësia e një përkufizimi të tillë ka ndikuar edhe në moszbatimin e tyre në planprogramet e zhvilluara mësimore.

Ndërkaq, sa u përket teksteve shkollore dhe mjeteve të tjera didaktike u theksua mungesa e burimeve alternative të informacionit, mungesa e teksteve të arsimit profesional, mungesa e literaturës dhe teksteve në lëndë të caktuara dhe mungesa relative e cilësisë së teksteve të punuara në bazë të planprogrameve të reja.

Si rezultat i të gjitha këtyre, pa marrë para sysh sukseset relative, kemi një situatë me cilësi të pakënaqshme të shërbimeve arsimore. Kjo situatë kërkon hartimin e politikave, strategjive dhe ndërtimin e mekanizmave për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe të efektivitetit të sistemit. Në këtë kuptim, u theksua nevoja e përqendrimit në aftësimin e mësimdhënësve, në vendosjen dhe zbatimin e standardeve kombëtare, në avancimin e metodave të vlerësimit dhe në përmirësimin e kontekstit arsimor – të gjendjes materiale dhe të infrastrukturës fizike – gjithnjë me qëllim përfundimtar përmirësimin e cilësisë së përgjithshme.

## 2.2.3. Përfshirja dhe barazia në arsim

Arsimi kosovar në vitet e fundit ka arritur shumë në rritjen e përfshirjes dhe në krijimin e kushteve për barazi më të madhe të ofertës dhe të cilësisë arsimore për të gjithë qytetarët e Kosovës. Një gjë e tillë është arritur në saje të realitetit të ri të krijuar pas luftës si rezultat i angazhimit maksimal të zyrtarëve e ekspertëve vendorë dhe i mbështetjes së madhe të bashkësisë ndërkombëtare.

Kjo është arritur duke zgjeruar ofertën arsimore (kryesisht në lëmin e arsimit joformal), duke promovuar dhe zbatuar filozofinë e arsimit inkluziv, duke demokratizuar përmbajtjet dhe praktikat arsimore, si dhe duke siguruar qasje të barabartë minoriteteve në nivele të ndryshme të vendimmarrjes në sistemin arsimor. Konkretisht, shumica e mësimdhënësve dhe e punëtorëve të administratës janë përfshirë në programe të ndryshme aftësuese, me qëllim të demokratizimit të marrëdhënieve në shkollë dhe për bartjen e praktikave të mira të ndërveprimit si brenda shkollës, ashtu edhe ndërmjet shkollës dhe komunitetit. Kujdes i veçantë gjatë kësaj kohe i është kushtuar përfshirjes në arsim të grupeve të ashtuquajtura të rrezikuara. Në këtë drejtim është organizuar mësimi intensiv me 3,580 nxënës të komuniteteve RAE, prej të cilëve 865 kanë vazhduar shkollimin e rregullt. Është në proces mësimi intensiv për 329 nxënës të moshës prej 9-16 vjeçare. Futja në zbatim e klasës së nëntë, masat e diskriminimit pozitiv për pjesëtarët e komuniteteve pakicë në Kosovë (për kokë nxënësi ndahen 25 % më shumë mjete dhe lejohet të punësohen 30 % më shumë mësimdhënës për numrin e njëjtë të nxënësve), zbatimi i praktikave në klasë dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike në shkolla kanë ndikuar në ngritjen e dukshme të përfshirjes së fëmijëve e të rinjve në nivele përkatëse të shkollimit në Kosovë. Kështu, përfshirja e fëmijëve në shkollimin e obligueshëm ka arritur masën 97 %, ndërkaq përfshirja, sidomos e vajzave, në shkollimin e mesëm të lartë është rritur për 30 % prej vitit 1999 deri në vitin 2004. Në këtë drejtim ka ndihmuar sidomos projekti i Bankës Botërore për rritjen e pjesëmarrjes në arsim. Ky projekt i Bankës Botërore ka ndihmuar në mënyra të ndryshme realizimin e planeve zhvillimore të shkollës, duke mbështetur projekte të ndryshme të nxjerra nga këto plane. Më shumë se 500 shkolla fillore dhe të mesme anekënd Kosovës kanë përfituar ndihmë financiare prej 5,000 deri 15,000 euro gjatë viteve 2003 – 2006 në kuadër të këtij projekti. Një vlerë tjetër e madhe e këtij projekti ka qenë edhe aktivizimi i komunitetit (ndonjëherë edhe në masë 100 % të shumës së ndarë nga BB-ja), të komunave (të cilat kanë qenë shumë aktive në ekipet komunale për vlerësimin e projekteve). Rol me rëndësi në ngritjen e përfshirjes në sistemin arsimor dhe në promovimin e në zbatimin e filozofisë së gjithëpërfshirjes kanë luajtur faza e parë dhe e dytë e Programit Finlandez për Mbështetjen e Arsimit Special në Kosovë

(FSDEK). Në kuadër të këtij projekti janë aftësuar rreth 100 ekspertë në programin dyvjeçar për zhvillim profesional, 15 të tjerë janë aftësuar në studime pasdiplomike për master në arsimin inkluziv, dy ekspertë janë dërguar në studime të doktoratës, me dhjetëra mësimdhënës janë aftësuar për mësim të fëmijëve me nevoja të veçanta, duke u themeluar edhe dy qendra burimore për arsimin e tyre etj.

Megjithëse shkollimi i fëmijëve tanë në diasporë nuk ndikon drejtpërsëdrejti në përfshirjen e fëmijëve në sistemin arsimor të Kosovës, Ministria e Arsimit po ashtu i ka kushtuar rëndësi edhe programeve arsimore, teksteve e mjeteve mësimore dhe bashkëpunimit me mësimdhënësit shqiptarë të Kosovës në diasporë, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe përfshirjes së këtyre fëmijëve në mësim plotësues në gjuhën shqipe. Për këtë qëllim janë organizuar seminare aftësuese, por edhe aktivitete të tjera për shkëmbimin e përvojës dhe të praktikave të mira ndërmjet Kosovës dhe diasporës shqiptare.

• • •

Pavarësisht nga arritjet e konsiderueshme, që ishin rezultat i angazhimit të madh të ekspertëve e zyrtarëve vendorë e ndërkombëtarë, përfshirja e fëmijëve dhe e të rinjve në sistemin arsimor të Kosovës ende nuk mund të krahasohet me qasjen që sigurohet në vendet e zhvilluara, gjë që vlen në veçanti për edukimin parashkollor dhe shkollimin e mesëm të lartë.

Kështu, për shkak të mungesës së mjeteve të nevojshme financiare, ndonjëherë edhe për arsye të mungesës së vetëdijes për rëndësinë e arsimit, për shkak të mungesës së politikave adekuate arsimore që promovojnë përfshirjen, si dhe për shkak të nivelit të ulët të bashkëpunimit ndërsektorial me qëllim të ngritjes së përfshirjes në arsim, në Kosovë ka ende zbrazëti në përfshirjen arsimore. Kjo vlen veçanërisht për përfshirjen e vajzave në të gjitha nivelet e shkollimit dhe për mungesën e përfshirjes së duhur të fëmijëve me nevoja të veçanta. Gjatë procesit të hartimit të strategjisë ishte konstatim i përgjithshëm se sistemi arsimor kosovar nuk ofron kushte të duhura për gjithëpërfshirje. Kjo rrethanë është shprehur qoftë në kuptimin gjeografik (përfshirja e ulët në viset rurale), në kuptimin gjinor (përfshirja më e ulët e vajzave), në kuptimin e nevojave në nxënie (nxënësit me nevoja të veçanta dhe me vështirësi në nxënie) dhe në aspektin e grupeve të ndryshme (grupet e ndjeshme dhe ato të rrezikuara). Një situatë e këtillë ishte manifestuar me braktisje të shkollës, me numrin e shtuar të analfabetëve funksionalë dhe në fund të fundit me qytetarë që përballen me vështirësi për t'u integruar në shoqëri.

Të gjitha këto rrethana, vështirësi, probleme dhe manifestimet e tyre përkatëse paraqesin sfidat me të cilat janë përballur hartuesit e kësaj Strategjie për të realizuar të drejtën universale për shkollim dhe njëherësh synimet e nismës së UNESCO-s - Arsimim për të Gjithë (Education For All), si kusht themelor për një shoqëri demokratike, e cila plotëson nevojat e anëtarëve të saj për zhvillim normal personal e kolektiv. Një sfidë tjetër do të jetë nevoja për të krijuar kushte për nxënie gjatë tërë jetës, qoftë për arsye të avancimit në vendin e punës, për rikualifikim, për të mbijetuar në tregun e punës apo për zhvillim personal profesional, me qëllim të përcjelljes së ndryshimeve marramendëse teknologjike e ekonomike, por edhe shoqërore.

## 2.2.4. Përgatitja dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Gjatë procesit të hartimit të strategjisë kishte konsensus të përgjithshëm për rëndësinë prioritare të cilësisë së mësimdhënies, por edhe të programeve të ndryshme të aftësimit e të përgatitjes së mësimdhënësve. Po ashtu kishte pajtim të përgjithshëm për arritjet e shumta të ringjalljes dhe të reformimit të mësimdhënies për një periudhë të shkurtër gjashtëvjeçare prej përfundimit të luftës dhe të izolimit dhjetëvjeçar nga rrjedhat e mësimdhënies në rajon e në botë. Përqendrimi i programeve për përgatitjen e mësimdhënësve në Fakultetin e ri të Edukimit, përfshirja e më se 7,000 mësimdhënësve në programe të shumta aftësuese nga qasja me nxënësin në qendër e filozofitë e reja të mësimdhënies (si gjithëpërfshirja, ndërveprimi dhe përqendrimi më i madh në shkathtësitë), themelimi dhe puna e Këshillit për Shqyrtimin e Aftësimit të Mësimdhënësve, themelimi dhe puna e qendrave didaktike, puna e Programit Kanadez për Aftësimin e Mësimdhënësve, zbatimi nga ana e Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC) i programit “Hap Pas Hapi” dhe aftësimi e certifikimi i më se 3,000 mësimdhënësve në programin “Zhvillimi i Mendimit Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit” (MKLSH) nga po kjo organizatë, si dhe ndërtimi i kapaciteteve të MASHT-it e të zyrave rajonale të arsimit në fushën e avancimit të mësimdhënies ishin vetëm disa nga arritjet e konstatuara, të cilat kishin ndikuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe në ndryshimin e raporteve në klasë. Pos këtyre masave institucionale e programore, ishin zhvilluar edhe politikat dhe rregulloret e nevojshme që kishin siguruar qëndrueshmëri të ndryshimeve, ishin ndërtuar më shumë kapacitete trajnuese vendore dhe ishin hartuar dhe publikuar botime të ndryshme për zhvillim profesional të mësimdhënësve. Gjatë punës së grupeve të ekspertëve u vlerësua shumë prania e përvojës dhe e ekspertizës kanadeze në fushën e mësimdhënies dhe të aftësimit të mësimdhënësve. Programi Kanadez për Aftësimin e Mësimdhënësve Kosovarë

(KEDP) kishte luajtur rol të pazëvendësueshëm në bashkërenditjen e përpjekjeve të organizatave të ndryshme që kishin ofruar programe aftësimi, kishin ndihmuar në hartimin e rregulloreve dhe të politikave në fushën e aftësimit të mësimdhënësve, kishin ndihmuar në themelimin e Fakultetit të Edukimit, kishin organizuar seminare të shumta trajnimi dhe kishin organizuar botimin e literaturës së nevojshme për aftësim dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve.

• • •

Megjithatë, pavarësisht nga arritjet dhe përpjekjet e organizuara të institucioneve vendore e ndërkombëtare, grupet e ekspertëve konstatuan edhe vështirësi e probleme të shumta në fushën e mësimdhënies e të përgatitjes së mësimdhënësve në Kosovë. Në rend të parë, u theksua numri i madh i mësimdhënësve të pakualifikuar në shkollat kosovare (prej 15 deri 18 % nga numri i përgjithshëm), mungesa e një baze relevante të të dhënave në fushën e mësimdhënies, mungesa e rregulloreve për akreditim të programeve e të organizatave për aftësim të mësimdhënësve, vonesat në fillimin e zbatimit të licencimit të mësimdhënësve dhe, sidomos, problemet me nivelin e ulët të të ardhurave të mësimdhënësve dhe sistemin e gabuar dhe jomotivues të kompensimit për punën e kryer. Mospërfshirja e të gjithë mësimdhënësve në programet e aftësimit dhe thellësia e programeve trajnuese ishin disa brenga të tjera, që kërkonin trajtim urgjent nga ekspertët në kuadër të procesit të hartimit të strategjisë.

Të gjitha këto probleme të konstatuara në fushën e mësimdhënies e theksuan edhe më rëndësinë e mësimdhënies cilësore për të siguruar një sistem cilësor dhe efektiv të arsimit. Për këtë arsye, doli si sugjerim i përbashkët që, tani, pas përfundimit të reformës së planprogrameve të zhvillohen politikat, programet dhe projektet përkatëse që do të zhvendosnin përparësinë e trajtimit nga procesi i planprogrameve në fushën e aftësimit dhe përgatitjes së mësimdhënësve. Po ashtu, një sfidë e rëndësishme që u rekomandua për trajtim nga ky grup dhe nga grupi për financa ishte edhe propozimi i reformimit të sistemit të pagave në sektorin e arsimit, në mënyrë që të sigurohet sistem më i drejtë dhe më motivues i kompensimit të personelit arsimor i bazuar në meritë, përvojë, në shkathtësitë dhe në shkallën e kualifikimit.

### 2.2.5. Infrastruktura

U deshën investime domethënëse të donatorëve të shumtë ndërkombëtarë, të institucioneve vendore, por edhe investime të komunitetit për të mundësuar një fillim në kushte relativisht normale të vitit shkollor 1999 – 2000. Donatorët ndërkombëtarë, të

prirë nga UNICEF-i, nga Agjencia Evropiane për Rindërtim (në fillim ECHO) dhe nga donatorë të tjerë, si Banka Islamike për Zhvillim dhe shtete individuale, si Gjermania, Zvicra, Holanda, Danimarka, Japonia e të tjerë, investuan shuma të konsiderueshme për të krijuar kushte fizike për organizim të mësimit pas shkatërrimeve të fundit të viteve të nëntëdhjeta dhe të mungesës së çfarëdo mirëmbajtjeje nga shteti në shkollat kosovare për më se njëzet vjet. Këto përpjekje, së bashku me pajisjen e shkollave me mjete të ndryshme dhe me teknologji informative dhe zhvillimi i programeve për promovimin e shkollave të shëndetshme, ndikuan në përmirësimin e mjedisit për mësimdhënie dhe nxënie dhe, si rezultat i kësaj, edhe në krijimin e parakushteve për mësim më cilësor. Më vonë u shtuan përpjekjet për përmirësimin e infrastrukturës fizike për të plotësuar kërkesat e fëmijëve me nevoja të veçanta konform politikave për arsim gjithëpërfshirës. Pas vitit 2002 kishte një zhvendosje graduale të barrës së investimeve për sigurimin e infrastrukturës fizike nga donatorë të ndryshëm tek institucionet vendore. Në periudhën 2002-2005, MASHT-i ka financuar rinovimin e 39 objekteve shkollore me vlerë të përgjithshme 1,8 milionë € dhe ndërtimin e 28 objekteve të reja shkollore në vlerë prej mbi 8 milionë €.

• • •

Të gjitha këto përpjekje gradualisht përmirësuan dukshëm kushtet fizike të mësimit në arsimin kosovar. Megjithatë, deri në vitin 2002, këto investime janë bërë vetëm në bazë të kërkesave të komunitetit dhe në bazë të vlerësimit të organizatave të ndryshme donatore. Në atë kohë mungonte një qasje e planifikuar dhe sistematike e trajtimit të problemit të infrastrukturës shkollore. Një përjashtim ishte baza e të dhënave e krijuar nga Grupi Ndërkombëtar i Menaxhimit (IMG), agjenci e financuar nga Bashkimi Evropian, ku janë përfshirë të gjitha objektet shkollore sipas incizimit në vitin 1999. Kësisoj, shumica e shkollave të ndërtuara pas luftës u ndërtuan në vendet e shkollave të vjetra të kohës së paraluftës. Kishte edhe raste ekstreme kur nuk ishte marrë parasysh lëvizja e popullatës nga një zonë (kryesisht rurale) dhe shkolla e re ishte ndërtuar për nevoja të një numri shumë të vogël të nxënësve. Një shpërputhje e tillë ndërmjet lëvizjeve demografike dhe ndërtimit e renovimit të shkollave ishte evidente në pjesë të shumta të Kosovës dhe rrjedhimisht, disa qytete përfunduan me shkolla të mbingarkuara dhe me mësim në më shumë se dy ndërrime, në kohën kur në disa fshatra kishte hapësirë për zhvillim të mësimit tërëditor. Për mungesë të një veprimi të organizuar, po ashtu kishte raste të instalimit të kompjuterëve dhe të teknologjisë moderne në objekte shkollore që kishin mungesë të vazhdueshme të rrymës elektrike.

Në anën tjetër, kishte lëshime të shumta edhe në mënyrën e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të objekteve të reja shkollore, bashkëpunim të pamjaftueshëm të komunitetit, procedura të ndërlikuara të menaxhimit financiar e të prokurimit, mungesa buxhetore për mirëmbajtje e menaxhim, menaxhimit të gabuar ose keqmenaxhimit të mjeteve dhe pajisjeve të sjella, e të tjera, të cilat kanë ndikuar në rënien e efektit të investimeve të konsiderueshme në këtë sektor dhe në rënien e cilësisë së punës për shkak të infrastrukturës fizike.

Një situatë e këtillë kërkon përpjekje të planifikuar mirë për të maksimizuar efektin e mjeteve të investuara pas luftës dhe për të prodhuar sa më shumë cilësi në shërbimet arsimore për njësi të mjeteve të investuara. S'do mend që sigurimi i kushteve më të mira teknologjike dhe zgjerimi i hapësirës fizike do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimit. Planifikimi i masave për sigurimin e punës në së paku dy ndërrime deri në vitin 2010 dhe sigurimi i zhvillimit të balancuar teknologjik dhe infrastrukturor në mes të zonave rurale dhe urbane mbesin dy sfidat kryesore të kësaj strategjie dhe të punës së institucioneve arsimore në periudhën e ardhshme afatmesme.

Këto probleme, së bashku me prioretizimin më të madh të teknologjisë informative në procesin mësimor, janë trajtuar nga grupi përkatës dhe janë propozuar masat konkrete për përmirësimin e situatës në mënyrë që, përfundimisht, infrastruktura dhe teknologjia informative të jenë në funksion të drejtpërdrejtë të ngritjes së cilësisë.

## 2.2.6. Arsimi dhe shoqëria

Në këtë fushë problemore ishte me rëndësi të shihej ndërveprimi dhe ndikimi i ndërsjellë ndërmjet shoqërisë dhe arsimit. Kështu, gjatë diskutimeve u shqyrtua nëse arsimi e gëzonte ende prioritetin që e kishte gjatë viteve të nëntëdhjeta të funksionimit në kushte krejtësisht të jashtëzakonshme dhe, nëse arsimi ruante ende po atë ndikim në shoqëri sikur gjatë asaj kohe kur ishte motor dhe shtyllë e të gjitha zhvillimeve shoqërore. Diskutimi tregoi se arsimi në periudhën e pasluftës ishte prioritet i shoqërisë vetëm në letër dhe në nivel të deklaratave pasi që pjesa më e madhe proporcionale e buxhetit kishte shkuar në ndihma sociale, ndërkaq në qendër të vëmendjes e të veprimit politik ishin çështjet që kishin të bënin me statusin dhe me plotësimin e standardeve. Në anën tjetër, u konstatua se as arsimi nuk ishte më forcë motorike e zhvillimeve apo e zhvillimit shoqëror e ekonomik. Kështu, pos rasteve të rralla, bashkëpunimi i arsimit me institucione, me komunitetin dhe me entitete ekonomike pothuajse nuk ekzistonte fare.

## 2. Arsimi parauniversitar në Kosovë – gjendja e tanishme

Pavarësisht nga të gjitha këto, në periudhën e pasluftës ishin bërë disa përpjekje për ndryshimin e legjislacionit në funksion të ndërveprimit dhe rritjes së rolit të arsimit në shoqëri dhe të ndikimit të komunitetit në arsim. Kështu, pjesëtarët e komunitetit fituan shumicën vendimmarrëse në këshillat e shkollave, ndërkaq këshillat prindër/arsimtarë në të gjitha nivelet e shkollimit në Kosovë kishin fituar rol partneriteti në udhëheqjen e sistemit të arsimit në Kosovë në përputhje me rregulloret përkatëse të MASHT-it. Organizatat UNICEF dhe Catholic Relief Services (CRS) kishin luajtur rol të pazëvendësueshëm në drejtim të humanizimit të ambientit e të marrëdhënieve në shkollë, si dhe në hapjen e shkollës ndaj komunitetit. MASHT-i kishte provuar promovimin e hapjes së shkollave ndaj ekonomisë dhe komunitetit edhe duke lejuar hapjen e xhirollogarive për shkollat profesionale në rastet kur ato realizonin projekte të ndryshme me komunitetin ose me ekonominë, me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës (zbatimi i kësaj nisme po has në vështirësi për shkak të ligjeve financiare në Kosovë). Në të njëjtën kohë reforma e planprogrameve shkollore në Kosovë kishte krijuar parakushte për më shumë bashkëpunim me komunitetin dhe me ekonominë, duke i hapur programet mësimore dhe shkollat ndaj rrethinës së vet.

Planprogramet e arsimit profesional i përshtateshin dukshëm më mirë nevojave të tregut të punës dhe ofronin më shumë shkathtësi më se të nevojshme për popullatën e re të Kosovës. Në këtë drejtim, merita të veçanta kishte organizata shtetërore gjermane për bashkëpunim teknik ndërkombëtar GTZ (por edhe SwissContact dhe KosVet), të cilat kishin ndihmuar arsimin profesional në Kosovë në disa drejtime: kishin zhvilluar planprogramet për 11 profile profesionale, kishin mbështetur tetë shkolla profesionale pilot me pajisje teknologjike për profesionet përkatëse, kishin aftësuar udhëheqjen e MASHT-it dhe drejtorët e shkollave profesionale për menaxhimin e proceseve përkatëse, kishin trajnuar shumicën e mësimdhënësve në metodologjitë dhe qasjet e reja mësimore, kishin ndihmuar në zhvillimin e politikave dhe planeve strategjike zhvillimore në fushën e arsimit profesional e të tjera.

Projekte të ndryshme informimi dhe të orientimit në karrierë u kishin ndihmuar të rinjve të afrohen me ofertën arsimore të shkollave profesionale në Kosovë. Këto e kishin ndihmuar përfshirjen e komunitetit në aktivitetet e këtyre shkollave, por edhe e kishin rritur interesimin e të rinjve për ofertën e tyre arsimore.

• • •

Me gjithë arritjet relative, duket se raporti shoqëri – arsim mund të mbetet një ndër sfidat më të mëdha të kësaj strategjie. Arsyeja qëndron te kushtet e vështira në të cilat funksionon sistemi arsimor, për shkak të statusit të pavolitshëm të arsimtarit në

shoqëri, por edhe për shkak të mungesës së një ekonomie që do të absorbonte profilet e prodhuara nga sistemi arsimor. Gjithashtu ky raport mbetet sfidues, për shkak të mungesës së analizave të mirëfillta të trendëve dhe të nevojave të tregut të punës, kapaciteteve të kufizuara të institucioneve arsimore dhe shtetërore, mungesës së institucioneve të arsimit të lartë në fushën e studimeve të aplikuara, nivelit të vetëdijes në shoqëri dhe të bashkëpunimit të pamjaftueshëm ndërinstitucional dhe me komunitetin me qëllim të tejkalimit të vështirësive e të problemeve në arsim dhe në funksion të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror dhe ekonomik e të tjera.

Të gjitha këto kishin sjellë në një situatë kur mungonte autoriteti për përcaktimin dhe zbatimin e kualifikimeve, kur kishte shpërputhje ndërmjet nevojave të tregut dhe të profileve të ofruara në sistemin e arsimit, kur kishte pak ose aspak ndërlidhje ndërmjet ekonomisë dhe arsimit, kur orientimi në karrierë po haste në vështirësi të shumta, kur mungonte nomenklatura e profesioneve e të tjera. Kjo gjendje po e vështirësonte tej mase realizimin e vizionit dhe misionit të arsimit të vijëzuar në hyrje të këtij plani zhvillimor. Prandaj mbetet sfidë themelore e institucioneve arsimore kosovare që, brenda disa viteve të ardhshme, të mundësojnë që arsimi të vihet në funksion të zhvillimit ekonomik, të kohezionit social, të përgatitjes së individëve për jetë e për ekonomi, për të ofruar shkathtësitë për jetë dhe shkathtësitë kyçe, si dhe për të siguruar një sistem të mësimit gjatë tërë jetës, përmes të cilit njerëzit do të mund të përcillnin më mirë zhvillimet dhe ndryshimet e shpejta të teknologjisë dhe të tregut të punës.

Parakusht thelbësor për të arritur objektiva të këtilla është bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet të gjithë faktorëve relevantë për zhvillimin e arsimit në Kosovë. Në këtë kontekst, del i domosdoshëm angazhimi dhe bashkërenditja më e mirë ndërmjet MASHT-it, Ministrisë së Punës e Mirëqenies Sociale, Odës Ekonomike, entiteteve private e publike ekonomike, sektorit të shëndetësisë, Ministrisë së Kulturës, Rinisë, Sporteve e Çështjeve Jorezidente e institucioneve të tjera.

### 2.2.7. Pozita materiale e arsimit

Arsimi kosovar gjendet sot i ndrydhur ndërmjet kufizimeve buxhetore të shoqërisë së varfër kosovare dhe të vendosjes së gabueshme të prioriteteve nga ana e Qeverisë. Në vitin 2006 janë ndarë nga Buxheti i Kosovës rreth 4.9 % e Bruto Prodhimit Vendor (BPV) për nevoja të arsimit (parauniversitar e universitar), të shkencës dhe të teknologjisë, që në dukje nuk është larg nga mesatarja evropiane prej 5.22 %. Megjithatë, nëse kujtojmë se Kosova ka një strukturë jashtëzakonisht të dobët të të

hyrave buxhetore (pjesa kryesore realizohet nga taksat mbi importet) dhe, rrjedhimisht, një BPV shumë të ulët, krahasuar me vendet përreth, pasi që pothuajse nuk bazohet fare në prodhimin vendor, atëherë kuptojmë se çfarë mund të bëjnë institucionet arsimore me mjetet e siguruara nga këto përqindje.

Nëse kësaj i shtojmë edhe strukturën shumë jomotivuese të të ardhurave të mësimdhënësve, që aplikohet në nivel të Shërbimit Civil të Kosovës e të cilat ndahen në formë të rrafshuar si stipendion e jo si paga të bazuara në meritë, në përvojë e në kualifikime, atëherë kuptojmë gjendjen vërtetë të rëndë materiale të arsimit e të mësimdhënësve kosovarë, por kuptojmë edhe një pjesë të arsyeve të grevave të mësimdhënësve në këto tri vitet e fundit dhe nivelin relativisht të ulët të cilësisë së shërbimeve arsimore në Kosovë. Kjo gjendje ka ndikuar edhe në nivelin e ulët të investimeve kapitale, në sigurimin e teknologjisë informative, të pajisjeve dhe të mjeteve mësimore në shkollat tona.

Në këtë situatë nuk kanë ndihmuar as ndihmat e shumta nga donatorë ndërkombëtarë, të cilat kanë qenë të orientuara kah mbështetja e programeve e jo kah përmirësimi i gjendjes materiale të arsimit apo kah ristrukturimi i shpenzimeve për arsimin. Një orvatje për ristrukturim të sistemit të pagave në sektorin e shërbimit civil në Kosovë dështoi në vitin 2005, për shkak të mungesës së mjeteve financiare dhe rezultoi me greva të gjata të mësimdhënësve në të gjitha nivelet.

Kështu, infrastruktura e pamjaftueshme, rastet e keqpërdorimeve dhe shmangieve të detyrave zyrtare, statusi i pavolitshëm i punëtorëve arsimorë në shoqëri, pamundësia e avancimit të mësimdhënësve, për shkak të financimit të njëtrajtshëm të të gjithëve dhe, në përgjithësi, mungesa e mjeteve materiale, kanë shkaktuar një situatë të largimit të mësimdhënësve dhe ekspertëve nga sektori i arsimit dhe, përfundimisht, cilësi të pamjaftueshme të shërbimeve arsimore.

Ky aspekt i sistemit arsimor është dhe do të mbetet pika më e dobët dhe sfida më e madhe për secilën qeveri dhe ministri të arsimit, si edhe për këtë plan strategjik zhvillimor. Nuk mund të pritet zhvillim dhe përmirësim i cilësisë së shërbimeve arsimore pa sigurim të më shumë mjeteve financiare dhe pa një strukturë e sistem më adekuat të shpërndarjes së të ardhurave e të shpenzimeve në sektorin e arsimit.

Pas identifikimit dhe analizës së këtij aspekti dhe fushe problemore, njëkohësisht, edhe është identifikuar mbase problemi kyç i këtij sektori dhe mbetet sfidë gjetja e zgjidhjeve përkatëse për të hapur rrugë të domosdoshme për zhvillimin e arsimit. Masat e propozuara nga ekspertët në këtë strategji duhet të shërbejnë si detyrim për të gjithë

shoqërinë kosovare, me qëllim të zhvillimit të duhur të resurseve njerëzore si përparësi e vetme krahasuese e Kosovës në raport me vendet në rajon dhe me vendet evropiane. Kjo është mundësia dhe rruga e vetme e shoqërisë kosovare për zhvillim dhe për integrim të dinjitetshëm në rrjedhat dhe në familjen e vendeve të zhvilluara evropiane. Vetëm resurset e arsimuara dhe të trajnuara njerëzore do ta bëjnë Kosovës konkurruese në tregun evropian të punës e të dijes.

## 3. Parimet e zhvillimit të sistemit – Vizioni dhe misioni

### 3.1. Parimet për zhvillimin e sistemit të arsimit

Zbatimi praktik i Strategjisë për arsimin parauniversitar për periudhën 2007 – 2017 dhe shndërrimi i saj në një levë të fuqishme të ndryshimeve të organizuara të sistemit të tashëm të arsimit, udhëheqja dhe menaxhimi i suksesshëm i jetësimit të saj në praktikë, me qëllim që ndryshimet të arrijnë në klasë, laboratorë, kabinete, mësonjëtore të specializuara, do t'i kontribuojë respektimit të parimeve, tani qartë të përcaktuara, në bazë të të cilave realizohet zhvillim efikas dhe i pandërprerë i sistemit të arsimit.

Parimet mbi të cilat duhet të bazohet sistemi i arsimit parauniversitar në Kosovë, si rezultat i jetësimit të Strategjisë janë:

3.1.1. Parimi i dobisë, i përfitimit dhe i filantropisë
3.1.2. Parimi i haptësisë, i transparencës dhe i fleksibilitetit
3.1.3. Parimi i monitorimit, matjes dhe i vlerësimit
3.1.4. Parimi i efikasitetit dhe i efektivitetit
3.1.5. Parimi i drejtësisë dhe i pjesëmarrjes në arsim
3.1.6. Parimi i rregullimit dhe i krijimit të stabilitetit
3.1.7. Parimi i tërësisë
3.1.8. Parimi i interesit kombëtar

### 3.1.1. Parimi i dobisë, përfitimit dhe i filantropisë

Ndryshimet e nxitura dhe të nisura me Strategji, duhet të sjellin ndryshime pozitive, dobi dhe përfitime për të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga mosha, gjinia, përkatësia etnike, racore, fetare, statusi social dhe ekonomik, zhvillimi i tyre fizik, psikik fiziologjik dhe kulturor e çfarëdo përkatësie tjetër. Ky parim, buron nga qëllimi moral dhe human i ndryshimeve të orientuara në zhvillimin e burimeve njerëzore. Respektimi i këtij parimi në zhvillimin e sistemit të arsimit në Kosovë mundëson që njeriu, zhvillimi dhe mirëqenia e tij të jenë në qendër të vëmendjes së sistemit të arsimit. Ky parim zhvillimor mundëson që sistemi i arsimit të jetë me orientime të thella humaniste dhe filantrope, që të krijohet një shoqëri miqësore e bazuar në kultivimin e diversitetit të nevojave, kulturave, interesimeve dhe të bindjeve të ndryshme. Me fjalë të tjera, ky parim buron nga kërkesa e ndershmërisë dhe nënkupton që ndryshimet të jenë të ndershme e humane, sepse ndryshimet në sistemin e arsimit, që nuk bazohen në ndershmëri, e bëjnë atë të paqëndrueshëm, të padrejtë, diskriminues dhe prodhues të krizave dhe të konflikteve në shoqëri.

### 3.1.2. Parimi i haptësisë, i transparencës dhe i fleksibilitetit

Zhvillimi dinamik i sistemit të arsimit nuk është i mundur nëse ky nuk është i hapur ndaj nevojave dhe interesimeve të qytetarëve të Kosovës, pavarësisht nga diversiteti i tyre i moshës, etnik, racor, fetar, shoqëror - ekonomik, kulturor, gjinor etj. Parimi i haptësisë kërkon që sistemi i arsimit të ketë një zhvillim dinamik, të qëndrueshëm, të jetë i përputhshëm me përmasat e sistemeve të shteteve të zhvilluara, t'i kënaqë nevojat dhe interesimet e qytetarëve të Kosovës. Për t'i plotësuar këto nevoja dhe interesime, sistemi i arsimit duhet të jetë transparent dhe fleksibil. Kjo do të thotë se sistemi do të jetë në një proces të ndryshimit të përhershëm, për të qenë në gjendje që të plotësojë të gjitha nevojat e qytetarëve të Kosovës.

Respektimi i parimit të haptësisë, të transparencës dhe të fleksibilitetit është kusht i domosdoshëm për zhvillimin dinamik të sistemit të arsimit në Kosovë, sepse të gjitha propozimet për ndryshime dhe rinovime do të debatohen, do të diskutohen, ndërsa disa nga to edhe do të pilotohen. Në këtë mënyrë ndryshimet jo vetëm që bëhen transparente për opinionin, por numri i pjesëmarrësve në këto ndryshime shtohet në mënyrë të ndjeshme. Me ketë proces të zgjerimit të bazës së vendimmarrjes bëhet edhe demokratizimi i sistemit të arsimit, i cili, në anën tjetër, është kusht i domosdoshëm për zhvillim të hovshëm të tij.

Në përputhje me këtë parim do të vendoset një bashkëpunim i programuar strategjik me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe do të krijohen lidhje dhe bashkëpunime funksionale dhe kreative me agjenci ndërkombëtare, qeveritare dhe ndërqeveritare, që kanë mision avancimin e arsimit në përgjithësi.

### 3.1.3. Parimi i monitorimit, matjes dhe i vlerësimit

Sistemi i arsimit nuk mund të zhvillohet, të avancohet dhe të integrohet në sistemet bashkëkohore të arsimit pa një sistem shumë të sofistikuar dhe funksional të monitorimit, të matjes dhe të vlerësimit të procesit të edukimit, të arsimit dhe të arritjeve, si dhe të ndikimit të tij në zhvillimin dhe në demokratizimin e shoqërisë kosovare e në krijimin e një shteti ligjor të bazuar në drejtësi sociale. Andaj zhvillimi i sistemit të arsimit, në përgjithësi, dhe i arsimit parauniversitar, në veçanti, nuk mund të paramendohen pa krijimin e një sistemi pragmatik dhe funksional të mbledhjes së të dhënave sasiore e cilësore për procesin e edukimit dhe të arsimit, për rezultatet e arritjeve të fëmijëve, të nxënësve, të mësimdhënësve dhe të institucioneve të arsimit parauniversitar, si dhe të krahasimit të këtyre të dhënave me standardet e përcaktuara në nivelin

e shkollës, komunës, rajonit e në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar. Jetësimi i këtij parimi mundëson që në çdo kohë të dihet gjendja e sistemit të arsimit.

### 3.1.4. Parimi i efikasitetit dhe i efektivitetit

Ekzistenca e një sistemi funksional nuk qëndron në përshtatjen e sistemit, gjendjes reale, por në zhvillimet sasiore e cilësore, si të sistemit në tërësi, ashtu edhe të pjesëve të cilat e bëjnë atë tërësi. Ky parim kërkon që të krijohen mekanizma dhe politika të tilla zhvillimore, të cilat garantojnë zhvillim të pandërprerë sasior e cilësor të sistemit.

Që sistemi i arsimit të jetë efikas, ai duhet të prodhojë rezultate maksimale me shpenzime më të vogla të mundshme njerëzore, kohore, financiare e materiale. Ky parim kërkon që të krijohen mekanizma funksionalë për përcjelljen, matjen dhe vlerësimin sistematik të investimeve në arsim, të monitorohen mënyrat e alokimit të mjeteve, shfrytëzimi racional i burimeve të reja, hyrja në sistem si dhe dalja nga sistemi i arsimimit, procesi i qarkullimit të hyrjeve dhe të daljeve nga sistemi i arsimit.

Aspekti tjetër i këtij parimi është efektiviteti. Me efektivitet nënkuptohet jo sasia e arritjeve, por dobia e përfitimet që kanë qytetarët e Kosovës dhe shoqëria kosovare nga arritjet në arsim. Arsimi është efektiv, atëherë kur ai u sjell të mira të gjithë qytetarëve të Kosovës. Deri sa efikasiteti përcaktohet përmes analizave që bëhen duke vlerësuar sasinë e rezultateve të arritura dhe të burimeve të shpenzuara për arritjen e rezultateve maksimale, efektiviteti ka të bëjë me sigurimin e dobive sa më të mëdha me mjetet e dhëna.

Parimi i efikasitetit dhe i efektivitet duhet të sigurojë zhvillim maksimal të burimeve njerëzore, i cili sipas analizave të OECD-së, paraqet fitimin që buron nga arsimi, i cili mund të shprehet me të ardhura më të mëdha, me shkallë më të lartë të punësimit, me lidhje më të fuqishme me tregun e punës, me shëndetin publik më të mirë dhe me një varg tjetër të përfitimeve jovalutore.

### 3.1.5. Parimi i drejtësisë dhe i pjesëmarrjes në arsim

Parimi i drejtësisë kërkon që të gjithë qytetarët e Kosovës të kenë mundësi të barabarta të përzgjedhin llojin e arsimit dhe të edukimit. Parimi i drejtësisë mundëson që arsimi cilësor t'u sigurohet të gjithë qytetarëve te Kosovës e jo vetëm disave. Ky parim

thekson domosdoshmërinë e nxitjes dhe të krijimit të mundësive sociale dhe ekonomike për arsimimin e të gjithë nxënësve, pavarësisht nga mundësitë zhvillimore, gjinia, mosha, përkatësia etnike, racore e fetare dhe nga statusi social (Education For All, Dakar, 2000; Agjencia Evropiane për zhvillimin arsimit me nevoja të veçanta 2003a; Komisioni Evropian, 2002b; Konventa për të drejtat e fëmijës, Neni 2. KB 1989; Deklarata Botërore për arsimim për të gjithë – EFA 1996; Memorandumi për të nxënit gjatë gjithë jetës; Rregullat e standardet për njëjtësimin e mundësive UN, 1994; Komunikata nga Salamanka, 1994; raportet dhe dokumentet e OECD-së të orientuar në punën me fëmijët e rrezikuar dhe të hendikepuar). Në veçanti, Synimi i Dytë i Mijëvjeçarit fton të gjitha vendet të sigurojnë që deri në vitin 2015 të gjithë fëmijët e grupmoshës përkatëse të përfundojnë shkollimin fillor.

Jetësimi i këtij parimi kërkon krijimin e mekanizmave me të cilat do të eliminohet braktisja nga arsimimi i detyruar dhe do të krijohet një qasje e lehtë për pjesëmarrje në arsim, me çka shtohen mundësitë për jetë kualitative të të gjithëve, pavarësisht nga përkatësia nacionale e çfarëdo përkatësie tjetër. Në përputhje me këtë parim, në sistemin arsimor të Kosovës kujdes i veçantë do t'u kushtohet: fëmijëve që rrjedhin nga familjet e varfra, fëmijëve të bashkësive të ndryshme etnike që janë pakicë, fëmijëve me nevoja të veçanta, fëmijëve jetimë, pa përkujdesje për arsye të ndryshme dhe të fëmijëve me prindër të vrarë ose të zhdukur në luftë, fëmijëve të diskriminuar mbi bazën e gjinisë; fëmijëve që lypin, fëmijëve të prindërve analfabetë, fëmijëve që janë viktima të dhunës, diskriminimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe të fëmijëve që kryejnë punë të rënda fizike të dëmshme për zhvillimin e tyre fizik dhe psikik.

### 3.1.6. Parimi i rregullimit dhe i krijimit të stabilitetit

Me jetësimin e këtij parimi sistemi i arsimit mbahet në nivelin e standardeve dhe të normave të parashikuara dhe të krahasueshme me standardet dhe normat demokratike të shteteve të zhvilluara. Duke hartuar dhe përcaktuar "rregullat e lojës" në të gjitha segmentet dhe nivelet e sistemit të arsimit, edukimi dhe arsimi në Kosovë mbahen në një ekuilibër dinamik dhe të qëndrueshëm të zhvillimit. Me këtë parim përcaktohen struktura, funksionet dhe lidhjet ndërmjet elementeve të sistemit.

Parimi i rregullimit nënkupton një kornizë të qartë dhe funksionale legjislative në të cilën parashihen qartë detyrat, veprimtaritë, përgjegjësitë dhe funksionet e të gjithë strukturave të ndryshme në arsimin parauniversitar. Ky parim kërkon që në legjislaturë të evitohen të gjitha kolizionet, paralelizmat e panevojshëm, dispozitat e paqar-

ta juridike e administrative. Ky parim kërkon që në sistemin e arsimit parauniversitar të ndërtohen standarde objektive, të matshme, që garantojnë efikasitet dhe efektivitet, që parandalojnë abuzimet dhe keqpërdorimet, që nxisin dhe stimulojnë bashkëpunimin dhe ndërveprimin funksional, si në aspektin horizontal, ashtu edhe në atë vertikal.

### 3.1.7. Parimi i tërësisë

Ky parim kërkon që sistemi i arsimit dhe i edukimit të trajtohet dhe të shikohet si një tërësi e pandarë, sepse arsimi është i mishëruar me të gjitha sferat e jetës dhe të shoqërisë. Kështu, efikasiteti i arsimit parashkollor varet nga arsimimi i lartë i edukatorëve dhe efikasiteti dhe efektiviteti i Fakultetit të Edukimit, nga zhvillimet dhe arritjet shkencore, nga ekonomia, shëndetësia, teknologjia etj., ndërsa arsimi fillor varet nga cilësia e edukimit parashkollor.

### 3.1.8. Parimi i interesit kombëtar

Sipas këtij parimi, arsimi trajtohet si kategoria më shtytëse ekonomike dhe interesi më i lartë kombëtar, sepse Kosova vetëm me një arsim cilësor mund të shndërrohet në një shoqëri të dijes, të përgatitur për integrime evropiane.

Në përputhje me këtë parim, në shoqërinë kosovare do të krijohet një mendësi e re për rolin dhe rëndësinë që ka arsimi për zhvillimin e shoqërisë. Efekti duhet të jetë i dukshëm tek të gjithë qytetarët e sidomos tek politikbërësit dhe vendimmarrësit, por edhe tek agjentët e tjerë, si mediat, mësimdhënësit, komuniteti e të tjerë. Me këtë mendësi do të bëhet krejtësisht e qartë se Kosova nuk mund të zhvillohet ekonomikisht dhe cilësia e jetës së qytetarëve nuk mund të përmirësohet, pa një arsimim cilësor për të gjithë.

## 3.2. Vizioni dhe misioni

Me këtë Strategji, Kosova duhet të shndërrohet në një shtëpi të madhe të të nxënit, sepse vetëm nëse të gjithë qytetarët e Kosovës aftësohen që të mësojnë gjatë gjithë jetës, ata do të aftësohen që të komunikojnë, të planifikojnë, të mendojnë në mënyrë kritike, të përdorin dy e më shumë gjuhë të huaja, të përdorin teknikën dhe teknologjinë e re. Vetëm qytetarët që përherë janë në kërkim të dijeve të reja dhe të qëndrueshme, do të jenë në gjendje të lëvizin, të gjejnë punë të re, të kenë mirëqenie,

të jenë të lumtur, të jenë të dobishëm për komunitetin dhe të ndihmojnë zhvillimin e shoqërisë.

### 3.2.1. Vizioni

Duke u nisur nga analiza e gjendjes ekzistuese të arsimit në Kosovë, duke pasur parasysh parimet universale të ndryshimeve në arsim dhe duke synuar integrimin e arsimit të Kosovës në rrjedhat e sistemeve demokratike të shteteve të zhvilluara, sidomos të Bashkimit Evropian, grupet punuese të ekspertëve kanë formuluar këtë vizion për arsimin kosovar:

***Kosova – shoqëri e dijes, e integruar në rrjedha evropiane me mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë individëve, të cilët i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.***

Realizimi i këtij vizioni në Kosovë, e cila ende është duke u përpëlitur në etapën e vështirë të transicionit, të statusit të pazgjidhur politik, me ndasi ndëretnike, nuk do të jetë i lehtë. Në anën tjetër, derisa Kosova përballet me këto probleme, bota lëviz me një shpejtësi marramendëse drejt një shoqërie dhe ekonomie të bazuar në dije. Natyrisht, Kosova nuk ka vetëm probleme dhe pengesa, ka edhe mundësi dhe lehtësi. Një ndër to është mundësia e krijuar për dije dhe informacion bashkëkohor, bashkë me motivimin dhe aftësimin për përdorimin racional të këtyre burimeve në shërbim të individit dhe të bashkësisë në tërësi. Kjo mundësi është çelës për zgjidhjen e të gjitha problemeve ekonomike, socio – politike, sepse individët, me gjithë dallimet a interesat e ndryshme që kanë, interes vital të përbashkët kanë integrimin e Kosovës në shoqërinë e dijes së botës bashkëkohore. Ky interes është pika referuese dhe emëruesi i përbashkët konsensual për përkrahjen dhe miratimin e kësaj Strategjie për krijimin e një sistemi të fuqishëm të arsimit parauniversitar dhe për jetësimin e këtij vizioni, i cili duhet të jetë zë i përbashkët i të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Andaj, besojmë plotësisht se vizioni i përcaktuar është një ëndërr e përbashkët e të gjithë kosovarëve, të cilët duhet të punojnë që këtë ëndërr ta bëjnë realitet. Ky vizion është edhe zgjidhja më fatlume për perspektivën e gjeneratave të reja të Kosovës. Jetësimi i këtij vizioni Kosovës do t'i mundësojë që të jetë pjesë e barabartë e botës së civilizuar, që do të veçohet me kohezion të fuqishëm social dhe me mirëqenien e të gjithë qytetarëve të saj.

### 3.2.2. Misioni

Përmes misionit krijohen kushtet që të realizohet vizioni i paraparë. Misioni i kësaj strategjie është:

***Ndërtimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, që siguron kushte për formim cilësor të të gjithë individëve, duke kultivuar shprehi të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe vlera të qytetarisë demokratike.***

Realizimit të misionit do t'i kontribuojnë jetësimi i mekanizmave për avancimin e efikasitetit dhe të efektivitetit të sistemit të arsimit dhe për aftësimin e qytetarëve për të nxënë gjatë gjithë jetës, në dritën e qëllimeve strategjike të Bashkimit Evropian, si dhe të kërkesave që i parashtron shoqëria  e dijes.

Misioni paraqet një obligim për sistemin e arsimit në Kosovë, një rrugë për t'i kontribuar arritjes së vizionit të përbashkët.

## 4. Objektivat strategjike dhe masat

Grupet e ekspertëve kanë identifikuar shtatë objektiva strategjike të cilat duhet të arrihen në periudhën 2007-2017:

4.1. Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor e efikas në sistemin e arsimit

4.2. Sistem funksional për sigurimin e cilësisë së të nxënit i bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e zhvilluara

4.3. Gjithëpërfshirje, barazi dhe respektim i diversitetit në arsim

4.4. Përgatitja dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve

4.5. Mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimdhënie dhe nxënie

4.6. Lidhje e qëndrueshme e arsimit me zhvillimet globale ekonomike dhe shoqërore

4.7. Avancimi i gjendjes materiale të arsimit

Këto objektiva nuk janë radhitur sipas ndonjë përparësie, sepse secila prej tyre konsiderohet e rëndësishme për avancimin e sistemit të arsimit parauniversitar. Ndërkaq, për secilën objektivë strategjike janë definuar:

- Treguesit objektivisht të verifikueshëm që dëshmojnë arritjen e objektivës në fjalë.
- Masat (aktivitetet) që paraqesin veprimet e ndërmarra për arritjen e objektivave strategjike. Shumë masa janë projekte në vete, të cilat duhet të elaborohen më tutje.

Në vazhdim është bërë një përshkrim i detajuar i objektivave strategjike dhe i masave të ndërlidhura.

### 4.1. Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor e efikas në sistemin e arsimit

Qeverisja mund të definohet si ushtrim i autoritetit politik dhe shfrytëzim i burimeve të institucionit për të menaxhuar probleme shoqërore. Udhëheqja është pjesë e qeverisjes, por, ndryshe nga qeverisja, e cila merr vendime strategjike, udhëheqja merr vendime operative. Ndërkaq, menaxhimi është i pranishëm edhe në qeverisje edhe

në udhëheqje, por, në përgjithësi, karakterizohet me pesë funksione: planifikimi, organizimi, udhëheqja, koordinimi dhe kontrolli. Gjithsesi, qeverisja udhëheqja dhe menaxhimi cilësor janë parakushte të domosdoshme që një sistem arsimor të kryejë funksionin e vet shoqëror.

**TREGUESIT**

1. Deri në fund të vitit 2007, rishikohet legjislacioni në fuqi dhe hartohet e miratohet legjislacioni i nevojshëm arsimor i krahasueshëm me atë të vendeve të BE-së;

2. Bëhet implementim i plotë dhe në vazhdimësi i legjislacionit në fuqi në të gjitha institucionet dhe strukturat arsimore;

3. Deri në vitin 2012, të gjithë udhëheqësit e institucioneve arsimore kanë kualifikim të duhur për udhëheqje dhe menaxhim cilësor;

4. Deri në vitin 2010, në të gjitha nivelet e sistemit arsimor ekzistojnë mekanizmat dhe zbatohen procedurat për sigurimin e të dhënave cilësore statistikore dhe të informatave reciproke, të krahasueshme me ato të institucioneve të ngjashme në vendet evropiane;

5. Bëhet vetë-vlerësim dhe vlerësim i standardizuar periodik i performancës institucionale në të gjitha nivelet e arsimit;

6. Deri në vitin 2010, ekzistojnë dhe zbatohen procedurat që sigurojnë pjesëmarrje të plotë të palëve të interesuara dhe transparencë në proceset e vendim-marrjes në sistemin arsimor;

7. Hartohen plane efikase dhe efektive zhvillimore deri në vitin 2008 dhe në vazhdimësi zbatohen në të gjitha institucionet e arsimit;

8. Deri në fund të vitit 2007 vendoset dhe në vazhdimësi avancohet sistemi funksional i komunikimit dhe ndërveprimit ndërmjet institucioneve arsimore dhe të institucioneve të tjera në Kosovë

**Masa 4.1.1.** Rishikimi i ligjeve ekzistuese dhe hartimi i ligjeve të reja

**Përshkrimi:**

- Rishikohen dhe harmonizohen (deri në fund të vitit 2007) ligjet dhe aktet nënligjore ekzistuese për të qenë në përputhje me dokumentet relevante dhe rrjedhat arsimore në Evropë;
- Rishikohen aktet ligjore e nënligjore me qëllim të tejkalimit të kolizioneve ndërmjet këtyre dokumenteve;
- Kryhet analiza e zbatueshmërisë financiare të ligjeve ekzistuese dhe të ligjeve të reja;
- Bëhet hartimi i akteve të reja ligjore dhe nënligjore (p.sh. Ligji për Kornizën e Kualifikimeve, Udhëzimi Administrativ për kodin e mirësjelljes së nxënësve në shkollë) etj.
- Përshkruhen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e sektorëve të ndryshëm në MASHT, ZRA, DKA dhe në institucionet edukativo-arsimore;
- MASHT-i angazhon grup të ekspertëve të cilët deri në fund të vitit 2008 bëjnë rishikimin e legjislacionit, me qëllim të identifikimit të fushave, për bartjen e kompetencave, për ngritjen e efikasitetit të sistemit dhe të qeverisjes në arsim;
- MASHT-i ndërmerr masa të duhura për zgjerimin e autonomisë së shkollës në sistemin arsimor të Kosovës;
- Themelohet Këshilli Kombëtar për Arsimin Parauniversitar;

**Masa 4.1.2.** Zbatimi i legjislacionit

**Përshkrimi:**

- Zhvillohen strategjitë dhe planet konkrete të veprimit për zbatim të legjislacionit në arsim;
- Bëhet monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të ligjeve në të gjitha nivelet dhe në institucionet arsimore dhe nxirren rekomandimet përkatëse;
- Barten përgjegjësitë dhe kompetencat përkatëse në nivel të institucioneve edukativo-arsimore sipas normave ligjore në fuqi;
- Zhvillohen udhëzimet, doracakët dhe kriteret për udhëheqje institucionale.

**Masa 4.1.3.** Ndërtimi i kapaciteteve njerëzore për qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim

**Përshkrimi:**

- Bëhet analiza e nevojave për zhvillimin e burimeve njerëzore;
- MASHT-i përkrah dhe bashkërendit zhvillimin e programeve për përgatitjen e kuadrove udhëheqëse dhe menaxhuese në arsim;
- Vendosen mekanizma dhe kapacitete trajnuese për qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor;
- Ndërtohen kapacitetet për planifikim dhe menaxhim financiar në nivel shkolle.

**Masa 4.1.4.** Ndërtimi i infrastrukturës për përpunimin e të dhënave në arsim (deri në vitin 2008)

**Përshkrimi:**

- Zhvillohet softueri i avancuar për përpunimin e të dhënave;
- Instalohet infrastruktura fizike për SMIA-n në nivel të shkollës, komunës, të regjionit dhe në nivel të MASHT-it;
- Trajnohet personeli përgjegjës për mirëmbajtjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave;
- Publikohen të dhënat së paku një herë në vit për të rritur llogaridhënien dhe transparencën;
- Bëhet analiza dhe krahasimi i informatave të siguruara përmes SMIA-s për ngritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të sistemit në harmoni me standardet e vendeve evropiane.

**Masa 4.1.5.** Përcaktimi dhe zbatimi i procedurave për vlerësim dhe vetëvlerësim të udhëheqjes e të qeverisjes

**Përshkrimi:**

- Ndërtimi i mekanizmave për vlerësim të udhëheqjes dhe menaxhimit të institucioneve arsimore;
- Hartimi i metodologjisë për vetëvlerësim të udhëheqjes arsimore;
- Vendosja e mekanizmave për përcjelljen e rezultateve të punës të institucioneve arsimore duke iu referuar planeve të tyre të veprimit;
- Nxitje për këmbim të përvojave në mes të institucioneve arsimore në fushën e vetëvlerësimit;

**Masa 4.1.6.** Sigurimi i pjesëmarrjes dhe transparencës së plotë në procesin e vendimmarrjes

**Përshkrimi:** MASHT, ZRA, DKA dhe institucionet edukativo-arsimore do të sigurojnë:

- pjesëmarrje të gjerë dhe në vazhdimësi të të gjitha palëve me interes në procesin e vendimmarrjes përmes funksionalizimit të organeve qeverisëse të shkollës;
- transparencë të plotë në procesin e vendimmarrjes pos tjerash përmes organizimit të ngjarjeve të ndryshme me mediat dhe me komunitetin;
- bashkëpunim dhe bashkërenditje më e madhe me komunitetin dhe me sektorin e shoqërisë civile vendore e ndërkombëtare për çështjet e shkollës dhe të shkollimit;
- themelohen dhe fuqizohen aktivet e fushave (për shembull shkencave) duke u dhënë përgjegjësi të shtuara në udhëheqje kryesuesve të këtyre aktiveve;
- mbështetet formimi i shoqatave të mësimdhënësve me bazë lëndore apo të grupeve lëndore (Shoqata e Mësimdhënësve të Shkencave të Kosovës, Shoqata e Mësimdhënësve të Gjuhës Amtare të Kosovës etj);
- funksionalizohet dhe mbështetet puna e Komitetit të Prindërve të Arsimit të Kosovës (KPAK) në të gjitha nivelet e sistemit arsimor;

**Masa 4.1.7.** Krijimi i mekanizmave për hartimin dhe përcjelljen e realizimit të planeve zhvillimore për të gjitha institucionet arsimore

**Përshkrimi:** Të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar do të funksionojnë në bazë të planeve zhvillimore, që hartohen nga vet institucioni, në bashkëpunim me komunitetin dhe me institucionet lokale. Për këtë qëllim duhet përcaktuar procedura të qarta për hartimin e planeve zhvillimore, të cilat sigurojnë pjesëmarrje të gjerë në procesin e hartimit, si dhe ofrojnë mundësi për monitorimin e realizimit të tyre. Vet plani zhvillimor duhet të shërbejë si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve në arsim, si në nivelin komunal, ashtu edhe në atë qendror.

Kujdes të veçantë duhet kushtuar ndërtimit të kapacitetit për planifikim zhvillimor, si në nivel të shkollës ashtu edhe në nivel të komunës dhe të regjionit. Kjo do të realizohet përmes hartimit të doracakëve për planifikim zhvillimor, si dhe përmes trajnimeve dhe ofrimit të formave të tjera të ndihmës profesionale subjekteve të përfshira në këtë proces. Gjithashtu, do të ndërtohen kapacitetet përkatëse monitoruese në nivel të komunës dhe të regjionit.

**Masa 4.1.8.** Koordinimi i plotë i veprimtarive dhe aktiviteteve në mes të niveleve të ndryshme të udhëheqjes arsimore dhe të sektorëve të tjerë të shoqërisë

**Përshkrimi:**

- Koordinim i punëve në kuadër të Qeverisë, MASHT, ZRA dhe DKA;
- Takime të rregullta MASHT-ZRA-DKA dhe ZRA-DKA-institucione edukativo-arsimore;
- Takime të rregullta dhe koordinim i aktiviteteve me asociacionet e prindërve;
- MASHT-i do të inkurajojë udhëheqjen arsimore për bashkëpunim ndërkombëtar me institucione dhe organizata simotra në rajon, Evropë dhe më gjerë (për shembull ASPnet-i, UNICEF-i, asociacione të mësimdhënësve e të tjera);

**SUPOZIMET KRITIKE**

Analiza e bërë nga grupet e ekspertëve ka nxjerrë në shesh se vazhdimi i reflektimit të konflikteve politike në fushën e arsimit mund të rezultojë me rënie të mëtutjeshme të cilësisë së shërbimeve që ofron sistemi i arsimit. Gjithashtu, njerëzit në pozita udhëheqëse duhet të tregojnë gatishmëri për të ndryshuar, duke përqafuar qasje që rezultojnë me qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor. Nga kjo dalin këto dy supozime kritike:

1. Zvogëlimi i konflikteve politike në fushën e arsimit
2. Gatishmëria për ndryshime e njerëzve në pozita udhëheqëse

## 4.2. Sistem funksional për sigurimin e cilësisë së të nxënit i bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e zhvilluara

• Ne dokument shprehja "sistem për sigurimin e cilësisë" ka këtë kuptim: kryesisht përmes një procesi gjithëpërfshirës të debatimit për objektivat arsimore dhe kurrikulin të udhëhequr nga qeveria, sistemi për sigurimin e cilësisë përcakton domethënien e "cilësisë" në kuptim të performancës dhe rezultateve të sistemit të arsimit.

• Sistemi përcakton përgjegjësinë e aktorëve kyç në sistem për ofrimin e cilësisë në sistemin e arsimit, përfshirë shkollat dhe vetë mësimdhënësit. Sistemi siguron që këta aktorë kanë në dispozicion të dhëna relevante për performancën dhe rezultatet e tyre si dhe ofron mekanizma për përmbushjen e nevojave të tyre.

• Sistemi kërkon llogari nga mësimdhënësit dhe nga shkollat për perfomancën e tyre duke siguruar një dinamikë të brendshme për arritjen e standardeve të larta të performancës.

Sistemi për Sigurimin e Cilësisë për Arsimin Parauniversitar duhet të:

• Zhvillohet dhe realizohet në nivel qendror, rajonal, komunal dhe në nivel shkolle;

• Sigurojë një nivel të lartë të mësimdhënies dhe rezultateve të performancës së fëmijëve dhe të të rinjve;

• Sigurojë një sistem të mirëfilltë të llogaridhënies;

• Krahasohet me sistemet e vendeve të zhvilluara përfshirë Kornizën e Përgjithshme të Sigurimit të Cilësisë të Bashkimit Evropian për arsimim dhe trajnim;

• Realizohet duke u bazuar në burimet njerëzore dhe financiare.

Është e pamundur që një sistem për sigurimin e cilësisë të shihet i veçuar nga disa aspekte të tjera të funksionimit të sistemit të arsimit (p.sh. qeverisja dhe udhëheqja, trajnimi i mësimdhënësve, etj.), por fakti se funksionalizimit të një sistemi të tillë i kushtohet rëndësi e veçantë në këtë dokument, flet për aspiratën që të ndërtohet një sistem arsimi, që siguron kushte për formim cilësor të të gjithë individëve.

**TREGUESIT**

1. Ekzistojnë standardet për sigurimin e cilësisë së të nxënit;
2. Deri në vitin 2012, krijohen dhe funksionalizohen mekanizmat për vlerësim dhe certifikim;
3. Vendosen mekanizma funksionalë për akreditim dhe licencim të institucioneve arsimore dhe të programeve;
4. Krijohen mekanizma funksionalë për mbikëqyrje (monitorim), inspektim dhe vlerësim.

**Masa 4.2.1.** Formimi i institucioneve të pavarura për këshillim, hulumtime, për vlerësim, certifikim dhe akreditim në arsim

**Përshkrimi:** Themelohen institucione të cilat merren me hulumtime në arsim, me zhvillimin e standardeve, me vlerësimin e cilësisë së mësimit dhe me format e vlerësimit. Autoritetet për certifikim dhe akreditim do të jenë përgjegjës për akreditimin e programeve, e të institucioneve te arsimit dhe të aftësimit profesional..

**Masa 4.2.2.** Rishikimi dhe miratimi i Kornizës së kurrikulit, standardeve te arritjeve dhe të përmbajtjes, si dhe harmonizimi i programeve mësimore me kërkesat dhe nevojat e nxënësve e të shoqërisë kosovare, si dhe krahasueshmëria e tyre me ato të BE-së dhe të vendeve të tjera të zhvilluara.

**Përshkrimi:** MASHT-i në bashkëpunim me institucionet të tjera të pavarura dhe të specializuara do të bëjnë monitorimin e standardeve dhe të programeve aktuale, vlerësimin e tyre dhe propozimin për përmirësim në përputhje me kërkesat e shkollës dhe nevojat e kohës (rishikim nga aspekti gjinor, i qytetarisë demokratike, ndërmarrësia, edukimi shëndetësor, etj.). Do të krijohet një sistem për menaxhim të këtij procesi, i cili do t'i nënshtrohet përmirësimit të vazhdueshëm, duke siguruar karakterin profesional të tij dhe të miratohet nga Këshilli Kombëtar i ekspertëve për planprograme dhe tekste shkollore. Ky proces do të mundësojë sigurimin e cilësisë dhe përgatitjen e nxënësve për vazhdimin e shkollimit për nevojat e tregut të punës, si dhe të ndjekë rrjedhat e zhvillimeve teknologjike, shkencore e kulturore.

MASHT-i në bashkëpunim me institucionet e tjera, angazhohet që në kurrikulat shkollore dhe në standarde të përfshihen shkathtësitë bazë që i proklamon Bashkimi Evropian, të cilat duhet t'i zotërojë një nxënës në shekullin 21.

**Masa 4.2.3.** Hartimi dhe sigurimi i teksteve cilësore dhe i mjeteve të tjera mësimore

**Përshkrimi:** Ndërtohen kapacitete (autorët, recensentët, botuesit dhe mësimdhënësit) përmes shkëmbimit të përvojave, diskutimeve publike, seminareve e të tjera, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së teksteve dhe mjeteve te tjera mësimore ne pajtim me standardet e pranuara ndërkombëtare. Kjo përfshin edhe përdorimin më të madh të teksteve alternative dhe të doracakëve, të udhëzuesve e të fletoreve të punës nga mësimdhënësit dhe nxënësit.
MASHT-i / Qeveria e Kosovës (deri në qershor 2007) hartojnë planin për pajisjen e të gjitha shkollave me mjete të teknologjisë informative;
Në këtë kontekst, do të hartohen programe për përdorimin e teknologjisë informative për avancimin e cilësisë së mësimdhënies e të nxënies.

**Masa 4.2.4.** Krijimi dhe zbatimi i bazës ligjore për sigurimin e cilësisë në arsim

**Përshkrimi:**

- Zhvillohet infrastruktura ligjore përmes rishikimit dhe hartimit të ligjeve, udhëzimeve administrative, rregulloreve e të akteve të tjera nënligjore që ndihmojnë sigurimin e cilësisë në arsim;
- Kryhet inspektimi i rregullt i shkollave me qëllim të krijimit dhe të ngritjes së vetëdijes për domosdonë e zbatimit dhe respektimit të akteve ligjore dhe normative për funksionim të rregullt të procesit edukativo-arsimor. Do të kryhen edhe inspektime specifike sipas kërkesave dhe nevojave të institucioneve.

**Masa 4.2.5.** Krijimi i kushteve për realizimin e mësimit praktik

**Përshkrimi:** Do të vendoset bashkëpunim me institucionet dhe sektorët e ndryshëm të ekonomisë të institucioneve të tjera për realizimin e mësimit praktik dhe lidhjen e shkollës (veçmas të shkollave profesionale) me ekonominë, me qëllim të funksionimit të sistemit dysh (dual) të mësimit ndërmarrje-shkollë. Përkrahen stilet e mësimit me pjesëmarrje aktive dhe me projekte, duke zhvilluar aktivitetet e mësimit që përfshijnë zbatimin praktik të njohurive, shkathtësive dhe shprehive të nxënësit.

**Masa 4.2.6.** Pjesëmarrja aktive në projekte të bashkëpunimit të ndërsjellë, rajonal dhe ndërkombëtar

**Përshkrimi:** Organizohen aktivitete në funksion të shkëmbimit të përvojave të ndryshme të nxënësve dhe mësimdhënësve për programe, për metodologji, për tekste, për realizimin e aktiviteteve sportive, kulturore, artistike, etj, të cilat i kontribuojnë ngritjes së cilësisë së arsimit. Bashkëpunimi i tillë krijon mundësi për investime dhe grumbullim të fondeve nga shkollat për të realizuar aktivitete të ndryshme që shkojnë në të mirë të mësimit dhe punës në shkollë.

**Masa 4.2.7.** Ngritja e shërbimeve profesionale në institucionet arsimore

**Përshkrimi:** Në institucionet edukative-arsimore ngrihen shërbime profesionale që ofrojnë mbështetjen e duhur në aspektin pedagogjik, social dhe shëndetësor për nxënësit, mësimdhënësit, punëtorët administrativë dhe teknikë.

## SUPOZIMET KRITIKE

Kapaciteti i mjaftueshëm i institucioneve arsimore për ofrimin e shërbimeve dhe për rritjen e cilësisë së të nxënit paraqet një gjendje të dëshiruar që është, pjesërisht, jashtë kontrollit të implementuesve të kësaj strategjie, në radhë të parë për shkak të gjendjes kritike në të cilën ndodhet sistemi i arsimit në Kosovë. Shumë institucione arsimore, për shkaqe objektive, akoma nuk mund të fokusohen në rritjen e cilësisë së punës, gjë që paraqet një rrezik real për procesin e implementimit të strategjisë.

## 4.3. Gjithëpërfshirje, barazi dhe respektim i diversitetit në arsim

Përfshirja e qytetarëve në sistemin e arsimit është një ndër treguesit e zhvillimit të një shoqërie. Barazia nënkupton të qenët i barabartë në status, të kesh mundësi të barabarta, të marrësh një trajtim të barabartë, pa diskriminime, pa barriera dhe pa paragjykime. Ky parim kërkon që të gjithë personave dhe institucioneve të përfshira në arenën e arsimit (si personeli mësimor dhe administrativ, nxënësit, prindërit, komuniteti, grupet e pafavorizuara, shkollat, etj.), t'u jepen të drejta të barabarta sipas statusit të tyre, të trajtohen si të barabartë për një zhvillim normal individual dhe institucional dhe për një përmbushje të suksesshme të detyrave dhe të përgjegjësive. Barazia mund të jetë numerike ose proporcionale. Respektimi i barazisë pranohet si një standard minimal i kulturës së sotme morale dhe arsimore, ndërsa ofrimi i mundësive të barabarta për të gjithë është parakusht për sigurimin e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në jetën shoqërore.

Diversiteti nënkupton diç më shumë se përkatësinë etnike dhe përfshin aspekte si mosha, gjinia, përkatësia fetare, statusi shoqëror i qytetarit, etj. Edukimi për njohjen e diversitetit nënkupton kompetenca si: haptësia, të kuptuarit e kulturave tjera, qasje kritike ndaj realitetit shoqëror, niveli i zhvillimit, etj.

**TREGUESIT**

1. Deri në vitin 2017, krijohen kushtet për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në arsimin e obligueshëm;

2. Në të njëjtën kohë të paktën 90% të fëmijëve te grup-moshës 5-6 vjeç përfshihen në edukimin parafillor, ndërkaq 35% të grupmoshës 0-5 vjeç përfshihen në ndonjë formë të edukimit parashkollor;

3. Po ashtu, të paktën 90% te grup moshës përkatëse përfshihen në programe te arsimit të mesëm të lartë dhe të aftësimit profesional;

4. Deri në vitin 2017, 30% e fëmijëve kosovarë në diasporë përfshihen në mësimin plotësues;

5. Ekzistojnë dhe zbatohen programe të shumëllojshme për të përkrahur arsimimin e të të rriturve në sistemin e arsimit.

**Masa 4.3.1.** Hartimi i politikave që sigurojnë përfshirje të plotë të fëmijëve në sistemin e arsimit

**Përshkrimi:**

- MASHT-i zhvillon politika gjithëpërfshirëse dhe mjedis të përshtatshëm, që promovon barazi gjinore, qasje të barabartë dhe diversitet kulturor, etnik, gjuhësor, racor etj;
- Bëhet plotësimi dhe zbatimi i plotë i infrastrukturës ligjore në arsimin parauniversitar;
- Organizohen aktivitete për vetëdijesimin e prindërve dhe të komunitetit për rëndësinë e arsimit në fëmijërinë e hershme përmes fushatave, seminareve, trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme;
- MASHT-i inkurajon dhe mbështet format alternative për përfshirje në edukimin parashkollor;
- Hulumtohen shkaqet e braktisjes se shkollës nga nxënësit dhe hartohen strategjitë e programet përkatëse për trajtimin e problemit;
- Zhvillohen programe alternative për riintegrimin e fëmijëve që nuk kanë qenë të regjistruar në shkollë apo kanë braktisur shkollën;
- Sigurohen fonde për vendosjen e një rrjeti për transportin e nxënësve nga zonat rurale në periferi të qyteteve dhe anasjelltas, në mënyrë që të rritet vijueshmëria e nxënësve në shkollë, që do të mund të realizohej përmes bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve lokale publike, autoriteteve të shkollës dhe përfaqësuesve të komuniteteve;
- Ndërmerren masa dhe sigurohen fonde për stimulimin e regjistrimit të të rinjve në drejtimet shkencore e teknike;
- Riaktivizohen konviktet ekzistuese dhe ndërtohen konvikte të reja për nxënësit e shkollave të mesme të larta;
- Finalizohet dhe zbatohet strategjia për shkollat promovuese të shëndetit, afirmohen shkollat mike për fëmijë dhe zgjerohet rrjeti i këtyre shkollave;
- Punohet për zbatimin e Strategjisë së Arsimit për Zhvillim Rural.

**Masa 4.3.2.** Krijimi i mekanizmave për barasvlerësimin e arsimit joformal me arsimin formal

**Përshkrimi:**

- Hartohen programe për kualifikime sipas nevojave sociale dhe ekonomike të individit që nxisin procesin e të nxënit gjatë gjithë jetës;
- Zhvillohet sistemi i standardizimit, akreditimit, licencimit dhe njohjes së të arriturave të individit, pavarësisht nga mënyra e arritjes së zhvillimit profesional;
- Krijohet një organ nacional këshillëdhënës për arsimin joformal, përcaktohen përgjegjësitë e ministrive si dhe rritet bashkëpunimi ndërmjet ministrive, OJQ-ve dhe sektorit privat për afirmimin e mësimit joformal;
- Zhvillohen partneritete dhe rrjete komunikimi (qeveria, OJQ-të sektori privat dhe komuniteti) për sigurimin e arsimit joformal;
- Sigurohen mjete financiare për organizimin e arsimit joformal dhe krijohet një mekanizëm i fondeve ( fondi për grante të vogla) për të mbështetur iniciativat e komunitetit për arsimim;
- Organizohen aktivitete për vetëdijesimin e të rriturve në zonat rurale për aftësim për shkrim-lexim dhe trajnime për shkathtësitë elementare;
- Hartohet katalogu i institucioneve dhe OJQ-ve të ndryshme për shërbimet që ofrojnë në arsimin formal dhe joformal;
- Sigurohet infrastruktura ligjore për krijimin dhe aplikimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve;
- Zhvillohet dhe zbatohet dokumenti mbi klasifikimin e profesioneve;
- Zhvillohet dhe funksionalizohet sistemi për këshillim dhe orientim në karrierë;
- Zhvillohen programet modulare për arsimin formal dhe joformal;
- Zhvillohet dhe zbatohet sistemi dual në arsimin profesional.

**Masa 4.3.3.** Zhvillimi i partneritetit social për gjithëpërfshirje të grupeve të pa favorizuara në proceset shoqërore dhe ekonomike

**Përshkrimi:**

- MASHT-i në bashkëpunim me aktorët tjerë kujdeset për hapjen e institucioneve për hartimin e programeve adekuate të dedikuara për edukimin dhe arsimimin e grupeve të pafavorizuara dhe të grupeve të tjera nga spektri i diversitetetit gjinor, gjuhësor, etnik, kulturor dhe racor;
- Hartohen projekte të dedikuara për mësimin e shkrim-leximit dhe shkathtësive elementare për uljen e shkallës së analfabetizmit;
- Në partneritet me MKRSÇJ-në bëhet përpilimi dhe implementimi i politikave nacionale për punën me të rinj.

**Masa 4.3.4.** Sigurimi i kushteve të përshtatshme për përfshirje të fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e arsimit

**Përshkrimi:**

- MASHT-i në bashkëpunim me institucione të tjera krijon kushte për përkrahjen e proceseve inkluzive për fëmijët me nevoja të veçanta në të gjitha nivelet e arsimit;
- Organizohen aktivitete për vetëdijesimin e shoqërisë për rëndësinë e gjithëpërfshirjës së fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Bëhet zbatimi dhe vlerësimi i Planit Individual të Edukimit i bazuar në Kornizën e Kurrikulit të Kosovës;
- Bëhet kualifikimi dhe rikualifikimi i mësuesve për arsimim gjithëpërfshirës;
- Shkollat Speciale shndërrohen në Qendra Burimore për të ndihmuar proceset inkluzive në shkollat e rregullta;
- Krijohen këshillimoret psikologjike - pedagogjike në shkolla me qëllim të krijimit të kushteve për gjithëpërfshirje;
- Organizohet vlerësimi diagnostifikues dhe vlerësimi arsimor;
- Ndërtohet partneriteti ndërsektorial në mes të sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale (shërbime të kontrollimit dhe përpilimi i programeve mësimore për mësimdhënësit e arsimit special) për avancimin e shërbimeve inkluzive në sistemin arsimor;
- Zhvillohen shërbimet rehabilituese në nivel të komunave;
- Vendosen standarde profesionale dhe standarde të cilësisë për ekspertë në lëmin e rehabilitimit;
- Ndërlidhet Plani Individual i Edukimit me Planin Individual të Tranzicionit. (PIA me PIT).

**SUPOZIMET KRITIKE**

1. Integrimi i të gjitha komuniteteve etnike në shoqëri;
2. Zbutja e varfërisë në shoqëri;
3. Ndërgjegjësimi për përfshirje në arsim.

## 4.4. Përgatitja dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Cilësia e mësimdhënies është përcaktuesi më i rëndësishëm i arritjeve të nxënësve, që varet nga përgatitja dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve. Me përgatitje nënkuptohet kualifikimi që bëjnë mësimdhënësit para shërbimit, kryesisht përmes studimeve universitare të profilit të caktuar. Ndërkaq, zhvillimi profesional është një kuptim më i gjerë, i cili nuk ka të bëjë vetëm me trajnimin, por edhe me ofrimin e mundësive të tjera për freskimin e vazhdueshëm të njohurive dhe shkathtësive, p.sh. pjesëmarrja në konferenca, në udhëtime studimore, etj. Me zhvillimin profesional nënkuptohet edhe rikualifikimi i mësimdhënësve për fusha të tjera.

**TREGUESIT**

1. Deri në vitin 2017, të gjithë mësimdhënësit në shërbim përfshihen në programe të akredituara për zhvillim profesional;
2. Deri në vitin 2017, të gjithë mësimdhënësit duhet të posedojnë të paktën një licencë;
3. Deri ne vitin 2015, institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe cilësore për përgatitjen e mësimdhënësve në përputhje me standardet e pranuara ndërkombëtare;
4. Deri në vitin 2010, të gjithë mësimdhënësit aftësohen për punë me kompjuterë dhe me aplikacionet themelore të TI-së;
5. Ofrohen programe funksionale, që mundësojnë rikualifikim të mësimdhënësve në shërbim.

**Masa 4.4.1.** Rishikimi i programeve për kualifikim të studentëve të rinj për mësimdhënës dhe për rikualifikim e ngritje profesionale të mësimdhënësve pa shkëputje nga puna.

**Përshkrimi:** MASHT-i dhe universitetet kërkojnë nga fakultetet të cilat përgatisin mësimdhënës që programet e tyre të jenë në harmoni me Udhëzimin Administrativ – Standardet e programeve për përgatitjen e mësimdhënësve gjatë studimeve. Ky udhëzim parasheh harmonizimin e programeve të studimit duke u bazuar në programet e vendeve të zhvilluara dhe në Procesin e Bolonjës. Hartohen dhe akreditohen programe për aftësimin e mësimdhënësve pa shkëputje nga puna.

**Masa 4.4.2.** Rishikimi i udhëzimit administrativ për licencimin e mësimdhënësve dhe zbatimi i tij

**Përshkrimi:** MASHT-i rishikon rregulloren për licencimin e mësimdhënësve për të krijuar hapësirë për arsimin dhe aftësimin profesional, për punën praktike, për mësimdhënësit e arsimit për nevoja të veçanta, për edukatorë etj. Po ashtu MASHT-i krijon kushte materiale për zbatimin e kësaj rregulloreje, me qëllim të motivimit të mësimdhënësve për punë cilësore. Gradimi i mësimdhënësve bëhet duke u mbështetur në përgatitjen arsimore, në aftësimin profesional dhe në performancën e tyre.

**Masa 4.4.3.** Përfshirja e ekspertëve nga profesione të caktuara joarsimore për të punuar në arsim.

**Përshkrimi:** MASHT-i dhe institucionet e arsimit të lartë duhet të jenë bartës të zhvillimit të programeve për aftësim të mësimdhënësve në shërbim dhe të atyre që do të punësohen në shkollat profesionale. Gjatë punësimit do të merren parasysh, jo vetëm kualifikimi arsimor, por edhe aftësimi profesional personal i individit, rezultatet e procesit të monitorimit apo të vlerësimit të mësimdhënësit dhe referenca nga persona përgjegjës. Pra, mësimdhënësi duhet të plotësojë kushtet për mësimdhënie sipas Standardeve të Praktikës Profesionale. Institucionet përgjegjëse do të sigurojnë përfshirjen në arsim edhe të profesionistëve, të cilët kanë njohuri të larta profesionale në një fushë dhe, si të tillë, mund të ndihmojnë në realizimin cilësor të praktikës profesionale.
MASHT-i, institucionet e arsimit të lartë dhe partnerë të tjerë hartojnë dhe zbatojnë programin për aftësimin e mësimdhënësve, për përdorimin e teknologjisë informative në procesin mësimor.

| | |
|---|---|
| **Masa 4.4.4.** | Ndërtimi i kapaciteteve për mbikëqyrje, monitorim dhe vlerësim të rregullt të punës dhe arritjeve të mësimdhënësve |
| **Përshkrimi:** | Zhvillimi i kapaciteteve profesionale bëhet në tri nivele, në atë të shkollës (drejtori, personeli mësimor dhe komuniteti), në nivelin komunal dhe në nivelin qendror (MASHT-i) për mbikëqyrjen, monitorimin dhe vlerësimin e përgatitjes së mësimdhënësve, me qëllim të sigurimit të cilësisë. Po ashtu do të bëhen analiza të arritjeve të nxënësve, pjesëmarrjes dhe sukseseve të tyre në aktivitete të ndryshme në shkallë vendi dhe më gjerë.<br><br>Krijohen parakushte të duhura për stimulimin e mësimdhënësve për punë të suksesshme dhe për ngritje të vazhdueshme të cilësisë në mësim. Stimulimi mund të jetë material, por gjithashtu edhe në forma të tjera, siç janë mirënjohjet publike, shpërblimet për punë të suksesshme, pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme në vend dhe jashtë vendit etj.<br><br>Gjithashtu, parashihen edhe sanksione për mangësitë apo mospërgatitjen e suksesshme të mësimdhënësve të caktuar. |

## SUPOZIMET KRITIKE

Megjithëse përmirësimi i pozitës materiale të arsimit është një ndër objektivat e kësaj Strategjie, konsiderohet se pozita e tanishme materiale e mësimdhënësve është një faktor rreziku për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies. Prandaj, duhet gjetur forma për motivim të shtuar të mësimdhënësve, si dhe mënyra për rritjen e interesimit të të rinjve për profesionin e mësimdhënësit. Kjo e dyta ndërlidhet me faktin se profesioni i mësimdhënësit është gjithnjë e më pak atraktiv, kështu që vendet e punës mbesin të paplotësuara.

## 4.5. Mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimdhënie dhe nxënie

Mjedisi fizik i të nxënit është një ndër karakteristikat kryesore të shkollës efektive. Studime të shumta flasin për ndërlidhje organike të mjedisit fizik cilësor me parametrat e tjerë të efektivitetit, siç janë: udhëheqja profesionale, pritshmëritë e larta, shndërrimi i shkollës në organizatë të të nxënit, etj. Në kushtet e Kosovës, përmbushja e këtij objektive është mjaft sfiduese, sepse kërkon guxim dhe përkushtim të lartë të politikëbërësve për të bërë investime të mëdha materiale, që nuk mund të shpaguhen brenda një afati të shkurtër.

MASHT-i, MSH-ja dhe MMPH-ja janë në procesin e hartimit të një strategjie të veçantë për shkollën e shëndetshme, e cila synon sigurimin e një mjedisi të shëndoshë dhe të sigurt shkollor përmes edukimit shëndetësor, promovimit të mbrojtjes së mjedisit dhe forcimit të partneritetit ndërmjet shkollës, familjes dhe komunitetit. Kjo objektivë strategjike përvijohet edhe në strategjinë për shkollën e shëndetshme.

**TREGUESIT**

1. Deri në vitin 2017, mësimi zhvillohet në më së shumti dy ndërrime;
2. Po ashtu, në të njëjtën periudhë, arrihet sigurimi i infrastrukturës bazë të nevojshme në të gjitha shkollat;
3. Deri në vitin 2017, sigurohen pajisjet bazë të teknologjisë asistuese për nxënësit me nevoja të veçanta;
4. Deri në fund të zbatimit të këtij plani strategjik, sigurohen kushte themelore për realizimin e mësimit praktik për të gjitha shkollat profesionale (brenda shkollës apo në bashkëpunim me ekonominë);
5. Krijohen kushte për aktivitete fizike dhe sportive në të gjitha shkollat[1]
6. Të gjitha shkollat pajisen me mjete konkretizimi sipas standardeve

[1] Nëse nuk përmendet afati, atëherë nënkuptohet se është fjala për vitin 2017

**Masa 4.5.1.** Hartimi i standardeve (normativave) dhe udhëzimeve për projektimin e hapësirave shkollore, për ndërtimin dhe pajisjen e objekteve shkollore, si dhe implementimi i tyre

**Përshkrimi:** Duke u nisur nga dokumentet ekzistuese, do të hartohet udhëzuesi i ri me standarde për projektimin e hapësirave shkollore dhe parashkollore në Kosovë. Ky dokument do të parasheh të gjitha standardet e projektimit dhe të ndërtimit të objekteve shkollore, p.sh. normativat do të përcaktojnë madhësinë e objektit në raport me numrin e nxënësve ($m^2$/nx.), kushtet e lokacionit ku do te ndërtohet objekti shkollor, orientimin, hapësirat e brendshme të nxënies, hapësirat e jashtme të nxënies, hapësirat në metër katrorë për administratë, sipërfaqja për numër të shërbimit profesional, ndriçimi, cilësia e ajrit, infrastruktura bazë, pajisjet, normativat e sigurisë, llojet e konstruksionit, materialet, mirëmbajtja e të tjera.

Normativat, njëherësh duhet të përcaktojnë kriteret për pajisje, inventar dhe, sipas nevojës, për mjete mësimore .

Gjatë hartimit të standardeve, kujdes i theksuar do t'i kushtohet krijimit të kushteve për personat me nevoja të veçanta.

Normat dhe standardet e parapara duhet të jenë konform standardeve të pranuara evropiane - EUROCODE- dhe të aplikueshme në Kosovë, si dhe duhet të ekzistojnë mekanizma funksionalë që sigurojnë implementimin e këtyre standardeve.

**Masa 4.5.2.** Ndërtimi i bazës së të dhënave sektoriale

**Përshkrimi:**

- Brenda bazës së të dhënave të SMIA-së ndërtohet baza e të dhënave sektoriale për infrastrukturë;
- Ndërtimi i bazës së të dhënave për infrastrukturë është esencial për të shërbyer në procesin e vendimmarrjes dhe gjatë hartimit të politikave, prioriteteve dhe strategjive (sidomos ato afatshkurtra dhe afatmesme). Baza e të dhënave nënkupton azhurimin e vazhdueshëm të të dhënave (për shembull çdo 6-12 muaj).

**Masa 4.5.3.** Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese shkollore

**Përshkrimi:**

- Konform normativave të përcaktuara e gjithë infrastruktura e objekteve ekzistuese duhet të plotësohet dhe të përmirësohet, në mënyrë që të shkohet kah realizimi i standardeve evropiane - EUROCODE.

  Të gjitha hapësirat shkollore të cilat nuk i plotësojnë standardet dhe që nuk janë në gjendje të mirë duhet të rinovohen duke përfshirë:
- Rregullimin dhe përmirësimin e godinave shkollore
- Rregullimin dhe përmirësimin e infrastrukturës për ujësjellës dhe kanalizim, ngrohja, telefoni, interneti, etj...
- Rregullimin e hapësirave të jashtme si: terrenet sportive, oborret, gjelbërimi, kopshti dhe sheshet e ndryshme, etj.

**Masa 4.5.4.** Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore

**Përshkrimi:**

- Institucionet qeveritare qendrore dhe lokale, në bashkëpunim me partnerët, përqendrojnë përpjekjet e veta në ndërtimin e objekteve të reja shkollore në zonat ku punohet në më shumë se dy ndërrime dhe në zonat ku objektet shkollore paraqesin rrezik për sigurinë e nxënësve. Të gjitha investimet do të bëhen në pajtim me standardet dhe udhëzimet e miratuara.

**Masa 4.5.5.** Mirëmbajtja dhe ruajtja e pasurisë shkollore

**Përshkrimi:**

- MASHT-i, në bashkërenditje me komunat, do të punojë në hartimin e politikave dhe në vendosjen e sistemit të menaxhimit dhe të mirëmbajtjes së pasurisë shkollore;
- Komunat dhe shkollat do të menaxhojnë dhe do të kujdesen për ruajtjen e objekteve dhe të hapësirës shkollore, si dhe për mirëmbajtjen dhe sigurinë e tyre në përputhje me politikat e miratuara.

**Masa 4.5.6.** Pajisja e shkollave me mjete mësimore.

**Përshkrimi:**

- MASHT-i dhe komunat, në bashkëpunim me donatorë dhe partnerë do të investojnë në furnizimin e shkollave me inventar dhe mjete mësimore standarde, si dhe me pajisje laboratorike të nevojshme. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet përdorimit të teknologjive të reja në procesin e mësimdhënies dhe nxënies.
- Blerja dhe organizimi i koncentruar i punëtorive dhe pajisjeve për arsimin profesional. Punëtoritë dhe pajisjet e tilla mund të shfrytëzohen edhe nga shkolla të tjera.
- Do të vendoset bashkëpunim me qendrat për aftësim profesional dhe me ndërmarrje ekonomike, me qëllim të shfrytëzimit të mjeteve të konkretizimit dhe të pajisjeve përkatëse për qëllime arsimore.

**SUPOZIMET KRITIKE**

Një dukuri tipike për infrastrukturën shkollore në Kosovë është mbingarkesa e kapaciteteve në zonat urbane dhe shfrytëzimi relativisht i ulët i tyre në zonat rurale. Prandaj, perspektiva e përmirësimit të infrastrukturës është e lidhur ngushtë me dy supozimet vijuese që janë jashtë kontrollit të zbatuesve të kësaj Strategjie:

1. Stabilizimi i proceseve migruese; dhe
2. Zhvillimi i viseve rurale.

## 4.6. Lidhje e qëndrueshme e arsimit me zhvillimet globale ekonomike dhe shoqërore

Është e njohur se zhvillimi ekonomik i një shoqërie është në korrelacion me nivelin e arsimimit të popullatës dhe me aftësinë e asaj shoqërie për t'i vënë të arriturat në arsim dhe në shkencë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm njerëzor. Zhvillimi njerëzor është më shumë se rritja e BPV-së, më shumë se prodhimi i mallrave dhe më shumë se akumulimi i kapitalit, që janë vetëm mjete për shtimin e mundësive për njerëzit. Zhvillimi njerëzor ka të bëjë me krijimin e ambientit ku njeriu mund ta zhvillojë plotësisht potencialin e tij dhe të bëjë një jetë produktive dhe kreative në pajtim me nevojat dhe interesat e tij. Njerëzit janë pasuria e çdo kombi, ndërsa zhvillimi njerëzor është shtimi i mundësive për të bërë një jetë që ata dëshirojnë dhe vlerësojnë.

Për këtë arsye, ndërlidhja e arsimit me zhvillimet globale ekonomike dhe shoqërore është një status normal i një sistemi arsimor me pritshmëri të larta dhe një parakusht për ndërtimin e një shoqërie demokratike me në qendër qytetarin.

# 4. Objektivat strategjike dhe masat

**TREGUESIT**

1. Është arritur punësueshmëri dhe mobilitet i shtuar i qytetareve në ekonominë e vendit dhe jashtë;

2. Ekzistojnë programe dhe mekanizma funksionalë për orientim në karrierë;

3. Ulet shkalla e analfabetizmit në Kosovë deri ne 5%;

4. Programet e arsimit dhe aftësimit profesional i përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe standardeve përkatëse të BE-së;

5. Deri ne vitin 2015, funksionalizohet sistemi kombëtar i kualifikimeve;

6. Shtohet angazhimi i shkollës ne përkrahjen e iniciativave qytetare ne funksion të zhvillimit shoqëror.

**Masa 4.6.1.** Integrimi i Kosovës në proceset zhvillimore evropiane dhe globale

**Përshkrimi:**

- Hartohen dhe zbatohen programe për ndërlidhjen efikase të institucioneve arsimore me ekonominë dhe ndërmarrjet;
- Bëhet shkëmbimi i përvojave në rajon dhe me gjerë;
- Bëhet organizim dhe bashkërenditje më e mirë e punëve në nivele ministrore, me partnerët socialë, dhe në nivel të shkollave-QAP-ve, për punë më të mirë praktike në shkollat profesionale;
- Shfrytëzohen analizat e tregut të punës për hapjen e profileve të reja arsimore duke përfshirë edhe arsimin formal e joformal
- Zhvillohen plane për zbatimin e Deklaratës së Lisbonës (shoqëria dhe ekonomia e bazuar në dije) dhe të Deklaratës së Kopenhagës të vendeve evropiane për arsimin dhe aftësimin profesional;
- Zhvillohen programe për të siguruar mobilitet të shtuar të krahut të punës, rritje të punësueshmërisë dhe lehtësim të bartjes së shkollimit për nxënësit e të diplomuarit kosovarë;
- Zbatohet klasa e 13-të në arsimin profesional (si urë lidhëse në mes të arsimit të mesëm të lartë dhe arsimit të lartë);
- Aplikohet në projektin EUROPASS ( Korniza për transparencën e kualifikimeve dhe shkathtësive);
- Krijimi i mundësive për konkurrim dhe pjesëmarrje në programet evropiane arsimore (si Sokrates, Komenius, Lingua, Minerva, Leonardo da Vinci, etj.);
- Zbatimi i politikave dhe praktikave të e-learning (‘mësimi elektronik’) në sistemin arsimor parauniversitar.

**Masa 4.6.2.** Sistemi i arsimit siguron përgatitjen e qytetareve për jetë

**Përshkrimi:**

- Ndërmerren masa për të siguruar kushte të aftësimit dhe mësimit gjatë tërë jetës;
- Zhvillohen shkathtësitë bazë si shkrim-leximi funksional, shkathtësitë matematikore, përdorimi i teknologjisë informative, mësimi i gjuhëve të mjedisit dhe i gjuhëve të huaja, shkathtësitë për ndërmarrësi, kulturë të përgjithshme, marrëdhënie ndërpersonale dhe sociale etj., përmes metodave të të nxënit aktiv, mendimit kritik, të dëgjuarit aktiv e të tjera.
- Promovohen dhe avancohen parimet e qytetarisë demokratike përmes nismave qytetare (zhvillimi i voluntarizmit, pjesëmarrjes në vendim-marrje, mbrojtja e ambientit, zhvillimi i parimit të tolerancës etj.)

**Masa 4.6.3** Përputhja e planeve dhe programeve në rrjedhat e zhvillimit të shoqërisë, të ekonomisë në vend dhe më gjerë

**Përshkrimi:** Institucionet e arsimit parauniversitar në mënyrë të vazhdueshme bëjnë hulumtimin e nevojave të ekonomisë dhe shoqërisë kosovare, trendëve të zhvillimit të arsimit dhe ekonomisë evropiane për të përcaktuar nevojën e bashkërendimit të programeve ekzistuese dhe për zhvillimin e programeve të reja në bazë të shkallës së punësueshmërisë së profileve në tregun e punës.

## SUPOZIMET KRITIKE

Kur Kosova ndodhet tashmë në fazën e transicionit dhe ekziston një hendek në mes të rezultateve që prodhon sistemi arsimor dhe kërkesave që shtron ekonomia e vendit, janë dy supozime kyçe prej të cilave varet arritja e kësaj objektive strategjike:

1. Interesimi i shtuar i punëdhënësve për zhvillime në arsim;
2. Zhvillimi ekonomik i përshpejtuar.

## 4.7. Avancimi i gjendjes materiale të arsimit

Me gjithë faktin që Strategjia parasheh një varg investimesh kapitale dhe shpenzime të shtuara për kategoritë tjera buxhetore, grupet e ekspertëve kanë konsideruar se një objektivë strategjike e saj duhet të fokusohet në avancimin e gjendjes materiale te arsimit për një afat më të gjatë. Kjo reflekton përkushtimin e hartuesve të Strategjisë që parametrat e financimit të arsimit parauniversitar të jenë të krahasueshëm me vendet e zhvilluara dhe të reflektojnë një politikë përkrahëse për zhvillimin e këtij sektori.

**TREGUESIT**

1. Shpenzimet publike për kokë nxënësi janë në nivelin e mesatares së vendeve të BE-së;

2. Ndërtohen mekanizmat funksionalë për menaxhimin e decentralizuar të mjeteve financiare;

3. Vendosen dhe zbatohen kriteret dhe rregulloret për financim që favorizojnë gjithëpërfshirjen dhe barazinë në arsim.

**Masa 4.7.1.** Rritja e fondeve për arsim

**Përshkrimi:**

- Institucionet e Kosovës do të shtojnë fondet për arsim nga buxheti, derisa të arrijnë përqindjen e shpenzimeve mesatare për një nxënës në nivelin e mesatares së BE-së;
- MASHT-i do t'i propozojë Qeverisë aplikimin e taksave të veçanta për arsimin (mallrat luksoze, etj.);
- Rritet përqindja e shpenzimeve për arsim brenda komunës nga të hyrat e krijuara vetanake dhe parashikohen stimulime përkatëse nga institucionet qendrore;
- Institucionet e Kosovës angazhohen për bashkërenditjen e aktiviteteve, fushën e investimeve në sektorin e arsimit;
- Identifikohen dhe shfrytëzohen burime të tjera për financim në nivel qendror dhe atë vendor, si për shembull ndihma dhe kontributet e ndryshme të prindërve dhe të komunitetit.
- Marrja e kredive zhvillimore me interes të ulët në institucione përkatëse financiare ndërkombëtare;
- Mundësohet gjenerimi i mjeteve vetanake nëpërmjet decentralizimit në të gjitha nivelet;
- Funksionalizohen mekanizmat për gjenerimin dhe shfrytëzimin e mjeteve vetanake nëpërmjet bashkëpunimit me ekonominë dhe me komunitetin.

**Masa 4.7.2.** Lirimi i institucioneve të arsimit parauniversitar nga taksat

**Përshkrimi:** MASHT-i do t'i paraqesë kërkesë të argumentuar Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës për lirimin e plotë ose të pjesshëm të institucioneve arsimore nga taksat dhe detyrimet e ndryshme, si: dogana, akciza, tatimi në vlerën e shtuar, tatimi në fitim, etj.

**Masa 4.7.3.** Rishqyrtimi – përmirësimi i kritereve për financim

**Përshkrimi:**

- MASHT-i inicion formimin e një grupi ndërministror të ekspertëve (MASHT-MEF-MSHP-MPL) për rishqyrtimin e formulës së granteve për financimin e arsimit parauniversitar;
- MASHT-i në bashkëpunim me MEF-in dhe MSHP-në do të bëjë përcaktimin e kritereve meritore për pagë dhe atë sipas peshës së pjesëmarrjes që kanë këto kritere në pagë si p.sh:
  - vendi i punës;
  - kualifikimi;
  - përvoja e punës;
  - përvoja profesionale;
  - angazhimet e tjera jashtë mësimdhënies;
  - puna mbi normë;
  - largësia nga vendi i punës;
  - trajnimet.
- MASHT-i do të insistojë në përmirësimin e kritereve për rritjen e buxhetit për mallra dhe shërbime;
- Rritja e fondeve për investimet kapitale konform kërkesave për ndërtimet e reja, zgjerime, renovime dhe infrastrukturë përcjellëse.

**Masa 4.7.4.** Decentralizimi i menaxhimit të mjeteve financiare

**Përshkrimi:**

- Krijimi i mekanizmave për decentralizim

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve më efikase, Qeveria krijon parakushte për decentralizimin e menaxhimit të mjeteve financiare prej nivelit qendror deri në nivelin lokal dhe atë të shkollës.
Me këtë do të krijohen mundësi që komunat dhe shkollat të menaxhojnë më lehtë, më shpejt dhe në mënyrë më transparente mjetet financiare.

- Krijimi i mekanizmave të monitorimit dhe udhëzimeve përkatëse

Krahas delegimit të autoritetit për menaxhim financiar niveleve lokale, në këtë rast Komunave dhe shkollave, duhet krijuar mekanizmat e monitorimit dhe inspektimit në nivel qendror dhe lokal.

**SUPOZIMET KRITIKE**

Avancimi i pozitës materiale të arsimit varet nga këto dy supozime:

1. Zhvillimi ekonomik i përshpejtuar
2. Gjetja e burimeve alternative të financimit

## Objektiva 4.1: Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor e efikas në sistemin e arsimit

| Masa 4.1.1 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Rishikimi i ligjeve ekzistuese dhe hartimi i ligjeve të reja | Amandamentimi / ndryshimi dhe plotësimi i ligjeve ekzistuese dhe akteve nënligjore, si dhe përpilimi i ligjeve të reja | MASHT-i Qeveria Kuvendi | 2007-2012 | |
| | Sigurimi i mbështetjes së qëndrueshme financiare për zbatimin e ligjeve | Qeveria | 2007-2012 | |

| Masa 4.1.2 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Zbatimi i legjislacionit | Përgatitja e planeve për zbatim të ligjeve | MASHT-i | 2007-2008 | |
| | Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit dhe nxjerrja e rekomandimeve | MASHT -i/ Auditimi | 2007-2012 | |
| | Përgatitja e udhëzimeve, doracakëve dhe e kritereve për udhëheqje institucionale arsimore | MASHT –i Organizatë e pavarur profesionale | 2008-2010 | 45,900 € |

| Masa 4.1.3 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Ndërtimi i kapaciteteve njerëzore për qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim | Themelimi i akademisë për aftësimin e udhëheqjes arsimore | Qeveria MASHT-i | 2007-2009 | 261,128 € |
| | Formimi i grupit punues për rishikim dhe zbatim të politikave të MASHT-it për udhëheqje arsimore | MASHT-i | 2007-2008 | 14,610 € |
| | Përgatitja e programeve aftësuese për planifikim dhe menaxhim të institucioneve arsimore | MASHT-i | 2007-2008 | 32,160 € |

# 5. PLANI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

| Masa 4.1.4 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Ndërtimi i infrastrukturës për përpunimin e të dhënave në arsim | Aftësimi i personelit të SMIA-s për mirëmbajtje, përpunim, analizë dhe krahasim të të dhënave | MASHT-i / DKA-ja | 2007-2008 | 36,900 € |
| | Zhvillimi i softuerit dhe instalimi i infrastrukturës fizike për SMIA-n | MASHT-i/ ZRA-ja Komunat Shkollat | 2007-2012 | 1,071,700 € |
| | Shpërndarja dhe publikimi i të dhënave | MASHT-i | 2007-2012 | 51,600 € |

| Masa 4.1.5 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Përcaktimi dhe zbatimi i procedurave për vet-vlerësim dhe vlerësim të udhëheqjes e të qeverisjes | Hartimi i rregullores për vetëvlerësim, mbikëqyrje dhe vlerësim të udhëheqjes arsimore | MASHT-i KSHAM-i | 2007-2008 | 18,580 € |
| | Zbatimi i rregullores për vetëvlerësim, mbikëqyrje dhe vlerësim të udhëheqjes arsimore | MASHT-i | 2008-2012 | 19,750 € |
| | Stimulim material dhe përkrahje për udhëheqje të suksesshme dhe performancë të mirë | MASHT-i | 2008-2012 | 39,000 € |

| Masa 4.1.6 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Sigurimi i pjesëmarrjes dhe transparencës së plotë në procesin e vendimmarrjes | Themelimi dhe fuqizimi i aktiveve të fushave shkencore në nivel shkolle, komune, rajoni dhe vendi | MASHT-i/ZRA-ja DKA-ja/Institucionet edukativo-arsimore | 2007-2008 | 3,400 € |
| | Mbështetje e shoqatave të mësimdhënësve e të prindërve. | MASHT-i Donatorët | 2007-2012 | 140,000 € |

| Masa 4.1.7 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Krijimi i mekanizmave për hartimin dhe përcjelljen e realizimit të planeve zhvillimore për të gjitha institucionet edukativo-arsimore | Të gjitha institucionet arsimore hartojnë plane zhvillimore | MASHT-i<br>ZRA-ja<br>DKA-ja<br>IEA-ja | 2007 - 2012<br>Në vazhdimësi | 69,200 € |
| | Institucionet mbështeten materialisht për zbatimin e planeve zhvillimore | Qeveria<br>MASHT-i<br>Donatorët | 2008-2012 | 602,000 € |
| | Ndërtimi i kapaciteteve përkatëse monitoruese në nivel të komunës dhe regjionit | MASHT-i<br>DKA-ja | 2008-2012 | 13,500 € |

| Masa 4.1.8 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Koordinimi i plotë i aktiviteteve në mes nivelesh të ndryshme të udhëheqjes arsimore dhe të sektorëve të tjerë të shoqërisë | Zhvillimi dhe zbatim i politikave për bashkëpunim dhe koordinim në nivele të ndryshme | MASHT-i | 2007-2008 | |
| | Mbështetje materiale për Komitetin e Prindërve të Arsimit të Kosovës (KPAK) | MASHT-i<br>DKA-ja<br>Donatorët | 2007-2012 | 55,000 € |

## Objektiva 4.2. Sistem funksional për sigurimin e cilësisë së të nxënit i bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e zhvilluara

| Masa 4.2.1 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Formimi i institucioneve të pavarura për hartimin e politikave, për vlerësim, certifikim dhe akreditim në arsim | Themelohet Këshilli Kombëtar për Arsimin Parauniversitar; | Qeveria MASHT-i | Qershor 2008 | 53,744 € |
| | Themelohet Instituti Pedagogjik i Kosovës; | MASHT-i | 2007-2009 | 1,346,800 € |
| | Themelohet dhe funksionalizohet një autoritet për punë të pavarur për akreditim dhe certifikim të programeve trajnuese; | MASHT-i MPMS-ja | 2007-2008 | 56,500 € |
| | Themelohet dhe funksionalizohet qendra për vlerësim; | MASHT-i | 2009-2012 | 2,427,880 € |
| | Themelohet një autoritet i pavarur për akreditim të institucioneve arsimore. | Qeveria MASHT-i | 2009-2012 | 207,430 € |

| Masa 4.2.2 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Rishikimi i Kornizës së kurrikulit, standardeve te arritjeve dhe përmbajtjes, si dhe harmonizimi i programeve mësimore me kërkesat dhe nevojat e nxënësve dhe shoqërisë kosovare, si dhe krahasueshmëria e tyre me ato të vendeve të zhvilluara | Ndryshimi, plotësimi dhe miratimi i Kornizës së Kurrikulit | MASHT-i | 2007 | 45,090 € |
| | Vlerësimi dhe harmonizimi i standardeve te arritjes me trendët bashkëkohore | MASHT-i | 2008-2012 | 386,170 € |
| | Rishikimi i kurrikulave lëndorë dhe harmonizimi i tyre me Kornizën Kurrikulare | MASHT-i | 2009-2012 | 753,101 € |

| Masa 4.2.3 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Hartimi dhe sigurimi i teksteve cilësore dhe mjeteve të tjera mësimore | Përcaktimi i standardeve për tekste mësimore dhe i procedurave të miratimit | MASHT-i | 2008 - 2012 | 30,540 € |
| | Përcaktimi i standardeve për mjete mësimore | MASHT-i | 2008 - 2012 | 8,250 € |

| Masa 4.2.4 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Krijimi dhe zbatimi i bazës ligjore për sigurimin e cilësisë në arsim | Rishikimi i dispozitave ligjore që përcaktojnë sigurimin e cilësisë në legjislacionin ekzistues dhe harmonizimi i tyre me ligjet e BE-së | MASHT-i | 2007 - 2008 | 32,750 € |
| | Krijimi i mekanizmave dhe instrumenteve për garantimin e cilësisë në arsim | MASHT-i | 2008-2012 | 22,500 € |

| Masa 4.2.5 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Krijimi i kushteve për realizimin e mësimit praktik | Sigurohen kushte për realizimin e mësimit cilësor praktik në shkolla | MASHT-i DKA-ja Shkollat | 2007 - 2012 | 51,950 € |
| | Vendoset bashkëpunim me ndërmarrje për sigurim të kushteve për punë praktike të nxënësve; | MASHT-i DKA-ja Shkollat Palët me interes Qeveria | 2007 - 2012 | |

| Masa 4.2.6 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Pjesëmarrja aktive në projekte të bashkëpunimit të ndërsjellë, rajonal dhe ndërkombëtar | Hartimi i një platforme për bashkëpunim regjional dhe ndërkombëtar | MASHT-i | 2008 | |

| Masa 4.2.7 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Ngritja e shërbimeve profesionale në institucionet arsimore | Ngritja e shërbimeve profesionale në shkollë | Qeveria, Shkolla, DKA-ja, MASHT-i | 2008-2010 | 1,084,440 € |

## Objektiva 4.3. Gjithëpërfshirje, barazi dhe respektim i diversitetit në arsim

| Masa 4.3.1 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Hartimi i politikave të përshtatshme që sigurojnë përfshirje të plotë të të gjithë fëmijëve në sistemin e arsimit | Hulumtimi i shkaqeve të braktisjes së shkollës. | MASHT-i<br>ISP-ja<br>Shkollat<br>MSHP-ja | 2007-2009 | 39,000 € |
| | Adaptimi i programeve për integrimin e nxënësve që nuk kanë qenë të regjistruar në shkollë apo që kanë braktisur shkollën | MASHT-i /<br>ISP-ja<br>Shkollat | 2009-2012 | 29,000 € |
| | Zgjerimi i rrjetit të shkollave promovuese të shëndetit dhe shkollave mike për fëmijë. | MASHT-i<br><br>MSH-ja,<br>MMPH-ja<br>Komunat | 2007-2012 | 2,800,000 € |
| | Përfshirja më e madhe e fëmijëve të diasporës në mësimin plotësues | Qeveria<br>MASHT-i<br>Komuniteti | 2007<br>2012 | 383,400 € |

| Masa 4.3.2 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| | Zhvillimi i sistemit të standardizimit, akreditimit, licencimit dhe njohjes së të arriturave të individit, pavarësisht nga mënyra e arritjes së zhvillimit profesional | MASHT-i<br>Ministritë e tjera | 2007-2012 | 132,560 € |
| Krijimi i mekanizmave për barasvlerë të arsimit joformal me arsimin formal | Hartimi i programeve për kualifikime sipas nevojës sociale dhe ekonomike të individit që nxisin procesin e të nxënit gjatë gjithë jetës. | MASHT-i<br>MPMS-ja<br>MTI-ja<br>MKRS-ja<br>(Autoriteti për kualifikime kombëtare) | 2007-2012 | 379,300 € |
| | Krijimi i shërbimeve për orientim në karrierë në institucionet arsimore të ndërlidhura me sistemin e këshillimit dhe orientimit në karrierë | MASHT-i<br><br>Qeveria | 2008-2012 | 50,000 € |

| Masa 4.3.3 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Zhvillimi i partneritetit social për gjithëpërfshirje të grupeve të pa favorizuara në proceset shoqërore dhe ekonomike | Krijimi i kushteve dhe hartimi i programeve adekuate të dedikuara për edukimin dhe arsimimin e grupeve të pafavorizuara nga aspekti gjinor gjuhësor, kulturor, etnik dhe racor, etj. | MASHT-i<br>ISP-ja<br>Komuniteti | 2008-2012 | 47,500 € |
| | Përpilimi dhe implementimi i politikave për punën me të rinj. | MASHT-i<br>MKRS-ja<br>MTI-ja<br>MPMS-ja | 2007-2010 | |

| Masa 4.3.4 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Sigurimi i kushteve të përshtatshme për përfshirje të fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e arsimit | Shndërrimi i shkollave speciale në Qendra Burimore në ndihmë të proceseve inkluzive në shkolla të rregullta. | MASHT-i<br>Komunat<br>Shkollat speciale<br>Komuniteti | 2007-2012 | 105,000 € |
| | Zbatimi i planit individual të edukimit për fëmijët me nevoja të veçanta. | MASHT-i<br>Komunat<br>Shkolla | 2007-2009 | 275,000 € |
| | Kualifikimi dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve në arsimin gjithëpërfshirës. | MASHT-i<br>Fakulteti i Edukimit<br>DKA-ja | 2007-2012 | 150,000 € |
| | Organizimi i ekipeve arsimore vlerësuese për fëmijët me nevoja të veçanta. | MASHT-i<br>Komuna<br>MSh-ja<br>MPMS-ja | 2007-2010 | 45,000 € |

## Objektiva 4.4. Përgatitja dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve

| Masa 4.4.1 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Rishikimi i programeve për kualifikim të studentëve të rinj për mësimdhënës dhe për rikualifikim e ngritje profesionale të mësimdhënësve pa shkëputje nga puna | Zhvillimi dhe implementimi i programit për studim pa shkëputje nga puna | MASHT-i Fakulteti i Ed. | 2007-2012 | 1,852,120 € |
| | Rishikimi dhe implementimi i Udhëzimit Administrativ - Standardet e programeve për përgatitjen e mësimdhënësve gjatë studimeve | MASHT-i UP-ja Agjencitë kompetente | 2007-2012 | 16,720 € |
| | Hartimi i një kornize për programe për aftësim profesional pa shkëputje nga puna | MASHT-i | 2007-2008 | 6,688 € |

| Masa 4.4.2 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Rishikimi i udhëzimit administrativ për licencimin e mësimdhënësve dhe zbatimi i tij | Zbatimi i udhëzimit administrativ për licencim të mësimdhënësve | MASHT-i UP-ja Agjencitë | 2007-2010 | 28,032 € |
| | Hartimi i programeve te akredituara për zhvillim profesional të mësimdhënësve | MASHT-i UP-ja Agjencitë për trajnim | 2008-2012 | 6,406,000 € |

| Masa 4.4.3 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Përfshirja e ekspertëve nga profesione të caktuara jomësimdhënëse për të punuar në arsim | Plotësimi i udhëzimit administrativ Standardet e praktikës profesionale duke përfshirë arsimin profesional dhe për NV-në | MASHT-i UP-ja Agjencitë për trajnim | 2007 | 6,688 € |

| Masa 4.4.4 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Ndërtimi i kapaciteteve për mbikëqyrje, monitorim dhe vlerësim të rregullt të punës dhe arritjeve të mësimdhënësve | Hartimi i rregullores për mbikëqyrje, ngritje profesionale, monitorim dhe vlerësim të punës së personelit arsimor | MASHT-i UP-ja Agjencitë trajnuese | 2007 | 25,080 € |
| | Implementimi i rregullores për mbikëqyrje, monitorim dhe vlerësim të punës së personelit arsimor | MASHT-i UP-ja Agjencitë trajnuese | 2007-2012 | 263,520 € |

## Objektiva 4.5. Mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimdhënie dhe të nxënë

| Masa 4.5.1 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Hartimi i standardeve (normativave) dhe udhëzimeve për projektimin e hapësirave shkollore, për ndërtimin dhe pajisjen e objekteve shkollore, si dhe implementimi tyre | Hartimi i normativave të reja për objekte shkollore bazuar në standarde evropiane dhe të aplikueshme në Kosovë | MASHT-i | 2007-2008 | 33,440 € |

| Masa 4.5.2 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Ndërtimi i bazës së të dhënave sektoriale. | Ndërtimi i bazës për infrastrukturë në kuadër të SMIA | MASHT-i | 2007-2008 | 51,000 € |

| Masa 4.5.3 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese shkollore | Sigurimi i ujit të pijshëm dhe kanalizimit për të gjitha shkollat | MASHT-i - Komunat-Shkollat | 2007-2012 | 3,600,000 |
| | Rregullimi dhe përmirësimi i infrastrukturës shkollore | MASHT-i – Komunat | 2007-2012 | 53,300,000 € |
| | Sigurimi i qasjes në internet për të gjitha shkollat | MASHT-i – Komunat | 2009 | 1,817,000 € |
| | Zhvillimi dhe realizimi i programit "Një laptop për nxënës (OLPC)" | MASHT-i – Komunat | 2007-2012 | 19,660,000 € |

| Masa 4.5.4 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore | Zhvillimi i një politike për ndërtimin e hapësirave të reja shkollore (p.sh. numri i shkollave të reja, sigurimi i mekanizmave për financim, kriteret, procedurat, etj.) | MASHT-i | 2007 | 5,016 € |
| | Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore (me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillimin e mësimit në më së shumti dy ndërrime) | MASHT-i – Komunat | 2007-2012 | 114,170,000 € |

| Masa 4.5.5 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Mirëmbajtja dhe ruajtja e pasurisë shkollore | Hartimi i politikave për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe sigurimin e pasurisë shkollore | MASHT-i | 2007-2008 | 8,360 € |

| Masa 4.5.6 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Pajisja e shkollave me mjete mësimore | Hartimi i normativave për pajisjen e shkollave me mjete mësimore | MASHT-i Instituti Pedagogjik | 2008-2009 | 33,440 € |
| | Pajisja e shkollave me pako standarde të mjeteve mësimore | MASHT-i Komunat | 2008-2012 | 11,000,000 € |
| | Blerja dhe organizimi i koncentruar i punëtorive dhe pajisjeve për arsim profesional | MASHT-i – Komunat | 2007-2012 | 4,000,000 € |

## Objektiva 4.6. Lidhje e qëndrueshme e arsimit me zhvillimet globale ekonomike dhe shoqërore

| Masa 4.6.1 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Integrimi i Kosovës në proceset zhvillimore evropiane dhe globale | Shfrytëzimi i analizave të tregut të punës për hapjen e profileve të reja arsimore. | MASHT-i<br>MPMS-ja | 2007-2012 | |
| | Zbatimi i Deklaratës së Lisbonës (shoqëria dhe ekonomia e bazuar në dije) dhe të Deklaratës së Kopenhagës (për arsimin dhe aftësimin profesional). | MASHT-i<br>MPMS-ja<br>Qeveria<br>(Agjencia për integrime evropiane) | 2007-2012 | |
| | Bashkëpunimi dhe këmbimi i përvojave në rajon dhe më gjerë. | MASHT-i<br>Qeveria<br>Komunat<br>MPMS-ja | 2007-1012 | 540,000 € |

| Masa 4.6.2 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Sistemi i arsimit siguron përgatitjen e qytetareve për jetë | Zhvillimi i shkathtësive bazë në institucionet edukative-arsimore. | MASHT-i<br>Instituti Pedagogjik | 2007-2012 | 1,660,000 € |
| | Promovimi i parimeve të qytetarisë demokratike përmes programeve shkollore dhe mbështetjes së nismave qytetare. | MASHT-i | 2007-2012 | 200,000 € |

# 5. PLANI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

| Masa 4.6.3 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Përputhja e planeve dhe programeve me rrjedhat e zhvillimit të shoqërisë, të ekonomisë në vend dhe më gjerë | Hulumtimi i nevojave të ekonomisë dhe shoqërisë kosovare, trendët e zhvillimit të arsimit dhe të ekonomisë evropiane për të caktuar nevojën e bashkërendimit të programeve ekzistuese. | MPMS-ja<br>Partnerët Socialë<br>MASHT-i | 2007-2012 | 171,840 € |

## Objektiva 4.7. Avancimi i gjendjes materiale të arsimit

| Masa 4.7.1 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Rritja e fondeve për arsim | Rritja e buxhetit për arsim parauniversitar në masën prej 16 % të Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës (me shkallë rritje prej 1% në vit duke filluar nga viti 2008) duke u nisur nga masa e tanishme prej 13.4%. | Qeveria MASHT-i | 2008-2010 | |
| | Rritja e buxhetit për arsim parauniversitar nga të hyrat vetanake të komunave në shkallën minimale prej 20%. | Komunat | 2008-2010 | |
| | Propozimi për aplikimin e taksave të veçanta për arsim. | MASHT-i | 2007 | |
| | Orientimi i Institucioneve të Kosovës për marrjen e kredive të volitshme dhe shfrytëzimin e fondeve të donacioneve për arsimin parauniversitar. | Qeveria | 2007 | |

# 5. PLANI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

| Masa 4.7.2 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Lirimi – Lehtësimi i institucioneve të arsimit parauniversitar nga taksat | Përpilimi i propozimit të argumentuar për lirim-lehtësim të institucioneve arsimore nga disa taksa | MASHT-i MEF-i | 2007 | |

| Masa 4.7.3 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Rishqyrtimi – përmirësimi i kritereve për financim | Hartimi i udhëzimit administrativ për financimin e institucioneve arsimore | MASHT-i – MEF-i | 2007 | 8,360 € |
| | Hartimi i udhëzimit administrativ për përcaktimin e kritereve meritore për pagat e punonjësve të arsimit | MASHT-i – Qeveria | 2007 | 8,360 € |

| Masa 4.7.4 | Prioritetet për periudhën 2007-2012 | Bartësit | Periudha e zbatimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|
| Decentralizimi i menaxhimit të mjeteve financiare | Inicimi i ndryshimeve në ligjin për financa publike dhe në aktet nënligjore përkatëse me qëllim të decentralizimit të autorizimeve financiare në nivel të komunës dhe të shkollës | MASHT-i[1] MEF-i | 2007 | 5,016 € |
| | Krijimi i mekanizmave për monitorimin e shpenzimeve financiare | MASHT-i MEF-i | 2007-2008 | |

[2] Ky ligj është në procedurë

## 6.1. Realizimi i Strategjisë – ndryshimi i strukturës dhe qasjes në financimin e arsimit

Reformat e deritanishme në sistemin arsimor, të zbatuara në partneritet vendor/ ndërkombëtar, konsolidimi i këtij sistemi, krijimi i masës kritike për veprime të mëtejshme zhvillimore në arsim, si dhe prioretizimi që i ka bërë qeveria përmes politikës së vet për "Tri E"-të (ekonomia, edukimi dhe energjia) ka sjellë në një moment shumë të përshtatshëm për kalim në fazën e re investive – zhvillimore të arsimit kosovar.

Mirëpo, ky kontekst nuk mund të jetë efektiv në masën e duhur pa i ndryshuar edhe mekanizmat e tjerë dhe sidomos ata mekanizma që ndikojnë në efikasitetin e sistemit. Në rend të parë këtu mendohet në strukturën e tanishme të financimit në arsim. Kjo ka të bëjë para së gjithash me (a) sistemin e tanishëm linear të gradave e të pagave, me (b) formulën tashmë të tejkaluar të granteve komunale për arsimin, me (c) mekanizmat që sigurojnë pjesëmarrje të komunitetit në udhëheqjen dhe përkrahjen e arsimit, në (d) planifikimin, implementimin dhe monitorimin e investimeve kapitale e të tjera.

Momentalisht, të gjitha këto karakterizohen nga një qasje pasive dhe jomotivuese e financimit, që nuk lidhet me rezultatet e punës qoftë të individit apo të institucionit, por vetëm me traditën e vjetër të mbijetesës të sistemit arsimor. Në këtë kuptim, pavarësisht nga investimi i ulët në arsim mund të thuhet që, shikuar nga këndvështrimi i rezultateve, Kosova ka një sistem arsimor relativisht të shtrenjtë dhe joefikas.

### Kalimi prej financimit në investim në arsim

Ky plan strategjik zhvillimor promovon pikërisht qasje dhe politika aktive arsimore që kërkojnë kalimin prej financimit në investim të arsimit (përfshirë kreditë). Kjo filozofi e re investive do të ishte në harmoni me qasjen e re të ndikimit aktiv të arsimit në shoqëri dhe të përkrahjes aktive të shoqërive përkatëse për sistemin arsimor të atyre vendeve. Kështu, studime të shumta empirike në Evropë, të porositura nga Komisioni Evropian, kanë vërtetuar se rritja e investimeve (jo financimit pasiv) në arsim dhe rritja e efikasitetit të këtyre investimeve do të rezultonte me një rritje më të madhe vjetore të zhvillimit të shkathtësive të fuqisë punëtore prej 0.45 % në plan afatgjatë[3] , ndërkaq investimet për të siguruar ngritjen e standardeve të arritshmërisë përmes programeve të ndryshme të mësimit tërëjetësor do të ndikonin në rritje të BPV-së prej 0.3 deri në 0.5 në shkallë vjetore në plan afatgjatë[4]. Ky kthim nga financimi i arsimit në investime arsimore do të nënkuptonte edhe mekanizmat përkatës për sigurimin e efekteve

[3] European Commission 2003a
[4] European Commission 2003b

kthyese nga investimi në arsim, si për shembull: kostoja e caktuar investive do të përcillej me një kontratë/marrëveshje e cila do të parashihte se sistemi arsimor do të ofronte një numër përkatës profilesh, shkathtësish, dhe shërbimesh për koston e caktuar të investimit në arsim. Një qasje e tillë është në përputhje të plotë me filozofinë evropiane të investimit në arsim të aplikuar në kuadër të Procesit të Lisbonës dhe në dokumentet e tjera përkatëse.

**Efekti i investimeve: kontrata qeveri/shoqëri – sistem arsimor**

Në dy vitet e fundit Qeveria e Kosovës i ka dhënë prioritet arsimit duke e rritur buxhetin në këtë fushë në vlerën prej rreth 5% në shkallë vjetore. Kjo ngritje është shënuar në kohën kur në sektorë të tjerë janë bërë zvogëlime të alokimeve buxhetore.

Dhënia përparësi sektorit të arsimit dhe investimit në këtë sektor duke siguruar mbështetjen financiare për zbatimin e kësaj Strategjie mundëson **këto rezultate konkrete:**

- themelohen 15 institucione dhe mekanizma të rinj cilësorë për çuarjen përpara të proceseve e shërbimeve arsimore;
- ngritët arritshmëria e nxënësve dhe performanca e institucioneve arsimore që shprehet përmes testeve kombëtare dhe ndërkombëtare për vlerësimin e arritshmërisë së nxënësve dhe performancës së institucioneve e të sistemit;
- vendosen dhe rishikohen standardet e arritshmërisë (që e bën sistemin tonë arsimor të matshëm dhe të krahasueshëm me sistemet në rajon e më gjerë);
- furnizohen me kompjuterë dhe me qasje cilësore në internet të gjitha shkollat në Kosovë;
- aftësohen më se 25,000 mësimdhënës në së paku dy programe trajnimi;
- ndërtohen më se 500,000 metra katrorë hapësirë shkollore, me qëllim që të gjithë nxënësit të mësojnë në më shumti dy ndërrime deri në vitin 2012;
- rinovohen rreth 300,000 m2 shkolla për të siguruar kushte cilësore pune;
- sigurohen punëtoritë, kabinetet dhe laboratorët për përmirësimin e kushteve të punës e të rezultateve në shkollat e mesme të përgjithshme dhe profesionale;
- zgjerohet spektri i shërbimeve arsimore, përshirë shërbime formale dhe joformale arsimore, si dhe  shërbime cilësore në aspektin e mësimit tërëjetësor;

- reformohet sistemi i pagave dhe gradimeve në arsim në bazë të meritës (që do të përmirësonte dukshëm efikasitetin e investimeve në arsim);
- rishikohen planprogramet në të gjitha nivelet dhe harmonizohen me ato në vendet evropiane.

Rrjedhimisht mund të përfundohet se, në rend të parë për shkak të dy dekadave të rënda për arsimin kosovar, shoqëria kosovare ka nevojë për rritjen e mëtejme të investimeve në arsim, me qëllim të sigurimit të qasjes universale në arsim, të shërbimeve më cilësore arsimore, të integrimit më të lehtë në proceset përkatëse evropiane dhe, përfundimisht, për sigurimin e zhvillimit të përshpejtuar ekonomik të Kosovës.

## 6.2. Procesi i buxhetimit

Versioni final i narrativit të Strategjisë (kapitujt 1-4 të këtij dokumenti) bashkë me planin e zbatimit u aprovuan nga KEAP-ja më 5 janar 2007, kur edhe u mor vendimi për të vazhduar punën në llogaritjen e buxhetit të Strategjisë për periudhën 2007-2012. Qëllimet kryesore të këtij procesi ishin:

- Të përcaktohet korniza financiare për zbatimin e strategjisë së arsimit parauniversitar;
    - të përkufizohet vëllimi i fondeve të nevojshme për zbatimin e Strategjisë në periudhën 2007-2012;
    - të identifikohet boshllëku ndërmjet kapacitetit financiar për përballimin e nevojave të arsimit parauniversitar dhe kostos reale të këtij arsimi sipas Strategjisë;
- Të prezantohet alokimi i burimeve të financimit dhe shpenzimeve në vitet e ardhshme:
    a. nga Buxheti i Kosovës;
    b. nga donacionet dhe asistenca financiare;
    c. nga burimet private;
    d. nga burime të tjera përshirë të hyrat vetanake të komunave.

# 6. BUXHETI I STRATEGJISË

Teknikisht, kjo detyrë u realizua në formë të dy punëtorive të njëpasnjëshme me pjesëmarrje të gjerë të ekspertëve nga fusha e arsimit dhe e financave. U bënë llogaritjet e buxhetit për çdo prioritet veç e veç, duke i ndarë shpenzimet në tri kategori: 1) investime kapitale, 2) mallra dhe shërbime; dhe 3) paga dhe mëditje. Ndarja e shpenzimeve u bë sipas viteve dhe alokimeve, duke rezultuar me një material voluminoz, përmbledhja e të cilit do të prezantohet në vijim.

Gjatë llogaritjeve u morën parasysh projeksionet buxhetore për periudhën 2007-2009, por edhe përcaktimi i Qeverisë së Kosovës për klasifikimin e arsimit në mesin e prioriteteve politike, si dhe mundësitë e pritshme për qasje më të madhe të Kosovës në institucione financiare ndërkombëtare. Elementet e tjera relevante të cilat janë marrë parasysh gjatë llogaritjeve buxhetore janë:

- Struktura demografike e popullatës së Kosovës – rreth 20% të qytetarëve të Kosovës janë nxënës të nivelit fillor dhe të mesëm, ndërsa parashikimet deri në vitin 2015 flasin për një rritje të popullatës në shkallë prej 1.6-1.8% në vit.
- Kosova ka një shkallë relativisht të lartë të varfërisë – rreth 44%, ndërsa 14% të qytetarëve jetojnë në varfëri të skajshme. Kjo është një arsye pse shpenzimet private nuk mund të shihen si një burim i qëndrueshëm për plotësimin e nevojave për arsim. Edhe në vendet e Bashkimit Evropian, shpenzimet private për arsim janë pothuajse margjinale – mesatarisht 10.8% të shpenzimeve të përgjithshme për arsim[5].
- Periudha 2007-2017, duhet të shënojë një shkëputje përfundimtare të Kosovës nga faza e emergjencës dhe kalim të natyrshëm në fazën e zhvillimit. Gjithashtu, kjo periudhë shënon ndarjen e Kosovës nga faza e izolimit dhe e ngecjes prapa, në fazën e krahasimit në rajon dhe ecjes kah integrimi në rrjedhat përkatëse në hapësirën arsimore evropiane.
- Investimi në arsimin parauniversitar është një ndër investimet më të rëndësishme që mund t'i bëjë një vend për të siguruar një perspektivë për qytetarët e vet. Ne këtë fazë të shkollimit fitohen njohuritë, shkathtësitë dhe shprehitë, që janë të nevojshme për arsimim të mëtutjeshëm, për pjesëmarrje në tregun e punës dhe për pjesëmarrje në jetën shoqërore e politike.

Në procesin e llogaritjeve të buxhetit janë paraqitur edhe disa kufizime, të cilat, objektivisht, mund të ndikojnë në vetë zbatueshmërinë e Strategjisë:

[5] Key Data on Education in Europe 2005, European Comission, f. 176

- Punonjësit e arsimit konsiderohen si shërbyes civilë, kështu që pagat e tyre përcaktohen në nivel të Shërbimit Civil të Kosovës. Me gjithë vullnetin e mirë të hartuesve të kësaj Strategjie, çështja e pagave nuk ka mundur të adresohet ashtu si duhet në procesin e zhvillimit të këtij dokumenti.

- Në momentin e hartimit të dokumentit dhe të buxhetit të Strategjisë nuk kanë qenë të njohura zgjidhjet konkrete për decentralizim në fushën e arsimit parauniversitar, kështu që mund të ndodhë që disa zgjidhje të mos jenë të aplikueshme në të ardhmen ose të kërkojnë modifikim në kuptim të sigurimit të mjeteve buxhetore nga burime të tjera.

- Projeksionet makroekonomike nuk japin një pasqyrë të qartë të perspektivave zhvillimore të Kosovës, por ofrojnë skenarë që reflektojnë varshmërinë e zhvillimit ekonomik nga faktorë të jashtëm.

## 6.3. Përmbledhja e buxhetit të Strategjisë

Llogaritjet e bëra tregojnë se zbatimi i Strategjisë në periudhën 2007-2012 kushton 245,109,441 EUR me këtë strukturë të projektuar të të hyrave, të dhënë në tabelën 1.

**Tabela 1.** Burimet e projektuara të të hyrave për zbatimin e Strategjisë në periudhën 2007-2012.

| Burimi i të hyrave | Shuma (EUR) | % |
|---|---|---|
| Buxheti i Kosovës | 135,261,221 | 55.18% |
| Donacionet dhe asistenca financiare | 55,933,580 | 22.82% |
| Burimet private | 14,027,000 | 5.72% |
| Burime të tjera (përfshirë të hyrat e komunave) | 39,887,640 | 16.27% |
| **Gjithsej** | **245,109,441** | **100%** |

Në tabelën 2 është dhënë një pasqyrë e shpenzimeve të projektuara sipas kategorisë shpenzuese dhe burimeve të të hyrave.

**Tabela 2.** Pasqyra e shpenzimeve sipas kategorisë shpenzuese dhe burimeve të të hyrave

| Nr. | Përshkrimi | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Investimet kapitale | Buxheti i Kosoves | 12,549,400 | 14,522,800 | 16,378,600 | 17,775,000 | 17,840,000 | 18,580,000 | 97,645,800 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 1,249,200 | 9,120,000 | 10,010,000 | 9,885,000 | 9,535,000 | 9,290,000 | 49,089,200 |
| | Burimet private | 1,250,000 | 1,610,000 | 2,150,000 | 2,525,000 | 2,525,000 | 2,780,000 | 12,840,000 |
| | Burime të tjera | 5,850,000 | 5,937,500 | 5,850,000 | 6,850,000 | 6,850,000 | 6,200,000 | 37,537,500 |
| | **Gjithsej Investimet kapitale** | **20,898,600** | **31,190,300** | **34,388,600** | **37,035,000** | **36,750,000** | **36,850,000** | **197,112,500** |
| Mallrat dhe shërbimet | Buxheti i Kosoves | 619,035 | 2,606,103 | 3,856,687 | 4,743,848 | 5,645,614 | 6,304,394 | 23,775,681 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 449,380 | 1,608,360 | 2,085,140 | 975,500 | 868,000 | 858,000 | 6,844,380 |
| | Burimet private | 0 | 125,000 | 125,000 | 125,000 | 0 | 0 | 375,000 |
| | Burime të tjera | 0 | 80,640 | 163,250 | 716,250 | 772,000 | 618,000 | 2,350,140 |
| | **Gjithsej Mallrat dhe shërbimet** | **1,068,415** | **4,420,103** | **6,230,077** | **6,560,598** | **7,285,614** | **7,780,394** | **33,345,201** |
| Pagat dhe mëditjet | Buxheti i Kosoves | 138,340 | 933,176 | 1,804,256 | 2,879,456 | 3,654,656 | 4,429,856 | 13,839,740 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 56,000 | 168,000 | 168,000 | 168,000 | 140,000 | 112,000 | 812,000 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Pagat dhe mëditjet** | **194,340** | **1,101,176** | **1,972,256** | **3,047,456** | **3,794,656** | **4,541,856** | **14,651,740** |
| TOTALI | Buxheti i Kosoves | 13,306,775 | 18,062,079 | 22,039,543 | 25,398,304 | 27,140,270 | 29,314,250 | 135,261,221 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 1,698,580 | 10,728,360 | 12,095,140 | 10,860,500 | 10,403,000 | 10,148,000 | 55,933,580 |
| | Burimet private | 1,306,000 | 1,903,000 | 2,443,000 | 2,818,000 | 2,665,000 | 2,892,000 | 14,027,000 |
| | Burime të tjera | 5,850,000 | 6,018,140 | 6,013,250 | 7,566,250 | 7,622,000 | 6,818,000 | 39,887,640 |
| | **TOTALI** | **22,161,355** | **36,711,579** | **42,590,933** | **46,643,054** | **47,830,270** | **49,172,250** | **245,109,441** |

Nga tabela shihet se kategoria e investimeve kapitale përbën 80% të shpenzimeve për zbatimin e Strategjisë në periudhën 2007-2012. Ndërkaq, 99.4% të shumës së përgjithshme për investime kapitale janë investime të drejtpërdrejta në infrastrukturë shkollore. Një shpenzim i tillë konsiderohet si i arsyeshëm, pasi, në momentin e tanishëm, në shkollat e Kosovës ka vetëm 2.5 m2/nxënës që përmbush vetëm gjysmën e nevojave, ndërkohë që 30% të hapësirës shkollore ka nevojë për renovime urgjente gjatë periudhës vijuese pesëvjeçare.

Te kjo kategori shpenzuese llogaritet që Buxheti i Kosovës të kontribuojë me 49.54% (97,645,800 EUR) të mjeteve të nevojshme për zbatimin e Strategjisë, kontributi i pritshëm i donatorëve është 24.90% (49.089,200 EUR), ndërsa 19.04% (37,537,500 EUR) parashihen nga të hyrat vetanake të komunave. Gjithashtu, parashihet edhe sigurimi i kontributeve nga burimet private në lartësi prej 12,840,000 EUR (6.51%). Në të ardhmen një pjesë e shpenzimeve kapitale nga Buxheti i Kosovës mund të vijë nga huazimet në institucione financiare ndërkombëtare. Krahas rritjes graduale të kontributit të Buxhetit të Kosovës dhe të kontributit nga buxhetet komunale, në vitin 2008, parashihet një rritje e menjëhershme e të hyrave nga donacionet dhe asistenca financiare për investime kapitale, e cila mund të realizohet nëse Kosova ka qasje në institucione financiare ndërkombëtare.

Kategoria e mallrave dhe shërbimeve përbën 13.60% të buxhetit të nevojshëm për zbatimin e kësaj Strategjie. Kontributi i Buxhetit të Kosovës në këtë mbulim të shpenzimeve të kësaj kategorie do të jetë gjithsej 23,775,681 EUR (71.30%), kontributi i donatorëve dhe ofruesve të asistencës teknike 6,844,380 EUR (20.53%), ndërsa kontributi i buxheteve komunale 2,350,140 EUR (7.05%). Përveç kësaj, gjatë pesë vjetëve të zbatimit të Strategjisë ekziston një trend i qartë i rritjes së kontributit nga burime vendore në raport me kontributin e donatorëve. Në vitin 2007, donatorët kontribuojnë me 42.06% të mjeteve të nevojshme, ndërsa në vitin 2012 parashihet që ky kontribut të reduktohet në 11.03%.

Kategoria e pagave dhe mëditjeve parashihet të mbulohet plotësisht nga burimet vendore, ndërsa pjesëmarrja e saj në buxhetin e Strategjisë është 5.98%. Shpenzimet e kësaj kategorie kryesisht kanë të bëjnë me gradimin e mësimdhënësve, si dhe me mbulimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e infrastrukturës së re shkollore.

Tabelat 3-9 ofrojnë një pasqyrë të shpenzimeve të projektuara, për zbatimin e Strategjisë për arritjen e objektivave strategjike specifike në periudhën 2007-2012. Gjithashtu, këto tabela përmbajnë informacion për burimet e projektuara të të hyrave sipas viteve.

# 6. BUXHETI I STRATEGJISË

**Tabela 3.** Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor e efikas në sistemin e arsimit (objektiva strategjike 1)

| Nr. | Përshkrimi | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Investimet kapitale | Buxheti i Kosoves | 37,200 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 37,200 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 350,000 | 350,000 | 0 | 0 | 700,000 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 87,500 | 0 | 0 | 0 | 0 | 87,500 |
| | **Gjithsej Investimet kapitale** | **37,200** | **87,500** | **350,000** | **350,000** | **0** | **0** | **824,700** |
| Mallrat dhe shërbimet | Buxheti i Kosoves | 72,633 | 320,117 | 231,397 | 238,907 | 203,407 | 203,407 | 1,269,868 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 13,250 | 83,250 | 154,000 | 0 | 250,500 |
| | **Gjithsej Mallrat dhe shërbimet** | **72,633** | **320,117** | **244,647** | **322,157** | **357,407** | **203,407** | **1,520,368** |
| Pagat dhe mëditjet | Buxheti i Kosoves | 8,400 | 20,160 | 25,200 | 25,200 | 25,200 | 25,200 | 129,360 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Pagat dhe mëditjet** | **8,400** | **20,160** | **25,200** | **25,200** | **25,200** | **25,200** | **129,360** |
| TOTALI | Buxheti i Kosoves | 118,233 | 340,277 | 256,597 | 264,107 | 228,607 | 228,607 | 1,436,428 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 350,000 | 350,000 | 0 | 0 | 700,000 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 87,500 | 13,250 | 83,250 | 154,000 | 0 | 338,000 |
| | **TOTALI** | **118,233** | **427,777** | **619,847** | **697,357** | **382,607** | **228,607** | **2,474,428** |

**Tabela 4.** Sistem funksional për sigurimin e cilësisë së të nxënit i bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e zhvilluara (objektiva strategjike 2)

| Nr. | Përshkrimi | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Investimet kapitale | Buxheti i Kosoves | 0 | 3,000 | 38,600 | 0 | 0 | 0 | 41,600 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 49,200 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 49,200 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Investimet kapitale** | **49,200** | **3,000** | **38,600** | **0** | **0** | **0** | **90,800** |
| Mallrat dhe shërbimet | Buxheti i Kosoves | 111,912 | 353,672 | 1,013,110 | 1,008,637 | 940,567 | 783,027 | 4,210,925 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 147,560 | 73,640 | 73,640 | 0 | 0 | 0 | 294,840 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 80,640 | 0 | 15,000 | 0 | 0 | 95,640 |
| | **Gjithsej Mallrat dhe shërbimet** | **259,472** | **507,952** | **1,086,750** | **1,023,637** | **940,567** | **783,027** | **4,601,405** |
| Pagat dhe mëditjet | Buxheti i Kosoves | 80,720 | 112,740 | 170,220 | 458,220 | 458,220 | 458,220 | 1,738,340 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Pagat dhe mëditjet** | **80,720** | **112,740** | **170,220** | **458,220** | **458,220** | **458,220** | **1,738,340** |
| TOTALI | Buxheti i Kosoves | 192,632 | 469,412 | 1,221,930 | 1,466,857 | 1,398,787 | 1,241,247 | 5,990,865 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 196,760 | 73,640 | 73,640 | 0 | 0 | 0 | 344,040 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 80,640 | 0 | 15,000 | 0 | 0 | 95,640 |
| | **TOTALI** | **389,392** | **623,692** | **1,295,570** | **1,481,857** | **1,398,787** | **1,241,247** | **6,430,545** |

**Tabela 5.** Gjithëpërfshirje, barazi dhe respektim i diversitetit në arsim (objektiva strategjike 3)

| Nr. | Përshkrimi | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Investimet kapitale | Buxheti i Kosoves | 0 | 35,000 | 38,000 | 35,000 | 0 | 0 | 108,000 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Investimet kapitale** | **0** | **35,000** | **38,000** | **35,000** | **0** | **0** | **108,000** |
| Mallrat dhe shërbimet | Buxheti i Kosoves | 187,870 | 224,670 | 226,760 | 194,760 | 194,760 | 194,760 | 1,223,580 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 253,820 | 581,720 | 493,500 | 457,500 | 455,000 | 455,000 | 2,696,540 |
| | Burimet private | 0 | 125,000 | 125,000 | 125,000 | 0 | 0 | 375,000 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Mallrat dhe shërbimet** | **441,690** | **931,390** | **845,260** | **777,260** | **649,760** | **649,760** | **4,295,120** |
| Pagat dhe mëditjet | Buxheti i Kosoves | 0 | 0 | 8,160 | 8,160 | 8,160 | 8,160 | 32,640 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Pagat dhe mëditjet** | **0** | **0** | **8,160** | **8,160** | **8,160** | **8,160** | **32,640** |
| TOTALI | Buxheti i Kosoves | 187,870 | 259,670 | 272,920 | 237,920 | 202,920 | 202,920 | 1,364,220 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 253,820 | 581,720 | 493,500 | 457,500 | 455,000 | 455,000 | 2,696,540 |
| | Burimet private | 0 | 125,000 | 125,000 | 125,000 | 0 | 0 | 375,000 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **TOTALI** | **441,690** | **966,390** | **891,420** | **820,420** | **657,920** | **657,920** | **4,435,760** |

**Tabela 6.** Përgatitja dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve (objektiva strategjike 4)

| Nr. | Përshkrimi | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Investimet kapitale | Buxheti i Kosoves | 12,200 | 64,800 | 59,000 | 0 | 0 | 0 | 136,000 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Investimet kapitale** | **12,200** | **64,800** | **59,000** | **0** | **0** | **0** | **136,000** |
| Mallrat dhe shërbimet | Buxheti i Kosoves | 79,628 | 672,204 | 652,940 | 578,284 | 581,120 | 574,940 | 3,139,116 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 3,000 | 303,000 | 303,000 | 303,000 | 303,000 | 303,000 | 1,518,000 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Mallrat dhe shërbimet** | **82,628** | **975,204** | **955,940** | **881,284** | **884,120** | **877,940** | **4,657,116** |
| Pagat dhe mëditjet | Buxheti i Kosoves | 49,220 | 627,476 | 1,160,516 | 1,688,516 | 2,204,516 | 2,720,516 | 8,450,760 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 56,000 | 168,000 | 168,000 | 168,000 | 140,000 | 112,000 | 812,000 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Pagat dhe mëditjet** | **105,220** | **795,476** | **1,328,516** | **1,856,516** | **2,344,516** | **2,832,516** | **9,262,760** |
| TOTALI | Buxheti i Kosoves | 141,048 | 1,364,480 | 1,872,456 | 2,266,800 | 2,785,636 | 3,295,456 | 11,725,876 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 3,000 | 303,000 | 303,000 | 303,000 | 303,000 | 303,000 | 1,518,000 |
| | Burimet private | 56,000 | 168,000 | 168,000 | 168,000 | 140,000 | 112,000 | 812,000 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **TOTALI** | **200,048** | **1,835,480** | **2,343,456** | **2,737,800** | **3,228,636** | **3,710,456** | **14,055,876** |

# 6. BUXHETI I STRATEGJISË

**Tabela 7.** Mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimdhënie dhe nxënie (objektiva strategjike 5)

| Nr. | Përshkrimi | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Investimet kapitale | Buxheti i Kosoves | 12,500,000 | 14,420,000 | 16,240,000 | 17,740,000 | 17,840,000 | 18,580,000 | 97,320,000 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 1,200,000 | 9,120,000 | 9,660,000 | 9,535,000 | 9,535,000 | 9,290,000 | 48,340,000 |
| | Burimet private | 1,250,000 | 1,610,000 | 2,150,000 | 2,525,000 | 2,525,000 | 2,780,000 | 12,840,000 |
| | Burime të tjera | 5,850,000 | 5,850,000 | 5,850,000 | 6,850,000 | 6,850,000 | 6,200,000 | 37,450,000 |
| | **Gjithsej Investimet kapitale** | **20,800,000** | **31,000,000** | **33,900,000** | **36,650,000** | **36,750,000** | **36,850,000** | **195,950,000** |
| Mallrat dhe shërbimet | Buxheti i Kosoves | 50,096 | 950,440 | 1,506,220 | 2,382,000 | 3,304,500 | 4,167,000 | 12,360,256 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 520,000 | 1,085,000 | 100,000 | 0 | 0 | 1,705,000 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 468,000 | 468,000 | 468,000 | 1,404,000 |
| | **Gjithsej Mallrat dhe shërbimet** | **50,096** | **1,470,440** | **2,591,220** | **2,950,000** | **3,772,500** | **4,635,000** | **15,469,256** |
| Pagat dhe mëditjet | Buxheti i Kosoves | 0 | 172,800 | 432,000 | 691,200 | 950,400 | 1,209,600 | 3,456,000 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Pagat dhe mëditjet** | **0** | **172,800** | **432,000** | **691,200** | **950,400** | **1,209,600** | **3,456,000** |
| TOTALI | Buxheti i Kosoves | 12,550,096 | 15,543,240 | 18,178,220 | 20,813,200 | 22,094,900 | 23,956,600 | 113,136,256 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 1,200,000 | 9,640,000 | 10,745,000 | 9,635,000 | 9,535,000 | 9,290,000 | 50,045,000 |
| | Burimet private | 1,250,000 | 1,610,000 | 2,150,000 | 2,525,000 | 2,525,000 | 2,780,000 | 12,840,000 |
| | Burime të tjera | 5,850,000 | 5,850,000 | 5,850,000 | 7,318,000 | 7,318,000 | 6,668,000 | 38,854,000 |
| | **TOTALI** | **20,850,096** | **32,643,240** | **36,923,220** | **40,291,200** | **41,472,900** | **42,694,600** | **214,875,256** |

**Tabela 8.** Lidhje e qëndrueshme e arsimit me zhvillimet globale ekonomike dhe shoqërore (objektiva strategjike 6)

| Nr. | Përshkrimi | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Investimet kapitale | Buxheti i Kosoves | 0 | 0 | 3,000 | 0 | 0 | 0 | 3,000 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Investimet kapitale** | **0** | **0** | **3,000** | **0** | **0** | **0** | **3,000** |
| Mallrat dhe shërbimet | Buxheti i Kosoves | 45,000 | 85,000 | 226,260 | 341,260 | 421,260 | 381,260 | 1,500,040 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 45,000 | 130,000 | 130,000 | 115,000 | 110,000 | 100,000 | 630,000 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 150,000 | 150,000 | 150,000 | 150,000 | 600,000 |
| | **Gjithsej Mallrat dhe shërbimet** | **90,000** | **215,000** | **506,260** | **606,260** | **681,260** | **631,260** | **2,730,040** |
| Pagat dhe mëditjet | Buxheti i Kosoves | 0 | 0 | 8,160 | 8,160 | 8,160 | 8,160 | 32,640 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Pagat dhe mëditjet** | **0** | **0** | **8,160** | **8,160** | **8,160** | **8,160** | **32,640** |
| TOTALI | Buxheti i Kosoves | 45,000 | 85,000 | 237,420 | 349,420 | 429,420 | 389,420 | 1,535,680 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 45,000 | 130,000 | 130,000 | 115,000 | 110,000 | 100,000 | 630,000 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 150,000 | 150,000 | 150,000 | 150,000 | 600,000 |
| | **TOTALI** | **90,000** | **215,000** | **517,420** | **614,420** | **689,420** | **639,420** | **2,765,680** |

**Tabela 9.** Avancimi i gjendjes materiale të arsimit (objektiva strategjike 7)

| Nr. | Përshkrimi | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Investimet kapitale | Buxheti i Kosoves | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Investimet kapitale** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| Mallrat dhe shërbimet | Buxheti i Kosoves | 71,896 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 71,896 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Mallrat dhe shërbimet** | **71,896** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **71,896** |
| Pagat dhe mëditjet | Buxheti i Kosoves | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Gjithsej Pagat dhe mëditjet** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| TOTALI | Buxheti i Kosoves | 71,896 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 71,896 |
| | Donacionet dhe asistenca financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burimet private | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Burime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **TOTALI** | **71,896** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **71,896** |

## 6.4. Projeksioni i shpenzimeve për arsimin parauniversitar 2007-2012

Në procesin e hartimit të buxhetit për vitin 2007, Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF-i) ka bërë projeksione të buxhetit për arsimin parauniversitar edhe për vitet 2008 e 2009. Meqë në këtë dokument shqyrtohet periudha 2007-2012, projeksioni për vitin 2009 është marrë si meritor edhe për periudhën 2010-2012. Në tabelën 10 janë prezantuar projeksionet e MEF-it dhe të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar, sipas kategorive shpenzuese, si dhe projeksionet për fonde shtesë të nevojshme për zbatimin e Strategjisë së Arsimit Parauniversitar nga BKK-ja dhe nga të hyrat vetanake të komunave. Në total janë prezantuar edhe shpenzimet e përgjithshme publike për arsimin parauniversitar në periudhën 2007-2012.

**Tabela 10.** Shpenzimet për arsimin parauniversitar 2007-2012 sipas kategorive shpenzuese

| Projeksionet e shpenzimeve per AP | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| (1) Projeksioni i shpenzimeve nga BKK për arsimin parauniversitar 2007-2012 (MEF) | | | | | | |
| Shpenzimet kapitale | 16,451,245 | 13,023,415 | 13,519,530 | 13,519,530 | 13,519,530 | 13,519,530 |
| Mallrat dhe sherbimet | 12,810,085 | 13,171,872 | 13,171,872 | 13,171,872 | 13,171,872 | 13,171,872 |
| Pagat | 69,763,480 | 69,887,991 | 70,003,267 | 70,003,267 | 70,003,267 | 70,003,267 |
| **Subtotatli (1)** | **99,024,810** | **96,083,278** | **96,694,669** | **96,694,669** | **96,694,669** | **96,694,669** |
| (2) Projeksioni i fondeve shtesë nga BKK për zbatimin e Strategjisë - shih tabela 2 | | | | | | |
| Shpenzimet kapitale | | 14,522,800 | 16,378,600 | 17,775,000 | 17,840,000 | 18,580,000 |
| Mallrat dhe sherbimet | 619,035 | 2,606,103 | 3,856,687 | 4,743,848 | 5,645,614 | 6,304,394 |
| Pagat | 138,340 | 933,176 | 1,804,256 | 2,879,457 | 3,654,656 | 4,429,856 |
| **Subtotali (2)** | **757,375** | **18,062,079** | **22,039,543** | **25,398,305** | **27,140,270** | **29,314,250** |
| (3) Projeksioni i shpenzimeve të përgjithshme nga BKK për arsimin parauniversitar = (1)+(2) | | | | | | |
| Shpenzimet kapitale | 16,451,245 | 27,546,215 | 29,898,130 | 31,294,530 | 31,359,530 | 32,099,530 |
| Mallrat dhe sherbimet | 13,429,120 | 15,777,975 | 17,028,559 | 17,915,720 | 18,817,486 | 19,476,266 |
| Pagat | 69,901,820 | 70,821,167 | 71,807,523 | 72,882,724 | 73,657,923 | 74,433,123 |
| **Subtotali (3) = (1) + (2)** | **99,782,185** | **114,145,357** | **118,734,212** | **122,092,974** | **123,834,939** | **126,008,919** |
| (4) Projeksioni i fondeve shtesë nga të hyrat vetanake të komunave për zbatimin e Strategjisë - shih tabela 2 | | | | | | |
| Subtotatli (4) | 5,850,000 | 6,018,140 | 6,013,250 | 7,566,250 | 7,622,000 | 6,818,000 |
| **Shpenzimet e përgjithshme publike për arsimin parauniversitar (3)+(4)** | **105,632,185** | **120,163,497** | **124,747,462** | **129,659,224** | **131,456,939** | **132,826,919** |

*Sqarime:*
*(1) Tri kategori shpenzuese të MEF-it: mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe subvencione janë përmbledhur në një të vetme – mallra dhe shërbime.*
*(2) Shpenzimet kapitale të nevojshme për vitin 2007 në lartësi prej 12,549,400 EUR janë përfshirë në buxhetin e Kosovës për vitin 2007.*

Për shkak të krahasimit të parametrave me vendet tjera, projeksioneve të dhëna në tabelën 10 i shtohen edhe projeksionet e shpenzimeve publike për arsimin e lartë, të cilat janë bërë duke pasur parasysh buxhetin e Kosovës për vitin 2007 dhe trendët e rritjes së shpenzimeve që parashihen për arsimin parauniversitar.

**Tabela 11.** Shpenzimet publike për të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë 2007-2012

| Niveli | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Arsimi parauniversitar | 105,632,185 | 120,163,497 | 124,747,462 | 129,659,223 | 131,456,939 | 132,826,919 |
| Arsimi i lartë | 17,000,000 | 19,338,608 | 20,076,332 | 20,866,811 | 21,156,127 | 21,376,606 |
| **Gjithsej** | **122,632,185** | **139,502,105** | **144,823,794** | **150,526,034** | **152,613,066** | **154,203,525** |

Strategjia dhe Plani Zhvillimor i Kosovës (SPZHK)[6] parasheh dy skenarë makroekonomikë për periudhën 2007-2013:

- skenari bazik që ekstrapolon zhvillimin ekonomik në bazë të trendëve të viteve të kaluara;
- skenari reformues që identifikon kufizimet, të cilat duhen tejkaluar në një periudhë afatgjatë për një zhvillim më të shpejtë dhe më të qëndrueshëm ekonomik.

Ky dokument projekton rritjen e Bruto Prodhimit Vendor (BPV) në kushtet e të dy skenarëve si është dhënë në tabelën 12.

**Tabela 12.** BPV-ja sipas projeksioneve të SPZHK-së (në miliona euro)[7]

| Skenari | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Bazik** | 2,365 | 2,407 | 2,445 | 2,517 | 2,555 | 2,606 |
| **Reformues** | 2,365 | 2,427 | 2,518 | 2,695 | 2,837 | 2,977 |

Me krahasimin e tabelave 11 dhe 12 fitohen shpenzimet publike për arsim në Kosovë si përqindje e BPV-së (shih tabela 13).

**Tabela 13.** Shpenzimet publike për arsim si përqindje e BPV-së sipas viteve

| Skenari | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | Mesatarja |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Bazik** | 5.19% | 5.80% | 5.92% | 5.98% | 5.97% | 5.92% | **5.80%** |
| **Reformues** | 5.19% | 5.75% | 5.75% | 5.59% | 5.38% | 5.18% | **5.47%** |

Sipas të dhënave të Komisionit Evropian në vitin 2001 vendet e Bashkimit Evropian kanë shpenzuar mesatarisht 5.1% të parave publike për arsim. Gjithashtu, pjesëmarrja e shpenzimeve publike për arsim si përqindje e BPV-së ka qenë relativisht stabile në periudhën 1995-2001 dhe ka ndjekur hap pas hapi rritjen ekonomike të vendeve anëtare[8].

[6] Kosovo Development Strategy, Draft 1+1, Dec 20, 2006
[7] Po aty
[8] Key Data on Education in Europe 2005, European Comission, f. 161

# 6. BUXHETI I STRATEGJISË

Me një mesatare prej 5.80% të shpenzimeve publike në arsim (skenari bazik), Kosova do të ishte në nivelin e përqindjes së shpenzimeve publike të vendeve si Franca, Lituania, Polonia, Austria, por nën nivelin e vendeve nordike – Suedia – 7.3%, Finlanda - 6.2%, Norvegjia – 7%, Danimarka – 8.5%. Megjithatë, kur merret parasysh fakti se Kosova ka BPV-në më të ulët në Evropë, një përqindje të madhe të popullatës së moshës së re dhe një shkallë të lartë të varfërisë, kjo përqindje e shpenzimeve për arsim mund të jetë e pamjaftueshme për të përkrahur një zhvillim të qëndrueshëm njerëzor. Përveç kësaj, gjithnjë duhet pasur parasysh se shpenzimet publike për arsim në Kosovë nuk mbulojnë disa prej shpenzimeve që normalisht mbulohen në vendet e BE-së.

Nga të dy skenarët është evidente se viti 2008 është viti i kthesës, kur duhet të fillojë një investim afatgjatë për zhvillimin e arsimit në Kosovë, prandaj vendimet kryesore duhet të merren në vitin 2007.

Tabela vijuese jep një pasqyrë të shpenzimeve publike për arsimin parauniversitar si përqindje e BPV-së. Është ky një tregues relevant për Strategjinë e Arsimit Parauniversitar, sepse jep mundësi krahasimi me vendet e tjera të botës.

**Tabela 14.** Shpenzimet publike për arsimin parauniversitar si përqindje e BPV-së sipas viteve

| Skenari | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | Mesatarja |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Bazik** | 4.22% | 4.74% | 4.86% | 4.85% | 4.85% | 4.84% | **4.73%** |
| **Reformues** | 4.22% | 4.70% | 4.72% | 4.53% | 4.36% | 4.23% | **4.46%** |

Nga të dhënat e Komisionit Evropian[9] vërehet se mesatarja e shpenzimeve të vendeve të BE-së për arsimin parauniversitar në vitin 2001 ka qenë 4%, ku është përfshirë edhe edukimi parashkollor. Përqindja e shpenzimeve publike për arsim parauniversitar dallon prej një vendi në tjetrin. Përderisa Danimarka shpenzon 5.8% të BPV-së për arsim parauniversitar, projeksionet tona janë në nivelin e shpenzimeve që bëjnë vendet si Belgjika, Lituania, Polonia, por mbi nivelin e anëtareve të reja të BE-së si Bullgaria – 3% dhe Rumania – 2.6%.

[9] Key Data on Education in Europe 2005, European Comission, f. 167

Me gjithë faktin se në disa vende ka vështirësi që këto shpenzime të zbërthehen sipas niveleve të arsimit parauniversitar (ISCED 0-4), konstatohet se arsimi i mesëm shpenzon prej 34-63% të mjeteve publike të dedikuara për arsim.

Duke u bazuar në projeksionet demografike të SPZHK-së, Kosova në vitin 2012 do t'i ketë rreth 2,250,000 banorë (shtimi vjetor prej 1.8%), ndërsa statistikat e arsimit parashohin një numër prej 400,000 nxënësish në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm (ISCED 1-4). Tabela vijuese reflekton shpenzimet mesatare publike për kokë nxënësi në arsimin parauniversitar si shumë në EUR dhe si përqindje e BPV-së për kokë banori.

**Tabela 15.** Mesatarja e shpenzimeve publike për kokë nxënësi në arsimin fillor dhe të mesëm

| Viti | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | Mesatarja |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shuma (EUR)** | 264.08 | 300.41 | 311.87 | 324.15 | 328.64 | 332.07 | **310.20** |
| **% e BPV Skenari bazik** | 23.09% | 26.24% | 27.28% | 28.01% | 28.45% | 28.66% | **26.96%** |
| **% e BPV Skenari reformues** | 23.09% | 26.03% | 26.49% | 26.16% | 25.62% | 25.09% | **25.41%** |

Sipas këtyre projeksioneve shpenzimet publike për kokë nxënësi në Kosovë si përqindje e BPV-së për kokë banori në vitin 2007 do të ishin në nivelin e mesatares së vendeve të Bashkimit Evropian - 23%[10], ndërsa në vitet pasuese kjo përqindje do të rritej. Megjithatë, rritja e përqindjes nuk rezulton edhe me një rritje sinjifikante të shumave të parave publike që shpenzohen për kokë nxënësi – pritet që të jetë një mesatare prej rreth 310 EUR për kokë nxënësi.

[10] Key Data on Education in Europe 2005, European Comission, f. 173

## LISTA E PERSONAVE QË KANË KONTRIBUAR PËR HARTIMIN E STRATEGJISË

1. Agim Veliu, ministër, MASHT
2. Fevzi Berisha, zëvendës-ministër, MASHT, kryetar i KEAP-it
3. Dëfrim Gashi, këshilltar i ministrit, MASHT
4. Dragisha Miriq, këshilltar i ministrit, MASHT
5. Avdullah Hoti, këshilltar i ministrit, MASHT
6. Fehmi Ismaili, sekretar i përhershëm, MASHT
7. Bardhyl Musai, këshilltar ndërkombëtar, MASHT
8. Nimon Alimusa, deputet, Kuvendi i Kosovës
9. Arbër Salihu, MASHT, anëtar i KEAP-it
10. Halim Hyseni, KEC, anëtar i KEAP-it
11. Lema Kabashi, Fakulteti i Edukimit, anëtare e KEAP-it
12. Luan Shllaku, KFOS, anëtar i KEAP-it
13. Osman Buleshkaj, KEDP, anëtar i KEAP-it
14. Zenun Kuliq, anëtar i KEAP-it
15. Achsel Sachs, GTZ
16. Afërdita Spahiu, UNICEF
17. Agim Berdyna, MASHT
18. Alush Istogu, DKA-Drenas
19. Anton Gojani, OSCE
20. Arianit Loxha, ekspert i pavarur
21. Azem Azemi, MASHT
22. Berta Hamza, GTZ
23. Besim Sejfijaj, MASHT
24. David Handley, KOSVET
25. Demë Hoti, Fakulteti i Edukimit
26. Drita Haxhaj, MASHT
27. Drita Kadriu, KEC
28. Dukagjin Pupovci, KEC
29. Eda Vula, Fakulteti i Edukimit
30. Enesa Kadic, MASHT
31. Fadile Dyla, MASHT
32. Fehmi Zylfiu, MASHT
33. Fetah Bylykbashi, MASHT
34. Fetah Kasumi, MASHT
35. Hasan Hoti, DKA-Prizren
36. Isuf Gashi, MASHT

37. Jehona Namani, MPMS
38. Jonuz  Salihaj, KEC
39. Lulavere Kadriu, MASHT
40. Mevlude Shamolli, MEF
41. Milaim Elshani, MASHT
42. Munish Hyseni, Shkolla fillore “Meto Bajraktari”, Prishtinë
43. Musa Shala, MASHT
44. Naxhije Shala, MASHT
45. Nazan Safqi, MASHT
46. Nehar Shishko, MASHT
47. Nexhip Menekshe, Shoqata “Durmish Arsllano”, Prizren
48. Nexhmi Rudari, MASHT
49. Nora Tafarshiku, KEC
50. Nyvit Drançolli, KEC
51. Pal Bala, Gjimnazi “Loyola”, Prizren
52. Peter Porten, Swisscontact
53. Radica Berishaj, MASHT
54. Ragip Zekolli, MASHT
55. Ramush Lekaj, MASHT
56. Remzi Salihu, MASHT
57. Rrahim Bublaku, MASHT
58. Rrustem Buzhala, DKA-Prishtinë
59. Sanije Dabiqaj, MASHT
60. Sherif Dobra, MASHT
61. Shkumbin Saneja, MEF
62. Shpejtim Bulliqi, DKA-Podujevë
63. Vedat Bajrami, MASHT
64. Veton Sylhasi, KEC
65. Vlera Kastrati, KOSVET
66. Xhafer Xhaferi, SBASHK
67. Xhavit Rexhaj, Fakulteti i Edukimit
68. Xhelal Derguti, GTZ
69. Zef Osmani, MASHT
70. Bekim Toçani, informim, MASHT
71. Ismet Osdautaj, informim, MASHT
72. Mimoza Hasani, informim, MASHT
73. Mimoza Jashari, sekretari, MASHT
74. Petrit Tahiri, logjistikë, KEC

# SHTOJCË 2

UNMIK

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS
GOVERNMENT OF KOSOVO
VLADA KOSOVA

Numër: 02/247
Datë: 25.04.07

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2007, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Kryeministri i Kosovës**
**Agim ÇEKU**